



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

**PLANI I VEPRIMIT 2010 PËR IMPLEMENTIMIN E  
PARTNERITETIT EUROPIAN PËR KOSOVËN**

Korrik 2010  
Prishtinë

<b>1. HYRJJE .....</b>	<b>8</b>
<b>1.1 RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EUROPIAN .....</b>	<b>8</b>
<b>2. Plani i Veprimit për partneritetet European .....</b>	<b>10</b>
<b>2.1 Përgatitja e Planit të Veprimit për Partneritetet European (PVPE 2010).....</b>	<b>13</b>
<b>3. ZBATIMI I PVPE-së 2009 DHE ADRESIMI I SFIDAVE TË RAPORTIT TË PROGRESIT.....</b>	<b>14</b>
<b>3.1. KRITERET POLITIKE.....</b>	<b>14</b>
<b>3.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT .....</b>	<b>14</b>
a. Kuvendi.....	14
b. Qeveria .....	15
c. Administrata Publike.....	15
d. Sistemi gjyqësor .....	16
e. Politikat kundër korrupsionit .....	17
<b>3.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE .....</b>	<b>17</b>
<b>3.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>19</b>
<b>3.2 KRITERET EKONOMIKE .....</b>	<b>21</b>
<b>3.3 STANDARTET EUROPIANE .....</b>	<b>23</b>
<b>3.3.1 TREGU I BRENDSHËM .....</b>	<b>23</b>
a. Lëvizja e lirë e mallrave .....	23
b. Lëvizja e lirë e kapitalit.....	25
c. Doganat dhe tatimet.....	26
d. Prokurimi publik .....	28
e. Të drejtat e pronësisë intelektuale.....	28
f. Punësimi dhe Politikat Sociale.....	29
g. Arsimi dhe kërkimet.....	31
<b>3.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE .....</b>	<b>34</b>
a. Industria dhe NVM-të .....	34
b. Bujqësia dhe peshkataria .....	34
c. Mjedisi.....	35
d. Politikat e transportit .....	38
e. Energjia.....	41
f. Shoqëria informative dhe mediat.....	44
g. Kontrolli financiar .....	47
h. Statistikat.....	48
<b>3.3.3 DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA.....</b>	<b>49</b>
a. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi.....	49
b. Shpëlarja e parave .....	50
c. Drogat.....	51
d. Policia.....	51
e. Luftimi i krimit dhe krimit të organizuar.....	51
f. Mbrojtja e të dhënave personale.....	52
<b>4. LIDHJA ME DOKUMENTET STRATEGJIKE TË QEVERISË .....</b>	<b>53</b>
<b>5. RAPORTIMI DHE MONITORIMI I PVPE-SË DHE INDIKATORËT E MATJES .....</b>	<b>53</b>
<b>6. MATRICA E VEPRIME TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EUROPIAN 2010 .....</b>	<b>56</b>

## **LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE**

AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ABK	Autoriteti Bankar i Kosovës
AKK	Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AKR	Aleanca Kosova e Re
AKS	Agjencia Kosovare për Standardizim
AMNVM	Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
AQBK	Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
APIK	Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
APK	Agjencia për Privatizim e Kosovës
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPSH	Bruto Produkti Shoqëror
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BQNJ	Byrotë e Qarkut për Ndihmë Juridike
CARDS	Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillimi dhe Stabilitet
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DK	Doganat e Kosovës
DPISH	Dokumenti Programues Indikativ Shumëvjeçar
DPSA	Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit
ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit

ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GjND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
GND	Grupi Ndërmintrosor për Decentralizim
GTZ	Agjencia Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
GZRK	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
HK	Hekurudhat e Kosovës
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KELP	Këshilli për Emërime të Larta Publike
KENM	Karta Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPK	Komisioni Prokurorial i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
KPP	Kodi i Përkohshëm Penal
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LQMK	Laboratorin Qendror për Metrologji i Kosovës
LPP	Ligji mbi Prokurimin Publik
LPH	Ligjit mbi planifikimin Hapësinor
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEI	Ministria e Integritimit Europian
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OGjM	Organizmat Gjenetikisht të Modifikuar
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PBEJL	Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PIP	Programi i Investimeve Publike
PK	Policia e Kosovës
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PNJK	Pilot-Njësitë Komunale

PPP	Partneritet Publik-Privat
PSH	Prokuroria e Shtetit
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PVRMFP	Plani i Veprimit për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike
PVRAP	Plani i Veprimit për Reformën e Administratës Publike
PZHIT	Plani Zhvillimor dhe Investues i Transmisionit
PZHRB	Plani për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
QITT	Qendra për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit
RAP	Reforma e Administratës Publike
RCC	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
RTK	Radio-Televizioni i Kosovës
SEETO	Observatori i Transportit për Evropën Juglindore
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SNS	Skema e Ndihmës Sociale
SHCK	Shërbimi Civil i Kosovës
SHPLF	Procesi i zhvillimit të Shpenzimeve Publike dhe Llogaridhënies Financiare
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TIK	Teknologjia Informative
TQNJ	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
ZÇK	Zyra për çështje të komuniteteve
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZMAGZ	Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare

ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ZPZH	Zyra për Persona të Zhdukur
ZQM	Zyra për Qeverisjes të Mirë
ZRRE	Zyra Rregullatore e Energjisë
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

## 1. HYRJE

### 1.1 RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EUROPIAN

Qysh prej Samitit të Selanikut më 2003, Kosova ka qenë fuqimisht e përfshirë në kornizën e Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit. Më 20 prill 2005, Komisioni Europian miratoi komunikatën “E ardhmja Europiane për Kosovën”, që përforcon edhe më tepër përkushtimin e BE-së ndaj Kosovës. Në vitin 2006, Këshilli Europian miratoi Partneritetin e parë Europian dhe më 18 shkurt 2008 Partneritetin e dytë Europian për Kosovën. Si përgjigje ndaj kësaj, më 31 korrik 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin e veprimit për implementimin e Partneritetit Europian (PVPE) 2008.

Kosova ende nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Në strategjinë e zgjerimit dhe sfidave 2009-2010 të publikuar më 14 tetor 2009, Raportin e Progresit 2009 dhe Komunikatën “Kosova – Përbushja e perspektivës Europiane” (Studimi për Kosovën) ku është vlerësuar progresi i arritur në Kosovës, si dhe janë prezantuar problemet dhe sfidat kryesore të Kosovës në fushën e integritit Europian. Në këtë komunikatë të Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin, Komisioni Europian ka propozuar thellimin dhe fuqizimin e perspektivës Europiane të Kosovës. Rekomandimet e Komisionit Europian në këtë Komunikatë, janë aprovuar nga Këshilli Europian në dhjetor të vitit 2009. Si rrjedhojë, Kosova hyn në një fazë tjetër të procesit të integritit Europian duke marr një perspektivë më të qartë Europiane përmes fuqizimit dhe thellimit të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit;<sup>1</sup> dialogut për viza me perspektivë të liberalizimit të tyre pasi të jenë kryer reformat e nevojshme dhe të jenë përbushur kushtet; zgjerimin e Masave të Pavarura Tregtare dhe pas përbushjes së kriterëve të nevojshme; propozimin e direktivave negociuese për një marrëveshje tregtare me Bashkimin Europian; shqyrtimin e mundësive për një marrëveshje kornizë mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Kosovës në programet e Komunitetit; aktivizimin e komponentës së Instrumentit të Paraanëtarësimit (IPA) për bashkëpunimin kufitar (Komponenta II e IPA-së).

Sfida e radhës për Kosovën, në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian, është të hyjë në fazën e ardhshme të procesit - në hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit. Sa më shpejt që Kosova arrin progres në zbatimin e rekomandimeve të Partneritetit Europian, e sidomos në zbatimin e prioritetëve thelbësore dhe atyre afatshkurtra, aq më herët do të hapet dera për

---

**1 Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asociimit (STM)** është instrumenti kryesor për dialogun politik mes Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian brenda kornizës së Procesit të BE-së për Stabilizim dhe Asociim. Qëllimi kryesor i takimeve politike dhe teknike të STM është bashkërendimi dhe monitorimi i reformave të Kosovës dhe procesi i përafrimit me BE-në, e sidomos prioritetet e përkufizuara në Partneritetin Evropian të miratuar nga Këshilli Evropian më 18 shkurt 2008.



Kosovën që të tregojë përkushtimin e saj të plotë për procesin e integritit European dhe të hyjë në fazat e ardhshme. Sfida të veçanta në këtë periudhë janë zbatimi i kritereve për një marrëveshje potenciale tregtare me Bashkimin European dhe liberalizimin e vizave.

Në shkurt të vitit 2009, Parlamenti European ka nxjerr një rezolutë përmes të cilës ka shprehur përkushtimin e BE-së për të luajtur rol udhëheqës në sigurimin e stabilitetit të Kosovës dhe Ballkanit perëndimorë si tërësi dhe ka ritheksuar gatishmërinë për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe politik të Kosovës duke i ofruar perspektivë të qartë për anëtarësim në BE. Në prill është mbajtur takimi i dytë ndër-parlamentar BE-Kosovë. Nga ky takim është lëshuar një komunikatë e përbashkët përmes të cilës është theksuar së situata e përgjithshme e stabilitetit politik të Kosovës është e kënaqshme.

Bashkimi European vazhdon të sigurojë një ndihmë të konsiderueshme financiare për ndërtimin dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës, nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik, si dhe avancimin e mëtejshëm të integritit rajonal. BE-ja është aktualisht donatori më i madh në Kosovë, që ndanë më shumë ndihma për kokë banori krahasuar me secilin vend tjetër të botës.

Instrumenti kryesor i asistencës së donatorëve gjatë periudhës 1999-2006 ka qenë Asistenca e komunitetit për rindërtim, zhvillim dhe stabilizim (CARDS). Kosova ka vazhduar të përfitoj nga Instrumenti i para-anëtarësimin (IPA), asistenca mikrofinanciare, Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillimi dhe Stabilitet (CARDS), Instrumenti për stabilitet (IfS) dhe burime tjera. Përafërsisht 500 milion euro i janë dhënë Kosovës ndër vite përmes IPA-së. Dokumenti i Planit Indikativ shumëvjeçar 2009-2011, dokumenti që identifikon fushat kryesore dhe prioritetet e asistencës së IPA-së, është aprovuar në korrik 2009. Mbi 103 milion euro janë alokuar për Programimin Vjetor 2009 të IPA-së, kurse në Programin Vjetor për vitin 2010 janë paraparë të alokohen 67 milion euro.

Në drejtim të përmirësimit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në dialogun politik dhe janë ndarë 1.7 milion euro në kuadër të IPA 2008. Fushat si ambienti dhe mundësitë e barabarta (masat kundër diskriminimit dhe përfshirja sociale e grupeve të rrezikuara) kanë pasur trajtim të veçantë. Në kuadër të IPA 2009, 3 milion euro janë destinuar për shoqërisë civile, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe fuqizimin e grupeve dhe grupeve të rrezikuara. Këto çështje janë mbështetur edhe nga Instrumenti i Demokratizimit dhe Drejtave të Njeriut.

Sa i përket zhvillimeve të tjera, Republika e Kosovës tanimë është njohur nga 69 shtete, anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Njohjet e reja po vazhdojnë duke dëshmuar kështu përparimin dhe stabilitetin politik në Kosovë. Gjatë vitit të kaluar, Kosova, po ashtu, është bërë anëtare e plotë e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore.

Qeveria e Kosovës ka vazhduar me konsolidimin e institucioneve shtetërore në vend por edhe jashtë vendit, me krijimin dhe konsolidimin e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Konsolidimi i institucioneve shtetërore, të mbështetura në standarde Europiane, ka vazhduar në veçanti me ngritjen e nivelit të funksionimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë

dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Së bashku me institucionet ndërkombëtare në Kosovë, NATO-n dhe KFOR-in, janë arritur tashmë kapacitetet e para operacionale të FSK-së.

Janë emëruar 18 Ambasadorët e parë dhe është bërë dërgimi i stafit të parë diplomatik dhe konsullor në përfaqësitë e Kosovës jashtë vendit. Në frymën e pavarësisë së Kosovës si një faktor stabiliteti në rajon – Qeveria ka synuar krijimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me të gjitha vendet e rajonit; shumica prej të cilëve veçse e kanë njohur pavarësinë. Sa i përket këtij bashkëpunimi, është bërë demarkacioni i suksesshëm i kufirit me Republikën e Maqedonisë dhe janë vendosur marrëdhëniet diplomatike me Maqedoninë dhe me Malin e Zi. Qeveria e Kosovës, pas përgatitjeve dhe prezantimit gjithëpërfshirës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), gjatë seancave dëgjimore, tani mirëpret një vendim të drejtë dhe respektimin e plotë të vullnetit të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran.

Ndër prioritet parësore të Qeverisë ka qenë dhe mbetet përsheptimi i procesit të integrimit euroatlantik të Kosovës. Qeveria e Kosovës e ka mirëpritur publikimin e Raportit Vjetor të Progresit 2009 dhe Komunikatës së KE-së për Këshillin dhe Parlamentin Europian “Kosova – Përmeshja e perspektivës Europiane” të ashtuquajtur Studimi për Kosovën. Sfidat e Raportit të Progresit janë në përputhje të plotë me prioritetet e Qeverisë dhe të institucioneve të Kosovës. Ato janë adresuar përmes Planit të Veprimit të Partneritet Europian, Planit të Punës së Qeverisë për vitin 2010 dhe dokumenteve të tjera strategjike.

Qeveria i ka funksionalizuar strukturat për integrim Europian dhe tash është në proces të fuqizimit të tyre. Është ndërtuar partneriteti i qëndrueshëm dhe komunikim i hapur me Komisionin Europian. Në plotësimin e një ndër kritereve më të rëndësishme për liberalizimin e vizave me BE-në është hartuar Plani i Veprimit për zbatimin e udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave. Si rezultat i intensifikimit të procesit të integrimit Europian, Qeveria e Kosovës, më 27 gusht 2008, ka miratuar strukturat e reja qeveritare me qëllim të koordinimit sa më të mirë të institucioneve në këtë drejtim. Këto struktura përfshijnë grupe punuese sektoriale, në fushën e qeverisjes së mirë, ekonomisë, tregut të brendshëm, inovacionit, infrastrukturës dhe bujqësisë.

## **2. PLANI I VEPRIMIT PËR PARTNERITET EUROPIAN**

Çdo zhvillim i mëtejshëm i Kosovës do të matet në bazë të implementimit të prioritetëve Kyçe, afatmesme dhe afatgjata të Partneritetit Europian. Mu për shkak të rëndësisë politike të Partneritetit Europian dhe reagimit të Qeverisë në formë të Planit të Veprimit për zbatimin e prioritetëve të partneritetit Europian, Qeveria e Kosovës do të jetë plotësisht e përkushtuar dhe të qëndrojë vendosmërisht pas këtij procesi të vështirë të ndërtimit të Partneritet me BE-në, duke vënë këtë dokument si prioritet të Qeverisë dhe anëtarëve të saj, si dhe duke shtyrë vazhdimisht implementimin e tij me anë të mekanizmave institucionalë të Qeverisë.

Plani i Veprimit është aprovuar përmes procedurave të rregullta qeveritare të ketë mbështetje politike dhe përkushtim, të diskutohet me përfaqësuesit e Komisionit Europian si dhe me tërë bashkësinë ndërkombëtare prezent në Kosovë, ti prezantohet publikut të gjerë në Kosovë, si dokument i përgatitur nga të gjitha institucionet e Kosovës si shprehje e pikëpamjes dhe e përkushtimit të tyre.

Plani i Veprimit i Partneritet European është dokumenti kryesor afatmesëm planifikues i Qeverisë së Kosovës që ka për qëllim përcaktimin e veprimeve të nevojshme për zbatimin e agjendës Europiane dhe progresin në procesin e Integritetit të Kosovës në BE, në pajtim me prioritetet e identifikuar nga Partneriteti European. Plani ndjek strukturën e Partneritetit European për Kosovën 2008 si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit, duke përfshirë këto pjesë:

- Kriteret politike,
- Kriteret ekonomike,
- Standardet Europiane,
- Monitorimi dhe raportimi në bazë të PVPE-së dhe Rishikimit të Planit.

Prioritetet e Partneritetit European janë ndarë në prioritetet afatshkurtra (1-2 vite) dhe prioritetet afatmesme (3-4 vjet). Prioritetet afatshkurtra – përshkruajnë veprimet që do të zbatohen vis-a-vis prioritetëve afatshkurtra brenda secilës fushë, kurse prioritetet afatmesme – përshkruajnë veprimet që do të zbatohen vis-a-vis prioritetëve afatmesme brenda secilës fushë.

Përmbajtja dhe struktura e pjesës mbi kriteret politike, kriteret ekonomike, dhe standardet Europiane – është paraqitur në vijim të prezantimit të reformave që janë ndërmarr në aspektin e kornizës ligjore dhe institucionale në planin afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe veprimet e planifikuara për adresimin e sfidave të Raportit të Progresit 2009. Në veçanti prioritetet e partneritetit European përfshijnë katër kapituj kryesor:

**Prioritetet kyçe** afatshkurtra kanë të bëjnë me respektimin e sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e minoriteteve dhe lirinë e religjionit, garantimi i qeverisjes demokratike dhe ofrimi i shërbimeve publike, vendosja e një administrate publike transparente dhe të përgjegjshme; vazhdimi i reformës në vetëqeverisje dhe në ngritjen e kapaciteteve administrative. Qëllimi i të cilave është të krijoj në klimë për pajtim, për tolerancë të qëndrueshme ndër-fetare dhe multi-etnike e cila është e favorshme për kthimin e të zhvendosurve. Luftimi i korrupsionit, krimin të organizuar dhe terrorizmit duhet të vazhdohet, po ashtu prioritetet kanë qëllim të krijojnë shoqëri të pa diskriminuar, përfshirjen e grupeve të pa favorizuara, konsolidimin e të drejtave pronësore, kornizës ligjore dhe qasja në gjyqe.

**Kriteret politike** kanë të bëjnë me demokracinë dhe sundimin e ligjit (institucionet, luftimin e krimin të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, parlamenti/zgjedhjet, administratës publike, sistemit gjyqësor, të drejtat e njeriut, mbrojtja e të drejtave të minoriteteve, të drejtat kulturore). Ato po ashtu fokusohen në çështjet regjionale dhe obligimet ndërkombëtare përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, implementimi i CEFTA-s Marrëveshja e tregtisë së lirë të Evropës qendrore dhe pjesëmarrja në të gjitha iniciativat rajonale.

**Kriteret ekonomike** përfshijnë mbajtjen e politikave të shëndosha buxhetore; qëndrueshmërinë afatgjatë të politikave sociale duke vënë në fokus varfërinë dhe përjashtimin social; shkallë më të lartë të kthimit të faturave të shërbimeve publike - qeverisje më të mirë dhe përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së arsimit, privatizimi dhe ristrukturimi, eficientëncën financiare e kompanive publike, krijimin e një tregu zyrtarë

të punës, forcimi i të drejtave pronësore, sundimin i ligjit dhe qasjen në gjykata; zbatimin e politikave aktive të tregut të punës dhe një rritje në kapacitetin e eksportit.

**Standardet Europiane** kanë të bëjnë me aspekte të caktuara të legjislacionit të Bashkimit Europian, do të thotë në tregun brendshëm, politikat sektoriale dhe fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Në këto fusha, Kosova duhet të përpiqet ta sjellë legjislacionin e saj në përputhje me legjislacionin e Komunitetit dhe të sigurohet për zbatimin e tij. Kosova duhet gjithashtu të zhvillojë dhe të forcojë kapacitetin e saj administrativ, në mënyrë që të sigurohet që politikat e saj dhe legjislacioni janë koherente me kërkesat e BE-së dhe për të implementuar standardet e BE-së.

Duke u bazuar në agjendën Europiane për Kosovën, çdo përparim i mëtutjeshëm i vendit do të matet në bazë të zbatimit të prioritetëve thelbësore, afatshkurtra dhe afatmesme, në kuadër të Partneritetit Europian. Në këtë kontekst, PVPE-ja duhet të përdoret për planifikimin e veprimtarisë së Qeverisë:

- Në lidhje me agjendën politike të Qeverisë dhe prioritetëve të saj,
- Agjendën legjislative të Qeverisë (ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe akte tjera ligjore) si dhe Kuvendit,
- Planin e punësimit të nevojshëm për zbatimin e agjendës së integritimeve Europiane dhe zbatimin e akteve të harmonizuara ligjore,
- Planin për ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit (nevojat për trajnime të përgjithshme dhe specifike),
- Planin për investime e sidomos për ndërtimin (avancimin) e rrjetit të TI në lidhje me Acquis.

Tutje, Plani i Veprimit mund/duhet të shfrytëzohet për komunikimin e brendshëm:

- Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë (mirëkuptimi i përbashkët i agjendës qeveritare dhe rezultateve që duhen arritur),
- Ministrave dhe stafit të tyre (udhëzime të qarta me caqe të matshme),
- Marrëdhëniet në mes të organeve qeveritare (një plan dhe të njëjtat afate),
- Qeverisë dhe komunitetit afarist dhe partnerëve socialë (mekanizëm paralajmërues për ndryshimet që do të ndodhin dhe do të prekin komunitetin afarist dhe partnerët socialë),
- Marrëdhëniet me sektorin e OJQ-ve (baza për ndërtimin e partneritetit)
- Komunikimin me media (agjendë e qartë e Qeverisë që mund të matet edhe nga mediat)
- Si dhe me publikun e gjerë, gjithë qytetarët, (qytetarët që duan mund të masin në çdo kohë së sa e suksesshme ka qenë Qeveria)

... si dhe për komunikim të jashtëm:

- Komunikim me bashkësinë ndërkombëtare dhe për kuptim më të mirë të prioritetëve të Kosovës (prioritete dhe agjendë qeveritare të qartë dhe të paraqitur publikisht),
- Marrëdhëniet me Komisionin Europian dhe shërbimet e tij (gjithmonë e nevojshme për qëllime të monitorimit dhe paraqitjes së pasqyrës së qartë për përparimin e arritur),
- Me të gjitha shtetet anëtare të BE-së (të mos harrohet që të gjitha vendimet e rëndësishme merren nga ato),

- Me fqinjët e Kosovës (të gjithë në rajon janë dhe do të ndjekin shumë, afërsisht atë që Kosova bën, planifikon dhe arrin),
- Me sektorin akademik dhe joqeveritar European dhe publikun e gjerë (Kosova ka nevojë për gjithë mbështetjen që mund ta marrë nga një mjedis sa më i gjerë që është e mundur).

## **2.1 PËRGATITJA E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EUROPIAN (PVPE 2010)**

Rishikimi PVPE-së 2009 dhe përgatitja e PVPE 2010 ka marr parasysh faktin së PVPE është dokumenti kryesor afatmesëm në fushën e Integritit European, prandaj duke konsideruar rekomandimet e Komisionet European në Raportin e Progresit 2009 është shtuar kujdes i veçantë në përmirësimin e cilësisë të këtij dokumenti, duke e bërë atë me të matshëm përmes vendosjes së veprimeve më të rëndësishme që mund të bëjnë ndryshime për procesin dhe jo ato rutinore.

Duhet marr parasysh se Partneriteti European është prezantuar në vitin 2008, dhe problemi kryesor qëndron se ka shumë prioritetet që nuk i përkasin realitetit të ri në Kosovë. Në anën tjetër disa prioritetet të tjera nuk janë konkrete dhe përkohë më shumë me veprime operacionale. Për këtë arsye, është e nevojshme që Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Komisionin European të punoj në drejtim të ridefinimit të prioritetëve të partneritetit European ose të përcaktohen prioritetet e Qeverisë së Kosovës për agjendën Europiane.

Kriteri kryesor gjatë përgatitjes së PVPE 2010 ka qenë relevanca e veprimeve me prioritetet e partneritetit European si dhe adresimi i sfidave të Raportit të Progresit 2009. Në këtë mënyrë, metodologjia e ndjekur për përgatitjen e PVPE-së 2010 ka përfshirë:

- Relevancën e veprimeve me prioritetet e partneritetit European si dhe vendosja e veprimeve konkrete dhe të realizueshme
- Adresimin e Sfidave të Raportit të Progresit
- Ndërlidhjen me dokumentet tjera strategjike të Qeverisë, si Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Plani i Punës së Qeverisë si dhe Planet e Ministrive dhe institucioneve të tjera

Disa faktorë të rëndësishëm janë marrë parasysh në përgatitjen e Planit të Veprimit për Partneritetin European 2010:

- Pavarësia e Kosovës dhe zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
- Struktura e re institucionale Europiane/ndërkombëtare e vendosur në Kosovë (ZCN/ZPBE, EULEX,)
- Ndikimi i Raportit të fundit të Progresit (tetor 2009) nga Komisioni European mbi arritjet dhe sfidat e Kosovës,
- Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidave 2009 – 2010 nga Komisioni European,
- Konkluzionet e takimeve që zhvillohen brenda procesit të DPSA-së (ish-MPSA), si dhe të gjeturat e Misioneve Homologe Vlerësuese të realizuara gjatë vitit 2009,
- Nevojat në lidhje me rishqyrtimin e prioritetëve në lidhje me shfrytëzimin e Ndihmës së Donatorëve në përputhje me rekomandimet e Partneritetit European,

Për më tepër, puna e institucioneve të Kosovës do të udhëzohet në të gjitha fushat e rëndësishme nga disa dokumente zyrtare të përgatitura dhe miratuara nga Qeveria:

- Programi i Qeverisë për periudhën 2008-2011,
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010 – 2012,
- Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2010,
- Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2010,
- Plani për Integrim European të Kosovës 2008-2010, miratuar nga Qeveria më 3 prill 2008.

Vlerësimi kryesor i rishikimit të PVPE-së 2009 është së numri i veprimeve është ulur nga 1600 në 1000 veprime. Kjo nuk është bërë vetëm për të zvogëluar numrin por për të ngritur cilësinë e këtij dokumenti. Në këtë aspekt duhet të kihet parasysh së janë përmbushur rreth 30% të veprimeve, dhe së janë fshirë një numër i tyre për shkak së nuk kanë qenë relevante me prioritetet e partneritetit European. Në procesin e rishikimit të PVPE-së janë përfshirë rreth 51 institucione qeveritare dhe institucione tjera si dhe më tepër së 300 zyrtarë, duke përfshirë edhe udhëheqës të institucioneve të ndryshme. Procesi i rishikimit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe aspektit të lidhjes me dokumentet tjera strategjike dhe dokumentet sektoriale për çka do të flitet në seksionin 4 të këtij dokumenti. Një numër i veprimeve u është ndryshuar afati dhe kanë mbet të njëjta, por edhe janë shtuar më shumë së 200 veprime të reja në saje të adresimit të sfidave të Raportit të Progresit.

Pjesa narrative e PVPE-së 2010 ka ndryshuar shumë për nga struktura e versioneve të kaluara, kjo me qëllim që të prezantojmë një dokument sa më koncizë dhe të lexueshëm. Në vijim është paraqitur një pasqyrë e shkurtër e zbatimit të PVPE-së 2009, dhe adresimit të sfidave të Raportit të Progresit 2009.2

### **3. ZBATIMI I PVPE-së 2009 DHE ADRESIMI I SFIDAVE TË RAPORTIT TË PROGRESIT**

#### **3.1. KRITERET POLITIKE**

##### **3.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT**

###### ***a. Kuvendi***

Në drejtim të adresimit të sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2009 që theksojnë mungesën e kapaciteteve administrative të Komisioneve të Kuvendit, me fokus në ngritjen e kapaciteteve administrative e financiare dhe të shkathtësive teknike të Komisionit për Integrim European në shqyrtimin e projektligjeve, janë paraparë veprime që parashohin punësimin e stafit profesional me ekspertizë në çështjet Europiane në kuadër të Komisionit për Integrim European dhe Divizionit për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor.

---

2 Një pasqyrë të plotë të kornizës legjislativë dhe institucionale në të gjithë sektorët që përfshinë Partneriteti European e jep *Plani i Veprimit 2009 për Implementimin e Partneritetit Evropian për Kosovën*, fq. 122 – 129

Me qëllim të përmirësimit të punës së Kuvendit është iniciuar procesi i ndryshimplotësimit të Rregullores mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit, e cila është miratuar më 29 prill 2010.

Prioritare në punën e Kuvendit mbetet çështja e përmirësimit të mbikëqyrjes së ekzekutivit, përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit në mes të Komisionit për Integrim Europian dhe Ministrisë së Integritimit Europian, kjo me qëllim të përmirësimit të koordinimit të aktiviteteve përkatëse në kuadër të këtij procesi.

#### ***b. Qeveria***

Në fushën e qeverisjes është shënuar progres, sidomos sa i përket procesit të decentralizimit që është një nga prioritetet kyçe të Partneritetit Europian.

Gjatë procesit të rishikimit janë shtuar veprime të reja të cilat burojnë nga Strategjia Legjislative e Qeverisë për vitin 2010 dhe të cilat ndërlidhen me rregullimin e konfliktit administrativ dhe të pagave të zyrtarëve publikë.

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-ministor mbetet sfidë, në këtë kuadër Kuvendi i Kosovës në sencanën e 13 majit 2010 ka miratuar Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin për Pagat e nëpunësve Civilë, dhe pritet që shpejt të miratoj edhe ligjin për Qeverinë të cilat janë ligje bazike për reformën e administratës publike.

#### ***c. Administrata Publike***

Tri projektligjet e përmendura (Ligji mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji mbi Qeverinë dhe Ligji mbi Pagat e nëpunësve Civilë) janë kyçe në reformën e përgjithshme të administratës së Kosovës. Mbetet që brenda vitit 2010 këto tri ligje bazike të miratohen dhe të nxirren aktet nënligjore për zbatimin e tyre, të cilat janë të domosdoshme për reformimin e administratës publike. Këto ligje do të mundësojnë rritjen e pavarësisë së shërbimit civil nga ndikimi i mundshëm politik dhe do të qartësojnë pozitën e shërbyesve civilë nga ata politikë. Me rëndësi prioritare dhe që ndërlidhet me pengimin e ndërhyrjeve politike në emërimin e shërbyesve të lartë civilë, do të jetë përcaktimi i kompetencave dhe procedurave të institucioneve bazuar në Ligjin mbi Shërbyesit Civilë sa i përket emërimeve në poste të larta publike.

Gjithashtu në vazhden e reformës së administratës publike është aprovuar PVRAP-i, rishikuar si dhe është përfunduar pjesa më e madhe e rishikimeve horizontale dhe vertikale të strukturave organizative të institucioneve. Megjithatë prioritet afatshkurtër mbetet që institucionet të fillojnë zhvillimin e implementimit të rishikimit funksional.

Përveç prioritetit afatshkurtër që ka të bëjë me implementimin e rishikimit funksional, janë vendosur edhe veprime që ndërlidhen me kompetencat e IKAP-it të cilat duhet të mbështeten dhe nxirren bazuar në Ligjin mbi Shërbyesit Civilë, si dhe disa veprime që ndërlidhen me e-qeverisjen dhe zgjerimin e rrjetit qeveritar të TI-së nëpër Komuna, gjë që do të përmirësoj qasjen në dokumente zyrtare dhe ngritë transparencën e punës së institucioneve.

#### *d. Sistemi gjyqësor*

Kërkesat që dalin nga Partneriteti European sa i përket Sistemit Gjyqësor kanë për qëllim forcimin e sistemit gjyqësor përmes implementimit dhe respektimit të plotë të ligjeve që sigurojnë sistemin e gjykatave dhe prokurorive efektive, të pavarura, llogaridhënëse, të paanshme dhe të lira nga influenca politike. Si veprim me rendësi në drejtim të adresimit të kësaj kërkesë mund ta veçohet përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve, proces ky që ka për qëllim emërimin dhe rrimërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke u bazuar në një sistem strikt të përzgjedhjes së kandidatëve si dhe avancimin e tyre në karrierë. Ky proces pritet të përfundoj në fund të vitit 2010. Poashtu për adresimin e prioritetit të lartpërmendur janë hartuar edhe katër ligjet reformuese gjyqësore si Ligji për Gjykatat, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe Prokuroritë të cilat gjithashtu priten të miratohen në fund të vitit 2010. Kjo pako ligjesh pritet të ndryshojë strukturën organizative të gjykatave dhe prokurorive që do të sigurojë pavarësimin dhe do të pengojë ndërhyrjet politike.

Sa i përket përpjekjeve për zbatimin e një skeme eficiente për mbrojtjen e dëshmitarëve po punohet drejt krijimit të bazës ligjore duke filluar me hartimin e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, krijimin e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve si dhe funksionalizimit të kornizës institucionale përmes ndërtimit të burgut për dëshmitarë të mbrojtur.

Gjithashtu, në periudhën afat-shkurtër synohet që të zbatohet plotësisht sistemi i automatizuar për menaxhimin e rasteve përmes mbështetjes së përdoruesve në zbatimin e softuerit të instaluar nëpër gjykata dhe prokurori.

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të Qeverisë në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme pa ndikime politike është siguruar sistemi i softuerit të nevojshëm për krijimin e bazave të të dhënave dhe arkivave elektronike për të bartur të dhënat nga DD/UNMIK në MD. Për plotësimin e prioritetit të lartpërmendur është hartuar Ligji për Mjekësi Ligjore i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2010. Ndërsa pritet që gjatë vitit 2011 të përfundojë ristrukturimi dhe riorganizimi i MD-së, bazuar në raportin e Rishikimit Funksional.

Me qëllim të arritjes së standardeve Europiane në çështjet e kriminalistikës penale dhe kërkesave për ekstradim është bërë organizimi i brendshëm i Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar si dhe kompletimi i kornizës ligjore. Gjatë këtij viti në bazë të strategjisë legislative janë paraparë të hartohen 4 Projektligje (PL) në këtë fushë, dhe atë: PL për ekstradim, PL për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë, PL për transferimin e personave të dënuar dhe PL kundër rrëmbimit ndërkombëtarë të fëmijëve.

Me qëllim të përmirësimit të sistemit të burgjeve fokusuar në sigurinë kontrollin, skemave për ri-integrim dhe kushteve objektive është duke u bërë riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese në burgje, ngritja profesionale e të dënuarve dhe përgatitja për ri-socializim. Po ashtu, në proces të vazhdueshëm janë duke u mbajtur trajnime për gjyqtarë në fushën e shërbimit sprovues për të mitur dhe është duke u hartuar programi i veçantë për ri-integrimin e të miturve pas lirimit nga vuajtja e dënimit.



Në periudhën afatmesme synohet që të plotësohen të gjitha kërkesat që dalin nga Partneriteti Europian dhe Raporti i Progresit për Kosovën duke u fokusuar në plotësimin e kornizës ligjore dhe institucionale përmes rekrutimit të numrit të nevojshëm të stafit administrativ nëpër gjykata, bazuar në analizën mbi numrin e nevojshëm të tyre, hartimin e rregullave mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave dhe prokurorive në përputhje me Ligjin e ri mbi Gjykatat dhe Prokuroritë, si dhe ndërtimin e objekteve të nevojshme për plotësimin e nevojave hapësinore si: ndërtimi i shtëpisë së përkohshme të sigurt, ndërtimi i burgut të sigurisë së lartë, ndërtimi i dy objekteve për nevojat e MD-së (në Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë) si dhe ndërtimi i objektit të Prokurorisë së Qarkut dhe asaj Komunale në Pejë.

#### ***e. Politikat kundër korrupsionit***

Gjatë periudhës që mbulon rishikimi i PVPE-së 2009, njëra ndër arritjet kryesore në fushën e politikave kundër korrupsionit ka qenë miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit (2009-2011). Për më tepër, AKK është angazhuar gjithashtu në avancimin e monitorimit të zbatimit të kësaj Strategjie përmes përgatitjes së matricave relevante.

Në kuadër të adresimit të prioritetit që kërkon luftimin e korrupsionit si dhe krijimin dhe konsolidimin e institucioneve të cilat do të ndikonin në zbatimin e legjislacionit, deri në fund të vitit 2010 pritet kompletimi i kornizës ligjore duke ndërmarrë masa për të siguruar pavarësinë dhe funksionimin e institucioneve relevante, përfshirë harmonizimin e kësaj kornize me standardet Europiane. Për adresimin e prioritetit të lartpërmendur janë bërë përpjekje për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, gjithashtu është miratuar Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Rregullt të Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë në institucionet publike, si dhe në vazhdimësi është duke u bërë monitorimi i rasteve të pranimit të dhuratave nga zyrtarët publikë në pajtim me Ligjin Kundër Korrupsionit.

Për më tepër, gjatë periudhës së rishikimit, janë bërë përpjekje edhe për ngritjen e shkallës së bashkëpunimit ndër-institucional përmes nënshkrimit të MM-ve në mes AKK dhe Institucionit të Ombudspersonit.

Në anën tjetër sa i përket themelimit të një mekanizmi për ruajtjen e të dhënave për luftën kundër korrupsionit planifikohet të zhvillohet një regjistër i hetimeve, dënimeve, ndjekjeve penale në rastet kundër korrupsionit, gjë që do të përcillej me zhvillimin e trajnimeve në fushën e zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë dhe pranimit të dhuratave.

Ajo çfarë mbetet si prioritet i paadresuar nga institucionet relevante është zhvillimi i një koncepti për vënien në përdorim të një sistemi strategjik sektorial në luftimin e korrupsionit.

### **3.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE**

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetare që janë të njohura me të drejtën ndërkombëtare janë direkt të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe pas deklarimit të pavarësisë, miratimi i legjislacionit në këtë fushë është një nga prioritetet më të larta për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të kompletimit të kornizës institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, 30 Komuna të Republikës së Kosovës kanë themeluar Njësitë për të Drejtat e Njeriut, kurse deri në përfundim të vitit 2010 pritet të funksionalizohen NDNJ-të në të gjitha Komunat si dhe të implemetohet programi për ngritjen e kapaciteteve të NDNJ-ve në nivel lokal.

Me qëllim të matjes së zbatueshmërisë, MAPL ka përgatitur pyetësorin për komunat për zbatimin e strategjive, planeve të veprimit dhe politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe është përgatitur raporti përkatës që mbulon gjashtëmujorin e parë 2009, i cili është publikuar në ueb-faqen e MAPL-së.

Sa i përket luftimit të dhunës në familje, nga aspekti i kompletimit të kornizës ligjore Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin kundër Dhunës në Familje dhe ka kaluar leximin e parë në Parlamentin e Kosovës. Në anën tjetër Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit kundër Dhunës në Familje është finalizuar dhe është dërguar në Qeveri për aprovim.

Me qëllim të zbatimit sa më efektiv të Ligjit Kundër Diskriminimit, është publikuar raporti i aktiviteteve për periudhën janar - qershor 2009 (ZQM), si dhe do të organizohen fushata të vetëdijesimit lidhur me promovimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Gjithashtu ZÇK do të ndërmarrë hapat për të siguruar përfaqësimin e barabartë dhe proporcional të komuniteteve jo-shumicë në Shërbimin Civil të Kosovës si dhe ndërmarrjet publike.

Sa i përket kompletimit të kornizës ligjore parashihet të përfundoj procesi i hartimit dhe miratimit të UA-së për Ofrimin e Shërbimeve në Komunitet (shtëpi për personat me aftësi të kufizuara mendore).

Me qëllim të adresimit të prioritetit për përmirësimin e të drejtave të fëmijëve, me Vendimin nr. 07/69 të datës 19 qershor 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe ka marrë Vendim Nr. 05/78 të dt .13/08/2009, për hartimin e Programit dhe Planin e Veprimit për Parandalimin e Vetëvrasjeve dhe Vetëdëmtimit në Kosovë për periudhën (2010-2013).

Sa i përket kornizës ligjore mbi lirinë e të shprehurit më 22 korrik 2009 ka përfunduar faza e dorëzimit të aplikacioneve për licencimin afatgjatë, kurse gjatë vitit 2010 do të amandamentohet Kodi i Sjelljes për Mediat Elektronike, i cili do t'i përfshijë të gjitha shërbimet audio-vizuale.

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut si dhe promovimit për kthim të qëndrueshëm të komuniteteve pakicë, gjatë vitit 2009, projekti për kthimin e organizuar në Klobukar ka përfunduar ndërsa të tjerët janë në vazhdim të realizimit. Gjithashtu zyret komunale për të drejtat e njeriut vazhdojnë të merren me promovimin e të drejtave të njeriut përmes dialogut ndër-etnik në mes të të gjitha komuniteteve.

Deri më tani 20 komuna kanë vënë në fuqi, bazuar në UA 2007/06, Rregulloret për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Nivel Lokal dhe në vazhdim pritet të kompletohet ky proces edhe në komunat e mbetura si dhe do të përkthehen

dokumentet e lëshuara në gjuhët zyrtare nga Komunat, siç parashihet nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve.

Në fushën e Trashëgimisë Kulturore është themeluar Këshilli për Trashëgimi Kulturore, më 27 Shkurt 2009 dhe gjer më tani ka zgjedhur kryesinë dhe ka miratuar Rregulloren e tij të Punës, dhe gjatë vitit 2010 pritet të funksionalizohet. Poashtu gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 parashihet themelimi i Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore, si dhe ngritja e kapaciteteve administrative të tij.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të Ligjit mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura janë hartuar dokumente strategjike dhe planifikuese (Plani i Veprimit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura si dhe Plani për hartimin e Ligjit mbi Qendrën Historike të Prizrenit dhe të Ligjit për Hoqën e Madhe, si dhe koncept-dokumenti mbi këtë të fundit). Do të organizohen fushata për ngritjen e vetëdijes së të rinjve, administratës publike dhe pronarëve mbi vlerat e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu aktivitetet me rëndësi gjatë vitit 2010 në këtë fushë është restaurimi dhe konservimi i Kalasë së Prizrenit.

Në Mars të vitit 2009 është bërë harmonizimi i dokumenteve strategjike mbi planifikimin hapësinor (Planit Hapësinor të Kosovës, si dhe planeve përkatëse zhvillimore dhe atyre urbane komunale) me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë Zonat e Veçanta të Mbrojtura, si dhe është hartuar broshura me informacione teknike mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura në shtator 2009.

Për të lehtësuar dhe nxitur kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga të gjitha komunitetet, vazhdon Programi “RRK” (Ndihma e Qëndrueshme për Kthimin e Pakicave në Kosovë Plus) për 4 pilot-komuna. Kurse, sa i përket finalizimit dhe riparimit të pronave të dëmtuara dhe shkatërruara në ngjarjet e marsit 2004, përfshirë objektet historike dhe religjioze, do të vazhdojë puna e KIR-it për riparimin e 34 tërësive ortodokse serbe.

Për t’u adresuar çështja e rregullimit të vendbanimeve joformale dhe gjetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme për akomodim dhe integrim të pjesëtarëve të komunitetit rom të cilët jetojnë në kushte të rrezikshme, gjatë vitit 2010 do të hartohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Rregullimin e Vendbanimeve Jo-formale.

Tek forcimi i strukturave administrative dhe mekanizmave përgjegjës pranë MKK-së, në pjesën e parë të vitit 2010 do të miratohet Strategjia e Përgjithshme dhe Plani i Veprimit i MKK-së 2009-2013 si dhe “Doracaku për kthim të Qëndrueshëm”. Me qëllim të shmangies së mbivendosjes së kompetencave dhe për një koordinim dhe bashkëpunim më efektiv, do të bëhet qartësimi i përgjegjësive mes MKK-së dhe ZCK/ZKM-së.

### **3.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE**

Bashkëpunimi rajonal mbetet njëra nga fushat që përballet me sfida në rritje të natyrës politike, të cilat duhet adresuar në mënyrë më strategjike përmes një qasjeje koherente dhe gjithëpërfshirëse, në veçanti duke pasur parasysh ndryshimet institucionale në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet me jashtë pas Shpalljes së Pavarësisë. Me qëllim të adresimit të sfidave të përmendura në kontekstin e fuqizimit

të bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, veprimet afatshkurtra fokusohen në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për përfaqësim të jashtëm, bashkëpunim rajonal dhe anëtarësim në organet dhe organizatat ndërkombëtare, dhe të një udhëzuesi për të siguruar pjesëmarrje aktive në nismat e bashkëpunimit rajonal, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional, në veçanti për adresimin e problemeve politike në këtë aspekt.

Sa i përket legjislacionit, është planifikuar hartimi dhe miratimi i Ligjit për Bashkëpunim dhe Partneritet Ndër-komunal, kurse në nivelin e ndërtimit të institucioneve dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale parashihet ngritja e kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe lokale për hartimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar, me fokus në sektorin e turizmit dhe atë të infrastrukturës. Në sektorin e energjisë, veprimet përkatëse parashohin vazhdimin e implementimit të Marrëveshjes me Shqipërinë, nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla me Maqedoninë dhe Malin e Zi, si dhe zhvillimin e një udhërrëfyese për transpozimin e Direktivave të BE-së për efikasitet të energjisë.

Në nivel më të përgjithshëm politik, do të vazhdojë pjesëmarrja aktive në punën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC). Në sektorin e tregtisë, rëndësi kyçe do t'i kushtohet zbatimit të prioritetit të Partneritetit European mbi Marrëveshjen mbi Hapësirën për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Sa u përket kapaciteteve institucionale, do të vazhdojë ngritja, zhvillimi dhe ristrukturimi i kapaciteteve, përfshirë rritjen e numrit të stafit, kurse në nivelin e implementimit do të vazhdojë zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, me theks të veçantë në raportimin efektiv të partnerët dhe akterët e tjerë relevantë në lidhje me shkeljen e saj nga cilido partner në raport me Republikën e Kosovës, përcjellja e rregullt e eksportit dhe importit të Kosovës me anëtarët e CEFTA-së, përcjellja e rregullt e shkëmbimeve tregtare me këto shtete, përfshirë përmes takimeve të rregullta me bizneset vendore dhe kompanitë nga këto shtete dhe anketimit të të dy grupeve lidhur me barrierat jo-tarifore në kontekstin e kësaj Marrëveshjeje, identifikimi dhe propozimi të mekanizmat drejtuese të CEFTA-s dhe akterët e tjerë relevantë ndërkombëtarë i çështjeve që lidhen me eliminimin e barrierave jo-tarifore me vendet nënshkruese të CEFTA-së, si dhe transpozimi dhe zbatimi i kornizës ligjore që përmbyll fazën e parë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit (ECAA). Së fundi, në fushën e sundimit të ligjit, do të vazhdojë nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale mbi ndihmën juridike ndërkombëtare në çështjet penale e civile.

### 3.2 KRITERET EKONOMIKE

Përmirësimi i politikave fiskale mbetet nga sfida të veçanta të Kosovës lidhur me zbatimin e prioriteteve të partneritetit European. Në kuadër të përmirësimit të politikave fiskale gjatë muajit tetor 2009 është përgatitur korniza makro-fiskale 2010 - 2014 e cila kornizë ka qenë bazë mbi të cilën është hartuar edhe buxheti për vitin 2010. Veprimi në fjalë vazhdimisht azhurnohet si dhe projektohet në vazhdimësi dhe janë të përfshira në KASH dhe të publikuara në buletin gjysmë vjetor makroekonomik.

Mekanizimi i Mbikëqyrjes Fiskale tashmë është funksional, andaj nevojitet vetëm koordinimin i takimeve dhe i raportimit të ky mekanizëm. Mekanizmi i Mbikëqyrjes fiskale analizon dhe shqyrton të gjitha politikat me ndikim fiskal dhe nuk kufizohet vetëm në ato sociale. Secili ligj dhe propozim nga të gjitha sferat tanimë bëhet vlerësimi i ndikimit fiskal të tij. Në këtë rrafsh janë bërë të gjitha vlerësimet e ndikimeve fiskale për të gjitha ligjet në sferën sociale.

Sa i përket analizës së niveli të shportës ushqimore dhe të krahasimit me shkallën e ndihmës sociale, MPMS ka bërë disa përpjekje gjatë vitit 2009 në bashkëpunim me ESK-në. Si rrjedhojë, është ardhur në përfundim së Qeveria dhe MEF duhet të marrë rolin iniciues duke themeluar grupin punues ndërministror për caktimin e nivelit të shportës ushqimore dhe të krahasimit me shkallën e ndihmës sociale.

Më qëllim të trajtimit sa më të mirë të varfërve në muajin mars 2009 grupi punues ka bërë propozime për ndryshime në Ligjin e Skemës së Ndihmës Sociale të cilat janë proceduar për në Qeveri. Me këto ndryshime ndihma sociale do të mund të orientohet dhe lehtësoj mirëqenien kryesisht tek familjet shumë anëtarëshe dhe me varfëri të theksuar. Gjithashtu do të përfitojë edhe një kategori e familjeve dhe individëve që janë të cenuara dhe të rrezikuara nga përjashtimi social, si dhe është propozuar një përfitim shtesë për familjet që kanë fëmijë në moshë shkollore (6-18 vjeç). Projektligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit të SNS-së është aprovuar nga Qeveria në Prill 2009, ende është në shqyrtim në Parlamentin e Kosovës.

Në vazhden e përmirësimit të nivelit të faturimit dhe inkasimit ka filluar të zbatohet projekti për përmirësimin e faturimit dhe inkasimit fillimisht në Distriktin e Ferizajt si pilot projekt në Shtator 2008 dhe mandej ka vazhduar në të gjitha Distriktet tjera. Në muajin shkurt të këtij viti ka filluar implementimi i këtij projekti në distriktin e Prishtinës. Sipas planit të gjithë punonjësit i nënshtrohen performancës individuale dhe çdo muaj bëhet vlerësimi individual. E gjithë energjia në dispozicion për konsumatorët, e ndarë sipas trafo-daljeve, matet dhe për të është i ngarkuar specialisti i daljes në bazë të së cilës energji edhe rishikohet për çdo muaj performanca individuale e tij. Krejt kjo bëhet duke u bazuar në Rregulloren e aprovuar për operacionet në Distrikte.

Deri më 30 dhjetor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka shpallur 11 valë të privatizimit duke krijuar 118 Ndërmarrje të Reja. Një numër i Ndërmarrjeve të Reja mund të rritet për shkak të tenderimeve të sërishme dhe gjithashtu për shkak të burimeve të disponueshme për përgatitjen e më shumë Ndërmarrjeve të Reja për vitin 2010. Misioni dhe strategjia e AKP-së nuk do të ndryshojë. AKP-ja do të shes,

transferojë dhe likuidojë pa u vonuar dhe do të këmbëngulë në detyrën e shpërndarjes së fondeve të mirëbesimit tek kreditorët, punëtorët dhe pronarët sa më shpejtë që të jetë e mundur. Gjithashtu, Bordi i Drejtoreve të AKP-se ka aprovuar vendimin për rifillimin e procesit të likuidimit.

AKP-ja do të filloj të bëjë një rishqyrtim me qëllim që të vlerësoj rezultatet e privatizimit dhe përfundimisht likuidimit të të gjitha NSH-ve. Aty ku privatizimi nuk është një alternativë, do të planifikohet likuidimi. Në të gjitha 599 NSH-të, likuidimet do të jenë planifikuara të ndjekin privatizimin në mënyrë që të kristalizojnë vlerën dhe përparësitë e ankesave që do të pasohen nga shpërndarja e fondeve tek ankuesit. Në baza të përgjithshme, privatizimet dhe likuidimet do të planifikohen gjatë periudhës mbi 3 vjeçare në baza tremujore. Pasi aktivitetet të kenë përfunduar, kjo do të rishikohet dhe të azhurnohet në baza vjetore. Plani fillestar i AKP-së për vitin 2009, ishte për të nxitur përparimin e likuidimeve për të lehtësuar shpërndarjen e parave nga likuidimi të mbajtura në mirëbesim, por për fat të keq, Komisionet e Likuidimit të AKP-së ligjërisht nuk mund të funksionojë pa prezencën e të emëruarve nga Zyra Civile Ndërkombëtare. Pa Komisionet e Likuidimit, likuidimi nuk mund të fillojë, përparoj ose përfundoj. Si pasojë nuk është bërë përparim me 120 likuidimet ekzistuese të filluara nga ish-Agjencia, më shumë se 3 vite më parë.

AKP është duke vazhduar me një ritëm të përsheptuar shpalljen e listave fillestare dhe atyre përfundimtare të punëtorëve të ligjshëm për 20%, si dhe shpërndarjen e 20% për ato lista për të cilat AKP ka pranuar vendimet përfundimtare nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Projektligji për Miniera dhe Minerale i cili do të zëvendësoj Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005\2 dhe 200\3 gjendet në fazën e shqyrtimit në Komision parlamentar, pasi që është bërë shqyrtimi i parë nga Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 2009.

Është përgatitur drafti i parë i rregullores për tarifën e licencimit dhe certifikimit. Pasi që nuk ka çështje të hapura, së shpejti do të filloj konsultimi me grupet e interesit i cili parashikohet të realizohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2010. Njëkohësisht është themeluar Bordi Mbikëqyrës jo-ekzistues për ARAC për të mundësuar pavarësinë operacionale të ARAC-së.

Lidhur me implementimi i plotë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit dhe Ligjit të KE-së mbi Aviacionin, të gjitha kërkesat e fazës së parë të implementimi të Marrëveshjes ECAA, përveç legjislacionit përkatës për ndihmat shtetërore dhe direktivës Europiane 2003/88 mbi organizimin e orarit të punës, janë përfunduar. Është përfunduar edhe një numër i madh i kërkesave nga faza e dytë.

Pas vendimeve të Qeverisë mbi emërimet e bordeve të drejtorëve për NP, MEF me ndihmën e këshilltarëve të USAID-it dhe KE-TAIEX ka organizuar tri sesione trajnimi për Bordet e Drejtorëve me temat Qeverisja Korporative në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike të NP-ve, si dhe trajnimi i Komisioneve të Auditimit të NP-ve. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për përbërjen e Bordeve të NP-ve lokale që ofrojnë shërbime në 2 apo më tepër komuna, është përfunduar.

Në përpjekjet për futjen e kapitalit privat në sektorin publik, janë formuar Komisionet Ministrorë për pjesëmarrjen e sektorit privat në ANP, KEK, dhe PTK.

Sa i përket, formimit të komisioneve të auditimit me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare, Komisionet e auditimit janë themeluar në të gjitha NP-të.

Në lidhje me procesin e definimit të statusit të ndërmarrjeve publike, deri më tani është përfunduar përpilimi i statutit të këtyre ndërmarrjeve. Gjithashtu është plotësuar stafi në Njësinë për Politika dhe Monitorimin e NP-ve.

Në bashkëpunim me organet mbikëqyrëse janë realizuar inspektime të rregullta subjekteve punuese. Inspektimet përsëriten sipas kërkesës së palëve për realizimin e të drejtave nga puna dhe punësimi. Me qëllim të rritjes së efikasitetit, është e nevojshme dhe e domosdoshme krijimi i kushteve për punën e inspektorëve të punës (Sigurimi i zyrave të përshtatshme, mjeteve për punë, mjeteve për komunikim dhe logjistikë).

Nga Inspektorati i punës janë kryer 1015 kontrollime të subjekteve punuese, nga të cilat 183 kontrollime janë përsëritur, ndërsa 142 inspektime si dhe 120 inspektime të përbashkëta me organet tjera të mbikëqyrjes janë kryer sipas kërkesave të palëve. Ndërkohë palëve ju janë shqiptuar 175 vërejtje me shkrim, janë nxjerr 313 aktvendime bazuar në raportet zyrtare të hartuara ku pasqyrohet gjendja faktike si dhe janë shqiptuar 38 gjoba.

### **3.3 STANDARTET EUROPIANE**

#### **3.3.1 TREGU I BRENDSHËM**

##### ***a. Lëvizja e lirë e mallrave***

Vizioni i Qeverisë në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave është krijimi i kushteve sistemore për tregti, industri, krijimi i politikave të punës dhe zbatimi i legjislacionit për përkrahjen e konkurrencës korrekte, hartimin e programeve dhe legjislacionit për përkrahjen e ndërmarrjeve industriale, tregtare, turistike dhe politikave zhvillimore të sektorit privat, mbështetjen e investimeve në Kosovë duke siguruar informacione dhe ndihmë në sigurimin e dokumenteve (leje, autorizime) të nevojshme për investime për investitorët vendas dhe të huaj dhe publikimin e të dhënave të investimeve të huaja në Kosovë, shenjen e rekomandimeve për çështje të privatizimit, administrimin e regjistrimit të regjistrimit të bizneseve.

Kosova është në procesin e hapjes së dosjes së plotë të tregut të brendshëm, si dhe do të sigurojë që secili akt relevant i BE-së do të transpozohet në mënyrë korrekte në kornizën ligjore të Kosovës, duke themeluar strukturën e fuqishme e të aftë të implementojë atë legjislacion, në pajtim me praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE-së. Kosova është në procesin e themelimit të kornizës ligjore horizontale mbi lëvizjen e lirë të mallrave. Ligji mbi Metrologjinë, si dhe Ligji mbi Inspektoratin e Tregut janë hartuar në frymën e legjislacionit evropian. Gjithashtu, një pjesë e standardeve evropiane tanimë është transpozuar, bashkë me transpozimin e disa Direktivave të Qasjes së Re: Direktiva 98/37/EC mbi Makinat që është transpozuar përmes UA Nr. 2007/16 mbi Rregullat Teknike për Makineri dhe elementet e tyre të sigurisë; Direktiva 73/23/EEC mbi Pajisjet elektrike me presion të ultë, e transpozuar

si UA Nr. 2005/28 për Rregullat Teknike për Pajisjet Elektrike të dizajnuara për përdorim në disa presione.

Duke filluar nga raporti i progresit të vitit të kaluar në këtë departament janë paraparë që në vitin 2010 të bëhet ndryshimi i Ligjit për Metrologjinë 02/L-34. Janë hartuar dhe miratuar disa Udhëzime Administrative si: Udhëzimi Administrativ Instrumentet Matëse të Masës – Peshoret Jo-automatike të Klasës së Saktësisë I,II,III, IV, Hartimi i Udhëzimit Administrativ për Kushtet Metrologjie për Produktet e Para- paketuara dhe të atij për Njësit Matëse. Gjithashtu është paraparë hartimi dhe miratimi i Strategjisë Zhvillimore të Sistemit të Metrologjisë 2010-2014; Certifikimi i Departamentit të Metrologjisë sipas ISO 9001.

Akreditimi – akreditimi u ofron të gjitha palëve të interesuara akreditimin mbi bazën e rregullave të përcaktuara në ligje dhe standarde. Për vitin 2010 është paraparë që të bëhet akreditimi i edhe 11 organizmave për vlerësimin e konformitetit, gjë që është parashtruar si kërkesë ne Raporti i Progresit të vitit 2009, do të punohet ne funksionalizimin e sistemit të cilësisë sipas kërkesave të ISO/IEC 17011, si dhe do të shqyrtohet mundësia e anëtarësimit të Departamentit të Akreditimit të Kosovës në Institucione rajonale dhe Ndërkombëtare. Këtu duhet theksohet gjithashtu që edhe përkundër mungesës së subjektivitetit për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, do të vazhdohet me nënshkrimin e marrëveshjeve të mirëkuptimit me vendet e rajonit si me; Malin e Zi, Sllovenin, Kroacinë, dhe Bosnjën e Hercegovinën.

Standardizimi – me anë të fushës së standardizimit Qeveria ka për qëllim: të kontribuoj në bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesit dhe veprimit me konsensus në hartimin, adoptimin dhe adaptimin e standardeve Europiane dhe ndërkombëtare; të plotësoj kërkesat e anëtarësimit në ISO/IEC dhe CEN/CENELEC; të avancoj standardizimin kosovar në nivelin e organizmave homolog regjional dhe Europian. Për vitin 2010 ku njësit ka paraparë që të miratoj Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kosovare për Standardizim; miratimin e 2000 Standardeve Europiane dhe ndërkombëtare; Hartimin dhe Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit të Standardizimit; krijimin e një data baze për standardet e miratuara.

Ngrija e kapaciteteve njerëzore për inspektoratin e tregut shihet si sfidë e cila gjithashtu është ngritur si çështje ne Raportin e Progresit të vitit 2009, kjo për faktin së ky njësit këtë vit parasheh ngritjen e kapaciteteve njerëzore nëpër komuna duke rekrutuar inspektor të rinj në inspektoratet komunale.

Sa i përket infrastrukturës ligjore, këtë vit do të bëhet miratimi i projektligjit për Inspektoratin e Tregut, hartimi i strategjisë nder-sektoriale për Inspektoratin e Tregut dhe Mbrojtjen Konsumatorëve, hartimi i Udhëzimit Administrativ për Organizimi edhe Funksionimin e Inspektoratit të Tregut, krijimin e standardeve për Njësitë Akomoduese dhe Agjencitë Turistike.

Departamenti i Ndërtimtarisë - kujdeset për mbarëvajtjen e Zhvillimin e Industrisë Ndërtimore, Hartimin dhe aplikimin e akteve ligjore për normat teknike në industrinë ndërtimore, Mbikëqyrja, funksionimi dhe inspektimi i industrisë ndërtimore, Mbikëqyrja dhe inspektimi i prodhimit të produkteve të ndërtimit, Mbikëqyrja dhe inspektimi i tregut të produkteve ndërtimore, Kontrolli e atestove për produktet



ndërtimore, Licencimi i ndërmarrjeve për punë ndërtimore, ndërmarrjeve për prodhim të materialit ndërtimor, ndërmarrjeve projektuese dhe laboratorët për ekzaminimin e provave të produkteve ndërtimore. Për vitin 2010 ndërtimtaria parasheh autorizimin e trupave për vlerësimin e komformitetit si dhe nderimin e Institutit për Materiale Ndërtimore.

Departamenti i Tregtisë në kuadër të kompetencave të veta ushtron, përcjell, sugjeron dhe analizon çështje si: krijimi i kornizës ligjore të përshtatshme dhe të harmonizuar me OBT-në; Angazhimin permanent i MTI-së për inkuadrim të Kosovës në iniciativat dhe projektet rajonale, si dhe mundësinë e krijimit të zonës së lirë tregtare në territorin e Kosovës; Hartimin dhe zbatimin e politikave për tregti të jashtme dhe të brendshme; Ushtron punët rreth licencimit të importit dhe eksportit nga fushë veprimtaria e vet; Zbatimin e masave për mbrojtjen e konsumatorit; Konkurrencën në tregun vendor; Përcjelljen e çmimeve dhe furnizimin e tregut me prodhime strategjike për konsumatorët vendorë; Lëvizjen e lirë të mallrave; Punë të tjera në kuadër të fushë veprimtarisë së vet. Ajo gjithashtu planifikon zhvillimin e veprimtarive tregtare dhe Promovon tregtinë lokale dhe ndërkombëtare. Me qëllim të realizimit të këtyre detyrave Departamenti i Tregtisë ka paraparë që në vitin 2010 të miratoj ligjin për Anti- Dumping, përmes të cilit do të bëhet implementimi Programit Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit 2009- 2014 si dhe të bëjë miratimin e Udhëzimit Administrativ për Librat Tregtare.

Me qëllim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit European në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, mes tjerash, MTI-ja do të angazhohet në krijimin e një qendre trajnuese në kuadër të Drejtorisë së Akreditimit, pranimi në EA (European Corporation for Accreditation), IAF (Internacional Accreditation Forum) dhe ILAC (International Laboratory Accreditation Cooperation); nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale; kompletimin e kornizës legjisacionit sekondar; implementimin e strategjisë për zhvillimin e sistemit metrologjisë 2009-2013; anëtarësimi në Organizmat rajonal dhe ndërkombëtare për metrologji; anëtarësimi në OBT si dhe anëtarësimi në të gjithë mekanizmat ndërkombëtar si anëtare e përhershme me të drejta të plota dhe ndërtimi i Qendrës së Panaireve.

Poashtu do të zhvillohen aktivitete si në vijim: hartimi i udhëzimeve administrative për materiale ndërtimi sipas prioriteteve që do të përcaktohen, ngritja e kapaciteteve prodhuese, tregtues dhe certifikuese të materialeve të ndërtimit, ndërtimi dhe funksionalizimi i Institutit të materialeve të ndërtimit dhe furnizimi i laboratorëve të institutit me aparatura dhe pajisje, anëtarësimi me të drejta të plota në ISO/IEC dhe anëtarësimi në nivelet fillestare të CEN/CENELEC.

#### ***b. Lëvizja e lirë e kapitalit***

Institucioni përgjegjës në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).

Për vitin 2010 Banka Qendrore ka parapare të bëjë avancimin e kornizës ligjore në përputhje me praktikën me të mira ndërkombëtare si dhe të asaj të BE-së, duke përgatitur Projektligjin për Bankën Qendrore, Projektligjin për bankat, projektligjin për transaksionet e pagesave, projektligjin për sigurimet, projektligjin për sigurimet e detyrueshme në trafik, projektligjin për Fondin Pensional të Kosovës. Ajo gjithashtu ka paraparë, fuqizimin e mbikëqyrjes bazuar në risk, definimin e kornizës për

implementimin e Basel II (banka) dhe Solvenca II (sigurimet), ofrimi i shërbimeve bankare, shlyerja individuale e pagesave në kohën reale (RTGS) dhe sistemi i depozitave qendrore të letrave me vlerë (CSD). Bazuar në këto do të themelohej njëسيا për vendosjen e politikave dhe rregullave për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në Kosovë me ç'rast do të sigurohej zgjerimi i përmbajtjes së informacionit të RKK-së, Automatizimi i procesit të transaksioneve në mes të BQK-së dhe Thesarit si dhe lidhja me sistemin SWIFT. Njëkohësisht zhvillimi i një makro-modeli për ekonominë e Kosovës me qëllim të avancimit të analizave mbi vlerësimin e stabilitetit financiar shihet si prioritet i këtij viti.

### *c. Doganat dhe tatimet*

Përpos detyrimeve doganore që vilen nga Dogana, gjithashtu TVSH-ja dhe Taksa mbi akcizën vilen nëpër kufij. Përveç vjeljes së të hyrave, Dogana e Kosovës e mbron shoqërinë nga kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të krimit ekonomik si dhe evazionit në të hyra.

Dogana Kosovës është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe është i financuar tërësisht nge Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Dogana e Kosovës vjel rreth 70% e të hyrave të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës me një mesatare 2 cent për 1 euro. FMN ka lavdëruar vazhdimisht Doganën për performancën e tij, duke e krahasuar në një nivel me Administratat Doganore të Evropës Perëndimore.

Në vazhden e përmirësimit të legjislacionit në fushën e doganave në dhjetor 2009 është miratuar Ligji për Masat Doganore dhe për mbrojtje e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale. Sa i përket ndërtimit të institucioneve Dogana e Kosovës në shkurt 2009 ka themeluar Njësinë për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (DPI), krahas Rregullores 2008/22. Kurse në janar 2009 është hartuar një dokument i brendshëm i cili përcakton procedurat që duhen zbatuar për ndërmarrjen e masave doganore ndaj mbrojtjes së DPI, Qarkorja 01-2009 si dhe Formulari i kërkesës për veprim dhe Deklarata për zbatimin e masave doganore.

Më 2 shtator 2009, është nënshkruar Udhëzimi administrativ Nr. 11/2009, dhe i njëjti ka hyrë në fuqi më datën 1 tetor 2009, ky udhëzim implementon Kodin doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Harmonizimi i procedurave të brendshme është plotësuar me hyrjen në fuqi të UA, Nr. 11/2009, që implementon Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Menagjimenti i lartë ka bërë përzgjedhjen e sistemit të ri më të avancuar doganor ACYCUDA World i cili do të zëvendësojë sistemin aktual TIMS. Sistem ASYCUDA World e implementon UNCTAD dhe aktualisht është funksional edhe në Shqipëri.

Gjatë periudhës Janar - Shkurt 2010 Sektori i Standardeve Profesionale ka miratuar strategji konform, Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit në Doganat e Kosovës, me zhvillimin e procedurave disiplinore për rastet e raportuara pranë Sektorit të Standardeve Profesionale për shkelje të ndryshme të Kodit të Mirësjelljes. Gjatë kësaj periudhe janë: iniciuar 3 raste nga ana e palëve si dhe janë iniciuar 3 raste nga ana e Doganës.

Në kuadër të bashkëpunimit me autoritet doganore të vendeve tjera Dogana e Kosovës më datën 14 Janar ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Administratën Doganore të Turqisë. Dogana vazhdon të ketë bashkëpunim të mirë me administratat rajonale. Me disa prej tyre bashkëpunimi është fuqizuar me nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëpunim. Ndërsa në fazën e nënshkrimit janë edhe marrëveshjet me vendet e tjera që do të ngritin tutje nivelin e bashkëpunimit.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është themeluar më 17 janar 2000, nën administrimin e UNMIK-ut. Më 18 shkurt 2003, autoriteti për Administratën Tatimore iu transferua MEF-it. Qysh prej atëherë, ATK-ja ka funksionuar si organizatë e pavarur, menaxhuar plotësisht nga punëtorët vendorë, mbështetur nga këshillat e organizatave ndërkombëtare si USAID-i, Shtylla IV e BE-së dhe CAFAO-UNMIK nga BE-ja.

Legjislacioni tatimor është pranuar nga FMN-ja dhe Komisioni Evropian si transparent dhe cilësor. Legjislacioni i ATK-së në një masë të madhe është në përputhje me Direktivën e Gjashtë të BE-së.

***ATK-ja është përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave të qeverisë qendrore, duke përfshirë: TVSH-ne mbi furnizimin e brendshëm, Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Kontributet Pensionale dhe administrimin e Ligjit për Lojërat e Fatit.***

Administrata Tatimore e Kosovës, nga data 01 Mars 2010, ka filluar instalimin vullnetar të pajisjeve elektronike fiskale (PEF) nga operatorët e licencuar, si dhe që nga data 22 mars, 2010 është bërë edhe promovimi zyrtarë i instalimit të Arkave Fiskale.

Komisioni për Arka Fiskale i formuar nga Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, ka licencuar dy kompani (Operatorë Ekonomik janë: “Dukagjini” Sh.p.k. dhe “Gekos” Sh.p.k.), të cilat janë përzgjedhur dhe autorizuar deri me tani për shitjen e Arkave Fiskale në Republikën e Kosovës. Është bërë edhe përzgjedhja e laboratorit të autorizuar për certifikimin e pajisjeve elektronike fiskale ( Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në kuadër të Universitetit të Prishtinës). Komisioni për Arka Fiskale bazuar në raporte të laboratorit ka certifikuar disa Pajisje dhe ka konfirmuar së janë plotësuar kushtet për fillimin e instalimit dhe mirëmbajtjes së Pajisjeve Elektronike Fiskale.

Në vazhden e përmirësimit të infrastrukturës ligjore Kuvendi i Kosovës në dhjetor 2009, Ligjin mbi tatimin në të ardhurat personale, dhe Ligjin për tatimin mbi të ardhurat e korporatave. Kurse në shkurt të këtij viti ka miratuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- Ligji për 146 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Qeveria e Kosovës ka në plan që këtë vit të adresoj tutje prioritetet e partneritetit European më qëllim të harmonizimit sa më të madh të tij me legjislacionin European, si dhe të forcojë kapacitetet institucionale dhe njerëzore duke pas për qëllim uljen e nivelit të evazionit fiskal. Prioritet kryesor gjatë këtij viti mbetet vazhdimi i promovimit të arkave fiskale në tërë Kosovën.

#### ***d. Prokurimi publik***

Sa i përket prioriteteve të partneritetit European në fushën e prokurimit publik, më 15 janar 2004 u miratua Ligji mbi Prokurimin Publik (LPP) Nr. 2003/17. Më 8 shkurt 2007, u miratua Ligji për Ndryshimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 2007/02-L99. Ligji tani është në proces të ndryshimit dhe pritet që diku nga fundi i kuartalit të tretë të përfundoj. Ky ligj do të harmonizohet në pajtim me standardet Europiane dhe praktikat e mira ndërkombëtare ku do të sigurojë ndryshimet e rëndësishme, mes të cilave, shkurtime të gjitha afateve të prokurimit dhe zvogëlimin e procedurave të prokurimit nga shtatë në gjashtë. Më tutje, Ligji mbi Prokurimin Publik është thjeshtuar, derisa disa funksione të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe MEF-it i janë transferuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRrPP).

Në bazë të këtij ligji gjithashtu do të përcaktohen detyrat dhe raportet në mes të institucioneve qendrore të Prokurimit Publik në Kosovë siç janë. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Agjencia për Prokurim Publik (APP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP).

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik për vitin 2010 parasheh hartimin dhe miratimin e Udhëzuesit për Kontratat Kornize. Ajo gjithashtu parasheh mbikëqyrjen dhe monitorimin e 50 autoriteteve kontraktuese (institucioneve) lidhur me aktivitetet e tyre të kryera të prokurimit si dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë. Veprim tjetër me rëndësi është nxjerrja e rregulloreve nga ana e KRrPP-së.

Agjencia për Prokurim Publik ka paraparë që të udhëheq me procedurat e centralizuara duke identifikuar furnizimet/shërbimet e përbashkëta në nivelin qendror dhe komunal, si dhe ngritjen e sistemeve ndihmëse elektronike për pasqyrimin e aktiviteteve në APP. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) në bazë të një kërkesë - ankese me shkrim të një Operatori Ekonomik ose Autoriteti Kontraktues, është i autorizuar që ta shqyrtojë atë kërkesë - ose ankesë, konform afateve ligjore të nxjerrë një vendim me shkrim, për mënyrën e vendosjes së asaj lënde, objekt i të cilës është shqyrtimi i prokurimit publik.

Gjithashtu, OSHP ka autorizim dhe përgjegjësi që të rishikojë dhe vendos vlefshmërinë e çdo vendimi, veprimi, mase, interpretimi ose rregullimi të nxjerrë, të përdorur ose shpallur nga Agjencia e Prokurimit Publik ose KRPP. Momentalisht ky institucion ka paraparë ngritjen e kapaciteteve njerëzore për të ngritur efikasitetin e aktiviteteve shqyrtuese në fushën e prokurimit publik.

#### ***e. Të drejtat e pronësisë intelektuale***

Të drejtat e pronësisë intelektuale janë të ndara në dy nën-fusha: pronësia industriale e cila përfshin zbulimet, markat tregtare, dizajnin industrial si dhe indikacionet gjeografike të burimeve. Pronësia Industriale funksionon mbi këto Ligje të miratuara: Ligji mbi Patentat Nr. 2004/49 më 27 shtator 2004, Ligji mbi Markat tregtare Nr. 2006/02-L54 më 23 shkurt 2006, Ligji mbi Dizajnin Industrial Nr. 2005/02-L45 më 21 nëntor 2005. Si dhe janë miratuar një numër i Akteve nënligjore si: UA “Për Procedurat e Regjistrimit të Patentave”, UA “Për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare”, UA “Për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit Industrial”, UA “Për njohjen e të drejtave të objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në ish-

Jugosllavi”, UA “Për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale” dhe UA “Për Përfaqësuesit e autorizuar në Sferën e Pronësisë Industriale.

Ndërsa e ‘Drejta e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta’ e cila përfshin veprat letrare dhe artistike si novelat, filmat, veprat muzikore, pikturat, fotografitë dhe dizajnët arkitektonike funksionon në baze të Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave Autoriale dhe të drejtave tjera të përafërta Nr. 2004/45 më 29 qershor 2006. Këto njësi tanimë e kanë përfunduar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Pronësinë Intelektuale veprim i cili ishte paraparë për vitin 2010-2014.

Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përafërta është aprovuar, dhe me këtë ligje është parapare që të themelohet Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe janë paraparë veprime që do të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve administrative të po kësaj Zyre.

Për vitin 2010, këto institucione kanë paraparë që të përmirësojnë sistemin e Teknologjisë informative me qëllim të mbajtjes të bazave të të dhënave për kompanitë të cilat janë dhe do të licencohen. Ndërsa e njëjta gjë vlen edhe për të drejtën Autoriale ku të gjitha të drejtat autoriale do të mund të evidentoheshin. Këto institucione kanë bërë dhe planifikojnë që të vazhdimësi të lidhin marrëveshje bilaterale me shumë vende të rajonit.

Janë hartuar plane për organizimin e trajnimeve për gjyqësorin në lëmin e mbrojtjes së të drejtës autoriale, me qëllim që të avancohet dhe të sigurohet e drejta autoriale. Institucionet përgjegjëse janë duke analizuar Ligjin për të Drejtat e Autorit, në mënyrë që të hartojnë propozime për amendamente të nevojshme, që ky Ligj të jetë i aplikueshëm dhe në mënyrën më të mirë të mundshme të mbuloj këtë fushë. Gjatë këtij viti është paraparë Certifikimi i Subjekteve për të drejtat e autorit sipas Ligjit si dhe të përpilohen module të ndryshme për të përmirësuar kapacitetet e tyre funksionale. Poashtu, edhe Ligji për Topografitë e Qarqeve të Integruara është miratuar.

#### ***f. Punësimi dhe Politikat Sociale***

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social ka vazhduar angazhimet e veta në zbutjen e problemeve sociale, ofrimin e shërbimeve për të punësuarit në Kosovë, si dhe krijimin e kushteve për punëkërkuessit për aftësimin e tyre konform kërkesave të ekonomisë së tregut.

Sa i përket Infrastrukturës Ligjore draft Ligji i Punës është miratuar nga Qeveria e Kosovës ku pritët aprovimi i tij në Kuvend në shtator 2010, kurse Ligji për Sindikatat dhe Ligji për Grevat pritët të miratohen pas miratimit të Projektligjit të Punës në Kuvendin e Kosovës.

Ndërkaq që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu do të hartoj ligjin për Këshillin Ekonomik Social deri në shtator të këtij viti kurse Ligjet nga fusha e Skemës së Ndhmës Sociale/SNS-së dhe Shërbimeve Sociale dhe Familjare do të revidohen sipas planit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

Mbeten të përfshihen në kuadër të strategjisë legislative për vitin 2011 Projektligji për Promovimin e Punësimit dhe Ndhimën e Punëkërkesve si dhe Projektligji për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimeve Publike të Punësimit.

Gjatë vitit 2010 do të vazhdojnë angazhimet e MPMS-së, ku do të përqendrohen në aktivitetet lidhur me propozimin për ndryshimet e Ligjit të Skemës së Ndhimës Sociale dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore që të shqyrtohen dhe të aprovohen nga Kuvendi i Kosovës.

Janë hartuar dy udhëzime administrative për definimin dhe përcaktimin e procedurave të ofrimit të shërbimeve sociale dhe ndihmave sociale pas fillimit të procesit të transferit të kompetencave, të cilat priten të aprovohen nga Qeveria. Nga janari i vitit 2009 është duke u implementuar Ligji për përkrahje familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara 1-18 vjeç, ku kanë përfituar mbi 2,200 fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara.

Strategjia Sektoriale është aprovuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale si një dokument i cili ka siguruar një ndërlidhje në mes dokumenteve të politikave dhe strategjive tjera që janë hartuar nga MPMS-ja.

Në kuadër të Programit për Zhvillimin e Strategjisë së Punësimit është aprovuar Strategjia për Punësim 2010-2012 si dhe është hartuar matrica e politikave për periudhën tre vjeçare 2010-2012 si dhe plani i veprimit që janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

Me synim të adresimit të prioritetëve afatshkurtra të Partneritetit Europian në fushën e punësimit dhe të politikave sociale do të ndërmerren këto veprime: Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve fizike të ndërtimit të zyrave komunale të punësimit, meqë është në proces formimi dhe zyrtarizimi i fillimit të funksionimit të komunave të reja sipas politikave qeveritare si dhe do të ndërmerren të gjitha veprimet për transferimin e Nën/Zyrave të Punësimit në Zyra Komunale të Punësimit në këto komuna, do të fillohet me transferimin e personelit dhe inventarit sipas nevojave do të behët rekrutimi i stafit për këto zyra me qëllim të riorganizimit të zyrave Komunale të Punësimit në Komunitet të reja, për ngritjen e cilësisë së shërbimeve përmes trajnimeve të ofruara dhe nxitjen e punësimit përmes projekteve tek grupet e të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të zhvillimit dhe implementimit të shërbimeve në komunitete për personat e varur përfshirë këtu fushën e shëndetit mendor do të ofrohen shërbimet e nevojshme në përputhshmëri me nevojat e klientëve në 7 shtëpitë e komunitetit për përkujdesje të personave me aftësi të kufizuara si dhe në Institutin Special në Shtime për klient të nacionaliteteve të ndryshme, kurse në shtëpitë e komunitetit për persona të rritur me aftësi të kufizuara në Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Dardanë dhe Deçan MPMS do të vazhdon me ofrimin e shërbimeve për klientët e vendosur nëpër shtëpitë në komunitet.

Poashtu do të vazhdoj ofrimi i shërbimeve edhe për dy shtëpitë tjera të komunitetit për nevoja të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të braktisur në Graçanicë dhe Shtime. Për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare në kontinuitet ofrohen shërbimet 24-orë që kanë të bëjnë me përkujdesjen shëndetësore, ofrimin e ushqimit, shërbimet

fizioterapeutike, terapia e punës dhe shumë shërbime tjera që direkt ndikojnë në mirëqenien e këtyre personave në nevojë.

Poashtu, do të ndërmerren veprime konkrete në Instalimin e Bazës së të dhënëve në Departamentin e Institutit për Politika Sociale - për menaxhimin e të dhënave për fëmijët e identifikuar në punë në Kosovë, të identifikuar nga KLV (Komitetet Lokale të Veprimit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve) nga të gjitha komunat e Kosovës, si dhe do të punohet në ngritjen e kapaciteteve në nivelin lokal të partnerëve me qëllim të vendosjes së strukturave Lokale për MPF në të gjitha komunat e Kosovës (Krijimi i Komiteteve Lokale të Veprimit).

Në periudhën afatmesme, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit European në fushën e punësimit dhe të politikave sociale do të ndërmerren këto veprime: do bëhet ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimeve në Sektorin e Dizajnit të Politikave të Punësimit, me qëllim të përgatitjes së planeve dhe projekteve konkrete të punësimit, parashihet ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimeve në Sektorin e statistikave të informimit dhe analizave të tregut të punës, do të punohet në hartimin e projekteve për ngritjen e shkallës së punësimit për këto grupe të caktuara; të rinjve grupmosha 18-39 vjeç,b) të papunët afatgjatë që presin për punë mbi 12 muaj, c) personat me aftësi të kufizuara, gjithashtu do ketë angazhim maksimal nga të gjitha strukturat e punësimit në vend për gjetjen e mënyrave të përshtatshme për krijimin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit për ndërmjetësim në punë sezonale jashtë vendit.

Do të hartohet strategjia afatmesme e ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve dhe përmirësimit të kushteve të punës për Qendrat për Aftësim Profesional, me sektorin për rikualifikim të fuqisë punëtore do të bashkëpunohet me ofertues të jashtëm të trajnimeve me qëllim të shtimit të numrit të punëtorëve të kualifikuar.

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me komunitetin lokal të biznesit me qëllim të nxitjes dhe rritjes së kërkesës për forcën e punës do punohet në hartimin e projekteve të përbashkëta që kanë për qëllim rritjen e kërkesës për forcën e punës në tregun e punës në sektorin publik dhe privat.

#### ***g. Arsimit dhe kërkimet***

Përcaktimi i arsimit nga Qeveria si një nga prioritetet themelore ka për qëllim që sistemi arsimor t'i shërbejë një shoqërie të bazuar në dije, perspektivë ekonomike dhe punësim. Ngritja e kualitetit qeverisës përmes udhëheqjes dhe menaxhimit cilësor dhe efikas të sistemit ofron mundësinë për gjithë përfshirjen e gjeneratës së re në arsim fillor dhe të mesëm, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Duke ndërtuar lidhje të qëndrueshme të arsimit me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror do të aktualizohet rëndësia e kualifikimeve në fushën e arsimit profesional dhe të arsimit të lartë për nevojat e ekonomisë dhe tregut të punës.

Vizioni i përgjithshëm i Qeverisë është që Kosova të bëhet një shoqëri e bazuar në dije, kompetenca dhe shkathtësi konkurruese brenda dhe jashtë saj, e integruar në rrjedha Europiane me mundësi të barabarta për avancim personal të të gjithë individëve që janë të aftë dhe të përgatitur të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social, kulturor, politik dhe shoqëror.

Misioni i Qeverisë është që Kosova të jetë shoqëri demokratike e integruar në rrjedhat Europiane, që ofron kushte dhe mundësi të barabarta për zhvillimin personal të të gjithë qytetarëve, ku qasja në përfitim të dijes, të aseteve kërkimore – shkencore dhe të përfitimit të shkathtësive, janë të ofruara për të gjithë të interesuarit dhe në funksion të zhvillimit të përshpejtuar dhe të qëndrueshëm të shoqërisë dhe kapaciteteve konkurruese jashtë Kosovës.

Përveç kësaj MASHT-i është duke hartuar edhe strategjinë gjithëpërfshirëse të arsimit 2010-2015 e cila momentalisht është në proces të konsultimit publik me të gjithë akterët relevant, dhe e cila do të përdoret për planifikim vjetor dhe do të jetë në harmoni me KASH-in. Prioritetet kyçe të kësaj strategjie janë; 1) Fëmijëria e hershme dhe shkollimi bazik, 2) Shkollimi dhe aftësimi profesional, 3) Shkollimi për të rritur, 4) Zhvillimi i mësimdhënësve, 5) Arsimi i Lartë, 6) Teknologjia Informativë dhe Komunikuese. Gjithashtu është duke u rishikuar Ligji për Arsimin Para-Universitar i cili Ligj i rishikuar njeh realitetin e ri në arsimin kosovar me fokus të veçantë në; 1. Decentralizimin e kompetencave në nivel komunal, 2. Autonominë e shtuar të shkollave, 3. Fuqizimin dhe rregullimin e reformave të vazhdueshme duke i dhënë Ministrisë rolin primar që i takon në përcaktimin dhe monitorimin e politikave dhe standardeve. Ligji bën të obligueshëm shkollimin e mesëm të lartë për shkak të braktisjes së shkollës në këtë periudhë, si dhe bën të obligueshëm edukimin parashkollor prej moshës 5-6 vjeçare.

Për të pasur një arsim sa më cilësor MASHT-i është në proces të rishikimit të plan-programeve mësimore në përputhje me nevojat e Kosovës dhe standardet Europiane. MASHT-i është duke hartuar Kornizën e Re të Kurrikulës së Kosovës e cila e ndryshon qasjen nga një kurrikulë e bazuar në përmbajtje në një kurrikulë e bazuar në kompetenca në përputhje me standardet e BE-së. Në pjesën e dytë të vitit 2010 do të filloj rishikimi i lëndëve specifike, implementimi i të cilave do të filloj në shtator 2011.

Gjatë vitit 2010 Qeveria e Kosovës do t'i kushtoj rëndësi të veçantë edhe edukimit parashkollor drejt misionit të saj afat gjatë për të pasur një zhvillim socio-ekonomik të bazuar në dije. Deri më tani zhvillimi i hershëm i fëmijës dhe edukimi parashkollor nuk ka pasur vëmendjen e duhur si në aspektin infrastrukturor po ashtu edhe në nivelin e politikave, sidomos në implementimin e tyre, dhe mbetet njeri nga sektorët jo shumë të zhvilluar të sistemit arsimor në Kosovë. MASHT-i është duke finalizuar politikat mbi standardet e zhvillimit dhe të nxënies për fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç. Gjithashtu MASHT-i është duke hartuar legjislacionin sekondar me qëllim të licencimit të ofruesve privat të arsimit parashkollor. Një partneritet i tillë me sektorin privat do të krijoj kushte më të favorshme për përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukimin parashkollor por gjithashtu edhe në ofrimin e shërbimeve më cilësore si rezultat i konkurrencës së tregut në këtë aspekt.

Me qëllim të adresimit sa më të mirë dhe më efikas të nevojave dhe prioriteteve në fushën e arsimit, MASHT-i ka filluar me procesin e decentralizimit të sistemit arsimor sipas formulës së re të financimit dhe menaxhimit. Qëllim i Qeverisë së Kosovës është që të kemi komuna autonome në aspektin e menaxhimit me resurset e tyre të cilat do t'i adresojnë nevojat e qytetarëve të tyre në bazë të prioriteteve të tyre komunale. Ky proces është duke u implementuar me kujdes të veçantë dhe hap pas



hapi do të përfshij të gjitha komunat. Gjatë vitit 2010 edhe 10 komuna të tjera do të kenë buxhetin e tyre të cilin do ta menaxhojnë vet. Megjithatë implementimi efektiv i decentralizimit pengohet nga mungesa e kapaciteteve të komunave për të kryer me efikasitet përgjegjësitë shtesë të planifikimit dhe menaxhimit. Prandaj ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të komunave dhe shkollave në këtë aspekt është shumë i nevojshëm për një decentralizim të suksesshëm të sistemit arsimor.

Rëndësi të veçantë në arsimin kosovar zë Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) si një nga sektorët kryesor të ndërlidhjes së arsimimit dhe ekonomisë së tregut. Është aprovuar Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional i cili ka filluar të implementohet. Janë hartuar edhe aktet e nevojshme të legjislacionit sekondar në bazë të cilave është duke funksionuar AAP-ja. Në këtë drejtim Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përcaktuar dhe rishikuar profilet e AAP-së.

Kosova ka hartuar Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK); ka themeluar Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve si dhe është emëruar drejtori i saj, dhe pritet që Autoriteti të jetë plotësisht operacional deri në fund të vitit 2010. MASHT-i ka hartuar aktet nën-ligjore për monitorimin e plan programeve, teksteve shkollore, metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit. Gjithashtu Qeveria e Kosovës me qëllim të adresimit të çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë në arsim, si një nga dobësitë e sistemit arsimor në Kosovë, ka krijuar edhe dy struktura të tjera në nivel kombëtar: Këshillin Kombëtar për Kurrikula dhe Këshillin Kombëtar për Licencimin e Mësimdhënësve, me një gjithë përfshirje të gjerë.

Shkencës dhe hulumtimit i është kushtuar një kujdes i veçantë gjatë vitit 2009 dhe ky sektor do jetë një nga sektorët kyçe për vitin 2010 dhe vitet në vazhdim. MASHT-i ka hartuar Programin Kombëtar të Shkencës e cila përcakton prioritetet kyçe për zhvillimin e një shoqërie dhe ekonomie të bazuar në njohuri; 1) Ambienti, energjia dhe burimet natyrore, 2) Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit, 3) Hulumtimi mjekësor, 4) Zhvillimi i shoqërisë bazuar në dije, 5) Linguistika, studimet historike dhe kultura dhe 6) Teknologjia komunikuese dhe informative si fushë e cila ndërlidhet me të gjitha më lartë. Qeveria ka ndarë një shumë prej 1 milion eurosh për shkencë dhe hulumtim për vitin 2010. Për këtë qëllim edhe MASHT-i ka krijuar një fond të veçantë prej 1 milion eurosh i cili do të vazhdoj çdo vit me mundësi rritjeje. Gjithashtu është emëruar edhe drejtori i Zyrës Nacionale Kontaktuese për Programin e BE-së FP7 për hulumtim dhe shkencë, si dhe janë emëruar 15 Pika Nacionale Kontaktuese, 12 pika kontaktuese dhe 3 zyrtarë administrativ MASHT-i është duke rishikuar Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore i cili do të përshtatet me rrethanat aktuale në Kosovë sa i përket këtij sektori. Gjithashtu MASHT-i është duke rishikuar edhe Ligjin për Arsimin e Lartë i cili pritet të miratohet në pjesën e dytë të këtij viti.

### **3.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE**

#### ***a. Industria dhe NVM-të***

Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është ngritur mbi bazat e Ligjit për Mbështetjen e NVM-ve me Nr. 02/L-5 që përcakton qëllimin e themelimit të Agjencisë.

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme të Partneritetit European në fushën e industrisë dhe NVM-ve, mes tjerash, MTI-ja do të implementojë strategjinë afatmesme për mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve, duke përfshirë përforsimin e Agjencisë për Mbështetjen e NVM-ve dhe Agjencisë së Promovimit të Investimeve, por edhe implementimin e Aktit European për Ndërmarrjet e Vogla. Ajo gjithashtu do të përforsojë kapacitetet institucionale dhe implementimin e strategjive, planeve të veprimit dhe projekteve konkrete në promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

Aspekti institucional përfshin trajnimet për personelin ekzistues, si dhe punësimin e mëtutjeshëm në këto agjenci, miratimin dhe implementimin e një strategjie zhvillimore të sektorit privat, si dhe një plan veprimi afatmesëm për mbështetjen e NVM-ve. Brenda kornizës së promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, aktivitetet përfshijnë: inkurajimi i shfrytëzimit të plotë të inkubatorëve të biznesit, themelimi i një sistemi efektiv për menaxhimin e të dhënave, themelimin e Parqeve të Biznesit në qytetet e vogla, implementimi i vazhdueshëm i Skemës së Konsulencës dhe Trajnimit Voucher për biznese, promovimi i ndërmarrjeve, si dhe analiza e funksionimit të bizneseve dhe ofrimi i rekomandimeve.

Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovës (APIK) - është agjenci e themeluar nga Ligji Nr. 02/L-33 'Mbi Investimet e Huaja' me 2005, dhe ka për qëllim që të: Siguroj integrimin e plotë të Kosovës në regjion, në ekonomitë Europiane dhe Botërore duke inkurajuar transferin e kapitalit, teknologjisë moderne, të dijes, shërbimeve financiare dhe intelektuale përmes tërheqjes së Investitorëve të huaj.

Njëkohësisht qëllim primar është që nëpërmjet realizimit të projekteve të nxitë eksportin e prodhimeve vendore dhe të ndikon në zvogëlimin e bilancit negativ në shkëmbimet tregtare.

Me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve eksportuese APIK do të vazhdojë me vlerësimin e konkurrencës së sektorit privat dhe futja në përdorim e mekanizmave për nxitje të investimeve. Gjithashtu do të punohet në Hartimin dhe miratimin Strategjisë për eksport; hartimin e Strategjisë për investimet e huaja direkte, Rifreskimin e bazës së të dhënave të eksportit në baza periodike; Përkrahjen e prodhuesve vendor me kapacitete eksportuese për pjesëmarrje në panairë ndërkombëtarë.

#### ***b. Bujqësia dhe peshkataria***

Bujqësia në Kosovë është një nga degët kryesore në ekonominë e vendit. Afërsisht gjysma e popullatës jetojnë në viset rurale ku bujqësia është veprimtaria kryesore ekonomike. Bujqësia vazhdon të mbetet një sektor me buxhet të ulët, por shumë

aktivitete në këtë sektor janë duke u financuar nga donatorët dhe nga asistenca e Bashkimit Europian. Veprimet e parapara në PVPE kanë si synim të arrijnë përmirësimin e mëtejshëm të kornizës ligjore dhe ngritjen e mëtejme të kapaciteteve institucionale të institucioneve që i përkasin këtij sektori.

Deri më tani, në zbatimin e PVPE-së ka pasur zhvillime të rëndësishme legjislative në fushën e bujqësisë dhe peshkatarisë sikurse miratimi i Ligjit për Ushqimin, Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe një numër i akteve nënligjore. Është miratuar Plani për Zhvillim Rural dhe Bujqësor (PZhRB) për vitet 2009-2013 dhe është miratuar Strategjia e Zhvillimit të Pyjeve. Strategjia për konsolidimin e tokave bujqësore do të përgatitet gjatë vitit 2010 dhe do të jetë baza për zbatimin e programit qeveritar për konsolidimin e tokave bujqësore në Kosovë. Për të siguruar implementimin e legjislacionit primar, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka miratuar një numër aktesh nënligjore ndërsa shumë të tjera po ashtu janë në fazën e përgatitjes finale.

Në përputhje me Ligjin për Ushqimin, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka kaluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Përpos kësaj, është ngritur Njësia e Pagesave brenda MBPZhR –së e cila do ti paraprijë Agjencisë së Pagesave; ky institucion do të jetë përgjegjës për shpërndarjen e pagesave tek fermerët nga Qeveria e Kosovës. Po ashtu, ka filluar projekti pilot për konsolidimin e tokave bujqësore që do të jetë një test për implementimin e programit qeveritar për konsolidimin e tokave bujqësore.

Veprimet e parapara në fushën legjislative parashohin përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis*. Sektori më i rëndësishëm është siguria ushqimore. Veprimet në këtë fushë përfshijnë hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për kontrollin e ushqimit për import dhe eksport, organizimin e sistemit të inspektimit dhe raportimit dhe gjithashtu me organizimin e brendshëm të AUV si institucioni kryesor në Kosovë për sigurinë ushqimore.

Veprime të tjera legjislative përfshijnë decentralizimin e kompetencave të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës e cila vepron në kuadër të MBPZhR-së, përkatësisht delegimin e këtyre kompetencave tek komunat e Kosovës. MBPZhR po ashtu parasheh një program legjislativ me qëllim të përafrimit të legjislacionit vendor me *acquis*, sikurse amendamentimit të ligjeve që rregullojnë blegtorinë, prodhimtarinë e duhanit, verëtarinë dhe vreshtarinë dhe bujqësinë organike. Parashihen po ashtu veprime në ngritjen dhe funksionalizimin e strukturave institucionale sikurse funksionalizimi i Njesisë së Pagesave brenda MBPZhR-së, trajnimet e fermerëve dhe tregtarëve të barnatoreve bujqësore.

### ***c. Mjedisi***

Mbrojtja e mjedisit dhe planifikimi hapësinor, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, etj., ka ndikim direkt në zhvillimin ekonomik e social dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik. Situata e vështirë e trashëguar në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, mjedisit, menaxhimit dhe mbrojtjes së resurseve ujore, menaxhimit të mbeturinave, ndotjes së ajrit, ndotjes së tokës dhe humbjes së llojllojshmërisë biologjike, me shfrytëzimin e pakontrolluar të resurseve natyrore, zhvillimin e

pakontrolluar të kapaciteteve industriale dhe afariste, në masë të ndjeshme ka filluar të përmirësohet. Në ndryshimin e ngadalshëm të kësaj gjendjeje ndikon edhe zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve ekzistuese dhe mungesa e disa të tjerave. Qeveria ka përgatitur një kornizë ligjore, ndërsa në nivelin e implementimit, do të inkorporojë dhe zbatojë normat ndërkombëtare për adresimin e këtyre problemeve mjedisore.

Në kuadër të zbatimit të prioriteteve të partneritetit European, janë miratuar: Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji për produkte Biocide Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për rrezatim Jo-jonizues, jonizues dhe siguria Nukleare, Ligji për Parandalimin dhe kontrollin e Integruar të ndotjes (IPPC), Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Ndotjen e Ajrit.

MMPH vlerëson së Raporti i Progresit për Kosovën ka bërë një vlerësim real të progresit të arritur në fushën e Mjedisit. Sfidat e dala nga ky Raport në MMPH janë analizuar dhe janë të përfshira në planet e punës për vitin 2010, në mënyrë që të njëjtat edhe të adresohen me përkushtimin më të madh me mundësit dhe kapacitetet që i ka kjo Ministri.

Sfida tjetër janë dy ligje të dala nga Pakoja e Ahtisarit, Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, dhe Projekt Ligjit për Hoqjen e Madhe, draftet përfundimtare të të dy projektligjeve janë kryer nga GP dhe i janë dorëzuar për komente tek ICO që në fund të vitit 2009. Meqenëse ende nuk ka komente, këto projekt ligje kanë kaluar për miratim në kornizën legjislative të 2010 (K3 2010)

Lidhur me sfidat e dala nga Standardet Europiane, që kanë të bëjnë kryesisht me ngeçjet në progres të miratimit të disa ligjeve e në disa raste edhe të mos implementimit të disa UA-ve nga ligjet mjedisore, janë ndërmarr këto aktivitete:

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, janë proceduar në Qeveri për miratim dhe procedim të mëtutjeshëm.

Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, është tejkaluar dhe në përkrahje të SIDA do të bëhet rishikimi i këtij Plani, dhe do të ndryshohet Strategjia dhe PKVM në vitin 2010, gjithashtu në mbështetje të mundshme nga SIDA.

Në përkrahje të ekspertëve të TAIEX-it, ka përfunduar drafti i parë i Strategjisë për cilësinë e ajrit, dhe së shpejti do të punohet edhe Plani i veprimit.

Sa i përket ndarjes të qartë të përgjegjësiave për menaxhimin e sistemit për monitorimin e cilësisë së ajrit, këto janë të ndara me ligjet në fuqi. Kjo ndërlihet gjithashtu me sfidën për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Institutit Hidrometeorologjik, dhe mund të themi së këto dy Institucione i kryejnë veprimtaritë e tyre në bazë të ligjeve: Ligji mbi veprimtarinë Hidrometeorologjike dhe Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, me të cilat i kanë të ndara edhe detyrat. Për specifikimin e detyrave të mëtutjeshme të AMMK-së, është hartuar edhe Udhëzimi Administrativë mbi strukturën organizative të AMMK-së i paraparë me ligj, dhe i cili pret miratimin.

Gjithashtu lidhur me cilësinë e ajrit, Drafti i UA për cilësinë e ajrit i hartuar në bazë të direktivave të BE, i vlerësuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), ka transpozuar vetëm 65% të direktivave, miratimi i Ligjit të ri për ajrin i cili është miratuar në Parlament, mundëson transpozimin e plotë të direktivës në UA.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Mbeturina është futur në kornizën Legjislative për vitin 2010, meqenëse pas një monitorimi të zbatimit të këtij ligji (në iniciativë të OSBE dhe Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis) janë vërejtur probleme të zbatimit në teren. Ndryshimi i ligjit do t'i eliminoj në masë të dukshme problemet ekzistuese.

ZRRUM si autoritet i pavarur dhe përgjegjëse në aspektin e licencimit, përcaktimit të tarifave të shërbimit, përcaktimit të standardeve të shërbimit etj. të Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Grumbullimit të Mbeturinave, nga gjendja në teren si dhe monitorimit të zbatimit të Ligjit për Mbeturina ka marr iniciativë për amendamentimin e ligjit Nr. 03/L-086 mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi Veprimtarit e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave të cilin nuk ka arit ta bëjë me arsyetim se Amendamenti i Ligjeve bëhet me Ministrin e Linjës për të cilin aktivitet MMPH nuk ka treguar gatishmëri.

Lidhur me transpozimin e dispozitave të direktivës së Impianteve me Djegie të Madhe që parashihet përmes Traktatit të Komunitetit për Energji, MMPH ka nxjerr UA “Mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes”(on rules and standards of discharges on air by stationary sources of pollution), Nr. 06/2007” ku është përfshire kapitulli për LCP. Direktiva e LCP është transpozuar deri në një shkallë por transpozimi i plotë pretendohet të bëhet deri vitin 2012.

Tek sfida që i përket Autoriteteve të Pëllgjeve lumore, zgjidhja e këtyre autoriteteve do të rregullohet pas miratimit të ligjit të ri për ujërat përmes legjislacionit sekondar.

Sa i përket ngecjes së progresit në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe Transpozimit të Direktivës së Zogjve dhe Habitateve, mund të thuhet se bazuar në rezultatet e Raportit të Monitorimit të Progresit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës në Kosovë- Gusht 2009, nivelet e transpozimit të direktivave për natyrën janë të avancuara, përparimi është raportuar për sa i përket transpozimit të Direktivës së zogjve të egër me rezultat rreth 83% (64% në 2008), ndërsa rezultati për Direktivën e habitateve 73%, pak më e ultë së vitin e kaluar. Ligji i ri për Mbrojtjen e Natyrës është në procedurë qeveritare, dhe pritet që ky ligj të sigurojë transpozimin e plotë të dy direktivave.

Sa i përket ngritjes së vetëdijes së publikut për çështje mjedisore dhe fuqizimit të bashkëpunimit me OJQ-të mjedisore, Departamenti i Mjedisit përmes sektorit për vetëdijesim dhe ndërgjegjësim të mjedisit ka përfunduar me mbajtjen e ligjëratave të rregullta me nxënësit e shkollave fillore në tërë territorin e Kosovës dhe gjithashtu është duke nxjerr gazetën mjedisore “Mjedisi”, përgatitja e broshurave dhe pllakateve me qëllim vetëdijesimin e publikut po vazhdon dhe botimi i tyre bëhet në të tre gjuhët zyrtare të Kosovës dhe në gjuhët e minoriteteve tjera. Nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim me OJQ-të mjedisore me 5 qershor të vitit 2009, ka ngritur këtë

bashkëpunim dhe OJQ-të mjedisore, dhe përfaqësuesit e operatorëve të ndryshëm, gjithmonë janë të kyçur në hartimin e Strategjive, dhe PKVM-së.

#### ***d. Politikat e transportit***

Duke marrë parasysh gjendjen e tanishme të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si dhe rëndësinë e shërbimeve të komunikimit, Qeveria e Kosovës synon të përmirësojë këtë infrastrukturë në pajtim me standardet Europiane për t'u bërë motor i zhvillimit ekonomik.

Infrastruktura rrugore është në fazën e zhvillimit. Kjo ka rëndësi të veçantë në sistemin ekonomik të Kosovës. Rreth 90% e transportit të mallrave dhe udhëtarëve në Kosovë kryhet përmes transportit rrugor.

Rrugët magjistrale dhe rajonale në Kosovë janë kryesisht me dy shirita. Në segmentet rrugore rreth Prishtinës janë zhvilluar rrugë me 4 shirita dhe në vazhdim është zgjerimi i rrugëve kryesore nacionale si ajo Prishtinë- Pejë dhe Prishtinë- Mitrovicë.

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit këtë vit planifikon të fillojë realizimin e segmentit A Morinë – Prizren në gjatësi prej 20 km të autostradës 7 Morinë – Merdare si pjesë e rrjetit bazik të Evropës Juglindore. Gjithashtu gjatë këtij viti pritet përfundimi i projektit zbatues për Autostradën 6 Prishtinë - Hani i Elezit .

Hekurudhat e Kosovës pretendojnë të jenë organizatë dinamike dhe e qëndrueshme që ndihmon në shtyrjen përpara të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës duke plotësuar nevojat e tregut me anë të transportit të sigurt e konkurrues të udhëtarëve dhe mallrave. Për transportin e udhëtarëve janë në funksion treni Prishtinë – Shkup, Treni i Pejës dhe Treni i Lëvizjes së Lirë. Subvencionimi nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës mbulon disa nga humbjet për operimin të transportit të udhëtarëve dhe krijon mundësinë që këta trena të funksionojnë. Kurse krijimi i të hyrave për mbulimin e shpenzimeve operative të Hekurudhave të Kosovës mundësohet nga transportimi i mallrave brenda shtetit dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Më 15 qershor 2008 është miratuar “Ligji për hekurudhat në Republikën e Kosovës” i cili përveç tjerave parasheh edhe veprime të rëndësishme të cilat do të mundësojnë funksionimin e këtij sektori sipas praktikave dhe legjislacionit modern European. Në muajin shkurt të këtij viti 2010, Qeveria e Kosovës e ka miratuar vendimin për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës ShA në dy kompani të reja:

- Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA; dhe
- Operimi me Trena në Hekurudhat e Kosovës ShA.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Hekurudhat e Kosovës ShA kanë themeluar grupet punuese të cilat do të punojnë në ndarjen e hekurudhave.

Dokumenti rreth i deklaratës së rrjetit, dokument ky mjaft i rëndësishëm për qasjen e operatorëve hekurudhor në linjat hekurudhore është finalizuar dhe tani ka mbetur që të miratohet versioni final i tij. Gjithashtu, pritet të finalizohet edhe dokumenti rreth përcaktimit të tarifave për qasjen në rrjetin hekurudhor, dokument ky shumë i rëndësishëm i cili do të jetë pjesë e dokumentit të Deklaratës së rrjetit etj.

Këtu vlen të përmenden edhe dy dokumente tjera mjaft të rëndësishme me të cilat parashihet zhvillimi i sektorit hekurudhor. Dokumenti i parë është “Politikat e Transportit Multi Modal të Kosovës”, dokument ky i punuar nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit në bashkëpunim me konsulentët e jashtëm dhe i miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2005, ndërsa dokumenti i dytë është “Strategjia Multi Modale e Transportit”, dokument ky i cili është punuar nga MTPT-ja përmes konsulencës së jashtme dhe i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2009.

Transporti ajror ka shënuar përparim në Republikën e Kosovës. Kosova është anëtare e Zonës së Përbashkët Europiane të Aviacionit (ECAA) me të drejta të plota, qysh prej vitit 2006, kur shtetet anëtare të BE-së nënshkruan Marrëveshjen e ECAA-s me vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo Marrëveshje obligon Kosovën që të pasqyrojë gjithë legjislacionin European mbi aviacionin civil në legjislacionin vendor.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e transportit, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, e cila përbëhet nga 36 Udhëzime Administrative.

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit European në fushën e transportit, synohet krijimi i një Autoriteti Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës me pavarësi operacionale dhe financiare, themelimi i një bordi Mbikëqyrës për ARAC-në, si dhe implementimi i plotë i Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit dhe Ligjit të KE-së mbi Aviacionin, analizimi dhe identifikimi i kundërthënies të mundshme në mes të Ligjit mbi Telekomunikacionin dhe Ligjin mbi Financat Publike si dhe hartimi dhe miratimi i amendamenteve të Ligjit mbi Telekomunikacionin.

Në fushën e infrastrukturës të vazhdohet me pjesëmarrje në zbatimin e Memorandumit të mirëkuptimit (SEETO) në të gjitha nivelet, përmes Takimeve të Ministrave, Komitetit Drejtues, Koordinatorëve Kombëtar dhe Grupeve Punuese, implementimi i segmenteve për drejtimin rrugorë 6 (kompletimi i projektit zbatues) si dhe kompletimi i projektit zbatues dhe fillimi i punimeve në segmentin A të drejtimit rrugor 7, të vazhdohet me përgatitjet e duhura rreth projekteve prioritare të identifikuar për drejtimet rrugore 6 dhe 7, linjën hekurudhore 10 dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Në sektorin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave do të bëhet hartimi i planit shumë vjeçar i veprimit për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe miratimi i këtij plani, përgatitja e kornizës për zbatimin e planit shumë vjeçar të veprimit për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, do të vazhdohet me konkludimin e marrëveshjeve bilaterale mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave me vendet fqinje dhe të tjera, përgatitja e legjislacionit mbi Marrëveshjen Europiane, që ka të bëjë me punën e ekuipazheve të automjeteve të angazhuara në Transportin Ndërkombëtar Rrugor (AETR), do të iniciohen aktivitetet trajnuese për përgatitjet dhe implementimin e tapogرافit digjital, të bëhet harmonizimi i planeve lokale të transportit për planifikimin e transportit në nivel qendror, të vazhdohet me përmirësimin e kualitetit të rrjetit ekzistues të transportit rrugor ndër-urban me qëllim që të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm për biznesin si dhe me adekuat për

shfrytëzuesit, të iniciohet pjesëmarrje në iniciativat rajonale që forcojnë lehtësimin e tregtisë dhe të transportit si dhe do të vazhdohet anëtarësimi në baze vjetore në Unionin Ndërkombëtar të Transportit Publik (UITP).

Këshillit për Siguri në Komunikacionin Rrugor është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 14 tetor 2008 me udhëzimin administrative Nr. 18/2008 në pajtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, kurse përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2008 është themeluar Sekretariati Teknik i këtij këshillit. Në këtë aspekt, në kuadër të zbatimit të ligjit është hartuar edhe një draft i Programit për Siguri në Komunikacionin Rrugor i cili pritet të shqyrtohet dhe miratohet pas mbledhjes së Këshillit për Siguri në Komunikacionin Rrugor.

Strategjia për transport multimodal dhe Plani i Veprimit ndërsektorial për transport multimodal tash më ka përfunduar dhe është miratuar nga Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2009. Ky dokument mundëson planifikimin dhe zhvillimin afat gjatë të sektorit të transportit deri në vitin 2030. Andaj, për këtë fushë duhet të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve institucionale për planifikimin e transportit multimodal, do të vazhdohet me përmirësimin e bazave të të dhënave të informatave rrugore dhe do të bëhet vlerësimi ekonomik i projekt-propozimeve si instrumente për programim dhe bugjetim të programit për menagjim të aseteve rrugore.

Zhvillimi i Strategjisë Multi Modale të Transportit për periudhën afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për Republikën e Kosovës ka përfunduar dhe është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj strategjie është edhe sektori i transportit hekurudhorë ku identifikohen dhe planifikohen projektet me rëndësi strategjike për vitet që po vijnë. Një rëndësi të posaçme ka edhe zhvillimi strategjik i transportit multimodal i cili ngërthen në vete edhe transportin hekurudhor dhe planifikohet të zhvillohet në Fazën A (vitet 2010 – 2015) dhe Fazën B (vitet 2016 – 2030).

Në sektorin e infrastrukturës rrugore do të bëhet përgatitja dhe miratimi i sistemit të kontraktimit shumë vjeçar bazuar në performancë për mirëmbajtjen rrugore verore dhe dimërore, rikategorizimi i rrjetit ekzistues rrugor, si dhe do të fillohet me një projekt në sektorin e transport për PPP-të.

Në prioritetet afatshkurtra kanë hyrë projektet e vazhdimin të modernizimit të linjës së 10 hekurudhore, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i linjave tjera hekurudhore, mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse (lokomotivave, vagonëve të udhëtarëve dhe mallrave, trenave motorik, etj). Kjo do të mundëson zhvillimin e sigurt të transportit të udhëtarëve dhe atij të mallrave ku Kosova pretendon që të jetë si urë lidhëse me vendet e rajonit dhe ato Europiane.

Më 26 prill të këtij viti ka filluar të zbatohet projekti i studimit të fizibilitetit për modernizimin e linjës së 10 hekurudhore. Ky projekt i financuar nga IPF do të jetë me rëndësi të posaçme për Hekurudhat e Kosovës në mënyrë që të mund të kërkohen investimet për modernizimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm.



Në prioritetet afatshkurtra është edhe krijimi i Autoritetit Rregullativ Hekurudhor dhe ndarja e hekurudhave. Këto dy projekte mjaft të rëndësishme tanimë janë në realizim e sipër. Në kuadër të ndarjes së hekurudhave pritet që të përpilohen dhe të nënshkruhen edhe dy dokumente të rëndësishme për sektorin hekurudhor;

- Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet MEF-it dhe INFRAKOS-it për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore; dhe
- Nënshkrimi i Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve Publike në transportin e udhëtarëve ndërmjet të Qeverisë së Kosovës dhe TRAINKOS-it.

Ndër prioritetet afatshkurtra hyn edhe nënshkrimi i marrëveshjes për kalimet hekurudhore kufitare me Maqedoninë. Kjo marrëveshje moderne e përpiluar në bazë të praktikave ë të mira të BE-së pritet që të finalizohet dhe të nënshkruhet së shpejti.

Në këtë periudhë po ashtu është paraparë pjesëmarrja aktive e Kosovës në Grupet punuese mbi hekurudhat në kuadër të SEETO-s si dhe anëtarësimi i Hekurudhave të Kosovës në institucionet hekurudhore ndërkombëtare dhe ato botërore siç janë: UIC, CER, RNE, etj.

Sa i përket Aviacionit, janë miratuar propozimet për anëtarët e Bordit të Autoritetit të Aviacionit Civil, i cili është tashmë funksional, ndërsa përmes Rregullores 2008/7 të nënshkruar nga Ministri i MTPT-së është siguruar vetëfinancimi i AACK-së përmes mbajtjes së një tarife të sigurisë e cila është pjesë e tarifës së shërbimit të udhëtarëve që fluturojnë nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Në anën tjetër është vazhduar me zbatimin e dispozitave që dalin nga Marrëveshja e Hapësirës së Përbashkët Europiane të Aviacionit (ECAA) dhe gjatë rishikimit të PVPE është vendosur që zbatimi i kësaj Marrëveshje të ndahet në dy veprime që përkon me dy fazat e implementimit të saj.

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit European në fushën e transportit, do të synojmë vlerësimin dhe analizimin e zbatimit të ligjit mbi sigurinë rrugore, hartimin e strategjisë për rritjen e sigurisë rrugore, pastaj zbatimin e programit të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të rrjetit rrugor të Kosovës, zbatimin e projekteve strategjike për drejtimet rrugore 6 dhe 7 si dhe zbatimin e strategjisë të transportit multimodal.

Bazuar në dokumentin mbi Zhvillimin e Strategjisë Multi Modale të Transportit, për periudhën afatmesme është paraparë një zhvillim më i madh i infrastrukturës hekurudhore, ku përfshihet edhe elektrifikimi i linjave të caktuara, si dhe një zhvillim më i madh i transportit të udhëtarëve (duke përfshirë këtu stacionet multi modale), si dhe një zhvillim më i hovshëm i transportit të mallrave duke zhvilluar edhe qendrat multi modale të grumbullimit dhe transportit të mallrave. Njëkohësisht parashihet edhe futja e operatorëve të tjerë hekurudhor dhe ndërlidhja dhe integrimi i hekurudhave të Kosovës në rrjetin hekurudhor Rajonal dhe atë European, me çka do të ngritët konkurrenca në tregun e transportit hekurudhor e me këtë edhe cilësia e ofrimit të shërbimeve hekurudhore.

#### ***e. Energjia***

Ministria e Energjisë dhe Minierave ka adoptuar një vizion strategjik afatgjatë për sektorët e energjisë dhe minierave në Kosovë. MEM është duke zbatuar reforma të

orientuara drejt tregut dhe po koordinon ristrukturimin e sektorëve të energjisë dhe minierave, në mënyrë që t'i përgatisë ato për tërheqjen e investimeve shumë të nevojshme private përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues për arritjen e partneriteteve publike-private. Zhvillimi i tregut konkurrues i energjisë, në pajtim me acquis të BE-së dhe Traktatin për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, përmes të cilit do të mund të ofrohen shërbime energjetike të cilësisë së lartë, me teknologji që nuk dëmtojnë mjedisin dhe me kosto të ulët, paraqet të vetmen rrugë përpara drejt zhvillimit të qëndrueshëm për vendin tonë.

Synimet strategjike:

- Të zhvillohet dhe implementohet politikë, strategji dhe kornizë ligjore për reformimin dhe ristrukturimin e sektorit të energjisë në pajtueshmëri me acquis të BE-së;
- Të promovohet dhe përkrahet zhvillimi i një tregu konkurrues energjetik, i cili do të integrohet në tregun e energjisë të BE-së në të ardhmen;
- Të promovohet restaurimi i qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve energjetike;
- Të arrihet siguria në furnizim me energji për konsumatorët me kosto sa më të ulët dhe në mënyrë sa më të padëmshme për mjedisin;
- Të inkurajohet hulumtimi dhe zhvillimi i rezervave të reja të linjtit dhe mineraleve të tjera;
- Të zhvillohen dhe implementohen politika, strategjia dhe korniza ligjore për sektorin minerar;
- Të promovohen investimet private në sektorët e energjisë dhe minierave në formë të partneriteteve publike-private.

Arritja sa me parë të jetë e mundur e sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm e cilësor me energji elektrike është sfida me e madhe. Për këtë, rendësi e veçantë po i kushtuar ndërtimit e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe rehabilitimit të TC Kosova B, të dyja këto me pjesëmarrjen e sektorit privat. E njëjta parashikohet edhe për sigurimin e mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm me linjit të këtyre kapaciteteve gjeneruese në të ardhmen.

Plotësimi i obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe procesi i integritimeve Europiane është një tjetër sfide aktuale. Në këtë kuadër, parashikohen masat që do të ndërmerren në të ardhmen për përfundimin e ristrukturimit dhe reformimit të sektorit energjetik në përputhje me direktivat e KE-së dhe legjislacionit vendor në fuqi, ashtu që ky sektor të bëhet jo vetëm i vetë-qëndrueshëm nga pikëpamja financiare, por edhe të tërheqë investime private dhe të arrijë të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik e social të vendit.

Zbatimi i qasjes Europiane sa i takon energjisë, mjedisit dhe konkurrencës është në vëmendjen e kësaj Strategjie. Kjo do të mundësojë integrimin e sektorit energjetik të vendit në sistemet energjetike Europiane. Vëmendje e veçantë po i kushtohet mbrojtjes së mjedisit nga emetimet ndotëse prej stabilimenteve energjetike.

Edhe rritja e efijencës së energjisë dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë konsiderohen elemente të rëndësishëm të politikës energjetike. Politika dhe masa të qarta janë përfshirë në këtë dokument për këta dy sektorë të rëndësishëm.

Përgatitjen e një kornize plotë ligjor dhe rregullator që do të mundësojë tërheqjen e investimeve të konsiderueshme private në sektorin tonë energjetik është në plotësim e sipër. Korniza rregullatore e sektorit energjetik të Kosovës synohet të jetë e plotë dhe e qartë në mënyrë që të arrihet besimi i investitorëve të huaj në të.

Vizioni i Qeverisë është që nëpërmjet investimeve private do të mund të eliminohet jo vetëm barra aktuale që sektori energjetik përbën për Buxhetin e Kosovës, por edhe do të mund të arrihet të përmirësohet ndjeshëm siguria e furnizimit me energji dhe të ngrihet cilësia e tij.

Zhvillimet kryesore në sektorin energjetik gjatë vitit 2009 janë orientuar drejt: Implementimit të reformave siç parashikohen në kuadër të obligimeve të Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE) dhe prioriteteve të Partneritetit Europian; Arritjes së progresit të planifikuar për tejkalimin e sfidave të identifikuar në Raportin e Progresit të Komisionit Europian 2008, dhe Realizimin në përpikëri i veprimeve të parapara, të cilat janë identifikuar në kuadër të raportit të KE për vitin 2008, nga Traktati i Komunitetit të Energjisë si dhe planeve zhvillimore nacionale për sektorin e energjisë.

Gjithashtu, duhet potencuar së në këtë kuadër është arritur progres edhe në:

- Zbatimin sipas orarit të paraparë të planit të KOSTT për zhvillimin e sistemit të bartjes,
- rritjen e faturimit dhe të inkasimit të energjisë elektrike,
- plotësimet në vazhdimësi e kuadrit ligjor dhe rregullator për sektorin e energjisë në përputhje me direktivat e BE për sektorin e energjisë, dhe
- zhvillimet bilaterale dhe rajonale në sektorin e energjisë.

Sipas Raportit të Komisionit Europian të Progresit për Kosovën për vitin 2009, sfidat kryesore përpara sektorit energjetik për vitin 2010 dhe në vijim janë identifikuar si vijon:

Gjendja financiare e KEK sh.a. vazhdon të mbetet sfida kryesore për institucionet. Edhe pse MEM pak mund të ndikojë direkt në përmirësimin e performancës financiare të KEK sh.a., MEM duhet të vazhdojë të mbështesë KEK sh.a. në një fushatë shumëformëshe për rritjen e inkasimit. Menaxhimi i kërkesës për energji (ose demand Side Management) duhet të arrihet nëpërmjet një Programi të veçantë të cilin duhet ta përgatisim sa më parë,

Furnizimi i pandërprere me linjit i kapaciteteve ekzistuese. Duhet të mbështesim kërkesat e KEK sh.a. për mbështetje buxhetore në 2010 për hapjen në kohë të Sibovcit JP; kjo përbën një prioritet të lartë. KE është e shqetësuar së mund të mbetemi pa linjit dhe do duhet të importojmë shume,

Krijimi i tregut konkurrues për ngrohjen sipas kërkesës së Ligjit për Ngrahjen Qendrore,

Aprovimi në Kuvend i Strategjisë të Rishikuar e Energjisë për 2009-2018, Ndërtimi i TC Kosova e Re duhet të respektojë Standardet Europiane, Kapacitetet institucionale dhe ligjore të MEM-it dhe ZRrE-së mbeten akoma të dobëta, dhe Të punohet intensivisht për të arritur caqet e parashikuara për eficiencën dhe BRE-të.

Puna e përbashkët dhe e bashkërenduar mire mes institucioneve vendore si MEM, ZRrE, MEF, MMPH, KOSTT sh.a., KEK sh.a. përbën një nga premiset kryesore për rangimin e reformave sipas orareve të parashikuara, plotësimin e obligimeve në kuadër të TKE-së, dhe përsheptimin e procesit integruar.

Gjithashtu, në kuadër të veprimeve të propozuara është dhënë një fokus i veçantë në adresimin sa me mirë të sfidave të dala për sektorin e energjisë nga raporti fundit i progresit të KE-së për Kosovën, dhe atë gjithashtu janë paraparë edhe afatet kohore, përgjegjësit si dhe për aty ku ka pasur implikime financiare janë alokuar edhe mjetet e nevojshme në mënyrë që të realizohen në baze të dinamikës së paraparë.

#### ***f. Shoqëria informative dhe mediat***

Telekomunikacioni është element kyç për aktivitetet ekonomike vendore dhe thelbësor për krijimin e marrëdhënieve komerciale ndërkombëtare. Industria e komunikimit përbënë një nga sektorët më fitimprurës për indikatorët makroekonomikë dhe shërben si katalizator në të ashtuquajturën “ekonomi e mençur”. Njëkohësisht, kjo industri shërben si “dritare” për bizneset dhe individët duke mundësuar qasjen e shpejtë dhe globale. Gjithashtu, është vegël për promovimin e transparencës dhe efikasitetit të qeverisë.

Liberalizimi i tregut të telekomunikacionit për ofruesit e shërbimeve telekomunikuese dhe për shërbimet lokale, shërbimet në distanca të largëta dhe ndërkombëtare formalisht është bërë në vitin 2003 me ligjin për Telekomunikacionin, (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/16 me 12 Maj 2003).

Angazhimet për marrjen e kodit thirrës për shërbimet telefonike dhe Kodit "Call Sign" për radio amator do të vazhdojnë deri në arritjen e qëllimit, por për shkak të kushtit të të qenit anëtar i OKB-së dhe pastaj rrjedhimisht edhe të ITU-së, si rrugë më e thjeshtë, ky objektivi është vështirësuar për tu arritur.

Në sektorin e telefonisë mobile tani janë të licencuar dy operatorë që ofrojnë shërbime të telefonisë mobile. Operatori VALA është operatori publik i telefonisë mobile, i licencuar nga ART-ja që nga korriku i vitit 2004. Operatori i dytë i telefonisë mobile është Konzorciumi IPKOnet – Telekom Slovenije/ Mobitel, i licencuar nga ART më datë 06 mars 2007.

Më 16 Prill 2010 është miratuar në Kuvendin e Kosovës Ligji për Shërbimet Postare, i cili e zëvendëson ligjin e vjetër për Shërbimet Postare - Nr. 2003/18 të miratuar më 10 tetor 2003. Ky ligj rezulton në krijimin e një autoriteti rregullator përgjegjës për rregullimin e sektorit të shërbimeve postare, respektivisht licencimin, kontrollimin, monitorimin, miratimin e tarifave, etj. Nenet 5 dhe 6 të këtij Ligji përcaktojnë rolin dhe detyrat e rregullatorit, dhe e definojnë atë si sektor në kuadër të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Ndërsa, MTPT do të mbetet edhe më tutje përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive të sektorit postar në Republikën e Kosovës.

Plotësimi i detyrimeve që ka të bëjë me komunikimin dhe me raportimin e të dhënave të nevojshme për Sektorin e Komunikimeve Elektronike dhe shërbimeve të Shoqërisë së Informacionit bëhen në mënyrë periodike – rregullisht. Forumi i tretë i Komisionit Evropian me vendet që aspirojnë integrimin në Bashkimin Evropian është mbajtur më

7 dhe 8 Shkurt 2010 në Budvë të Malit të Zi. Në këta Forum për të arriturat në sektorin e Telekomunikacionit në vendin tonë ka pasur edhe Kosova. Gjithashtu në Forum është prezantuar edhe raporti i katërt i sektorit të komunikimeve elektronike në të gjitha shtetet e rajonit dhe Turqisë.

Sa i përket legjislacionit sekondar, ART ka bere progres te konsiderueshem duke inicuar formimin e grupeve funksionale ne pergatitjen e rregulloreve me rendesi kyqe per funksionim normal te tregut.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është autoriteti i vetëm rregullativ i transmetimit në Republikën e Kosovës. KPM ka për mision të promovojë zhvillimin e një tregu të shëndoshë medial që u shërben të gjithë njerëzve të Kosovës; të inkurajojë profesionalizmin në radhët e gazetarëve, menaxherëve dhe pronarëve të mediave dhe të mbrojë lirinë e shprehjes, shumëllojshmërinë e mendimit, qasjen në informata për gazetarë dhe publikun si dhe interesin e shfrytëzuesve të mediave dhe operatorëve sipas sundimit të ligjit.

Në Kosovë gjithashtu janë të licencuar 10 operatorë kabllorë, 7 prej tyre i përkasin shumicës Shqiptare, 2 prej tyre i përkasin komunitetit Goran si dhe 1 i përket komunitetit Serb. Ndërsa, deri tani KPM ka licencuar edhe 28 ofrues të shërbimeve programore të cilët ofrojnë programe vetëm përmes operatorëve kabllorë.

Skena mediale ka ndryshuar shumë gjatë dy viteve të fundit. Transmetimi nuk është me vetëm ai klasik, në rrjetin tokësor. Zhvillimet e teknologjisë kanë rezultuar me prezantim të platformave të reja. Ndryshimet janë në vazhdimësi por rregullimi i tyre mbetet i njëjtë. Secila platformë duhet t’u nënshtrohet parimeve dhe kushteve për operim më efikas dhe në pajtim me ligjin dhe standardet Europiane.

Sa i përket fushës së shoqërisë informative është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative e cila rregullon këtë sektor. Në kuadër të përmirësimit të kornizës legjislative më 15 shtator 2009, MTPT ka lëshuar Urdhëresën Administrative NR 1/2009 për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit për fillimin e veprimeve për krijimin e regjistrimit dhe menaxherit të regjistrimit për kryedomenin “.ks” të kodit shtetëror për internet të Republikës së Kosovës – (ang. country code top-level domain – ccTLD) kurse më 13 shkurt 2009 është ART ka miratuar Udhëzimi Administrativ NR 2004/3 mbi caktimin e dënimeve për kundërvajtjet nga telekomunikacioni.

Me synim të adresimit të Prioriteteve afatshkurta të Partneritetit European në fushën e shoqërisë informative dhe mediave, do të synojmë përhapjen e Internetit Brezgjerë në të gjitha shkollat dhe institucionet akademike, zhvillimin e programeve për mësimin e vazhdueshëm të zyrtarëve qeveritar në sferën e teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit (ECDL/ICDL), zhvillimi i programit për funksionalizmin e përdorimit të numrit telefonik standard të emergjencës “E-112” dhe krijimin e planeve implementuese për emergjencë të integruar dhe të shërbimeve komunikuese të sigurisë publike, krijimin e qendrave kompjuterike shtetërore të reagimit në raste emergjente dhe fillimi i shkëmbimit të informacioneve, themelimin e kushteve për tregti elektronike, prokurim elektronik dhe aplikim i nënshkrimit elektronik.

Ndërkaq, duke u bazuar në kompetencat e ART-së, do të synohet që të bëhet harmonizimi i tabelës së ndarjes të frekuencave në përputhje me tabelën Europiane të rëndomtë të ndarjes dhe me Vendimin Nr. 676/2002/EC, sigurimi i veglave elektronike (softuer i avancuar për menaxhimin e spektrit të frekuencave), krijimi i stacionit fiks për monitorimin e spektrit, të bëhet ngritja e kapaciteteve për të kryer monitorimin e spektrit dhe matjen nga distanca të parametrave të emetimit, mbajtja e spektrit, identifikimi i emetimeve dhe lokacioni i burimit të ndërhyrjes së dëmshme, definimi i regjimit të Qasjes dhe Shërbimeve Universale, angazhimi rreth marrjes së kodit thirrës për shërbimet telefonike dhe kodit për Top Nivelin e Domenit Nacional për shërbime të Internetit – Kodit Shtetëror për Internet si dhe Kodit "Call Sign" për radio amator, promovimi i nyjave të përbashkëta/ shkëmbyese të internetit, studimi për definimin e tregut me qëllim të definimit të ofruesve të shërbimeve që kanë fuqi të ndjeshme në treg, analiza e tregjeve relevante në sektorin e komunikimeve elektronike, rregullimi i shërbimeve që i ofrojnë Operatorët me fuqi të ndjeshme në treg, përgatitja dhe aprovimi i Rregullores për Bartshmërinë e Numrave (ang. Number Portability), përgatitja dhe aprovimi i Rregullores për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit (ang. Carrier Selection and Carrier Preselection), përgatitja dhe aprovimi i Rregullores për RUO (RUO - Reference Unbundling Offer), zhvillimi dhe implementimi i detajuar i sistemit të politikave për çmimet/tarifat, implementimi i rebalancimit të tarifave nga PTK dhe përfundimi dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare për qasje në Infrastrukturën brezgjere wireless (patela). Duke u bazuar në kompetencat e KPM do të synohet që të bëhet hartimi i strategjisë për kalim në sistemin digjital të transmetimit nga sistemi analog, implementimi i Projektit Kapital të Monitorimit Mobil përmes sigurimit të pajisjeve për pranimin e sinjaleve të mediave analoge dhe kabllore dhe arkivimin e tyre.

Me synim të adresimit të Prioriteteve afatmesme të Partneritetit European në fushën e shoqërisë informative dhe mediave, do të synojmë ta bëjmë ndryshimi i Ligjit të Telekomunikacionit dhe Ligjit mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim në bazë të konkluzioneve nga analizat e bëra. Ndërkaq sa i përket kompetencave të ART-së do të synohet që të bëhet krijimi i kategorive të përshtatshme për licencim/autorizim/regjistrim dhe udhëzuesve të përshtatshëm për të kaluar nga regjimi aktual në regjimin e kategorive të licencave/autorizimeve/regjistrimeve, aprovimi i termeve të referencës mbi funksionimin e ART-së, përfshirë aprovimin e statutit bazë, kompletimin e urdhëresave organizative dhe sistematizuese, si dhe hartimi i rregullores për të drejtën për shteg për operatorët e licencuar për të ofruar shërbime telekomunikuese.

Ligji mbi Telekomunikacionin është amandamentuar në vitin 2008. Në Strategjinë Legjislative të vitit 2010 është paraparë hartimi i Ligjit për Komunikimet Elektronike, i cili do ta zëvendësojë Ligjin mbi Telekomunikacionin. Për shkak të kompleksitetit të këtij ligji, i cili mbulon shumë aspekte ekonomike dhe rregullatore të lëmisë së telekomunikacionit dhe komunikimeve radio difuzive, MTPT i ka bërë kërkesë Komisionit European që nëpërmjet asistencës teknike TAIEK të i ndihmojë entitetet kryesore që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike, që të formulojnë këtë ligj.

Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit 2010-2015 përfshinë të gjithë sektorët dhe fushat e mbuluara nga Ministria. Ato janë zhvilluar ndarazi, por kjo strategji nuk nënvlerëson ndërlidhjen e tyre dhe ndikimin pozitiv të këtyre ndërlidhjeve, me qëllim të zbatimit me sukses të Strategjisë dhe të plotësimit të nevojave të qytetarëve të Kosovës. Për më tepër, kjo Strategji ka marr në

konsideratë të gjitha dokumentet e mëparshme në mënyrë që të sigurohet harmonizimi dhe për tu shmangur dyfishimet.

### ***g. Kontrolli financiar***

Departamenti i Thesarit ka përgjegjësi t'i përmbushë praktikat më të mira ndërkombëtare në menaxhimin e parasë publike për Republikën e Kosovës.

Në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Thesari është përgjegjës për zhvillimin e kornizës së politikave të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, implementimin e rregullave financiare të KBFP-së, edukimin lidhur me kontrollin e brendshëm financiar, ekzekutimin e buxhetit, grumbullimin dhe ruajtjen e parasë publike.

Në shtator 2009 në kuadër të Departamentit të Thesarit, është themeluar Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo njësi numëron një staf prej 5 vetash dhe është duke punuar ngushtë me projektin të financuar nga Komisioni European i cili është si mbështetje për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Projekti i financuar nga KE ka dy komponente që lidhen me MFK-në, rishikimi i rregullës financiare për MFK-në, rishikimi dhe hartimi i legjislacionit tjetër sekondar dhe terciar për MFK, si dhe mbështetja e njësisë së MFK-së për ngritje të kapaciteteve, Qëllimi i rishikimit dhe hartimit të legjislacionit sekondar dhe terciar për MFK ka për qëllim që të i ndihmojë organizatat buxhetore që në mënyrë efikase të zbatojnë përgjegjësitë e tyre për MFK.

Në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Thesari është përgjegjës për zhvillimin e kornizës së politikave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, zhvillimin e rregullave financiare, edukimin e organizatave buxhetore me Menaxhimin Financiar dhe kontrollin.

Thesari gjithashtu është përgjegjës për themelimin e një kornize të llogaridhënies që, brenda një ambienti të llogaridhënies dhe kontrollit të plotë, i mundëson Thesarit dhe organizatave buxhetore t'i plotësojnë obligimet e tyre ligjore për të ekzekutuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës në mënyrë efikase dhe efektive duke pasur parasysh parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

Kërkesat që dalin nga partneriteti European sa i përket Kontrollit Financiar kanë për qëllim që të vazhdojnë përpjekjet për zbatim të strategjisë për kontroll të brendshëm publik financiar dhe ligjet relevante si bazë për arritjen e prioritetëve në këtë fushë, të cilat edhe kanë dalë si sfidë në Raportin e Progresit dhe të cilat janë adresuar me rishikimin e PVPE-së 2010.

Gjatë vitit 2009 janë arritur këto objektiva:

- Miratimi i Ligjit për menaxhimin e borxheve
- Rishikimi i rregullës financiare 02- Shpenzimi i parasë publike (në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë),
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për delegimin të shpenzimeve nga Departamenti i Thesarit të Organizatat buxhetore,

- Miratimi i Udhëzimit administrativ për kredit kartela
- Miratimi i udhëzimit administrative për llogaritë e ambasadave

Për qëllim të zhvillimit dhe ngritjen e nivelit të përgjegjësisë të funksionit të llogaridhënies janë planifikuar këto veprime:

- Vazhdimi i decentralizimit të shpenzimeve nga Thesari të organizatat e nivelit qendror.
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për menaxhimin e borxheve
- Miratimi i udhëzimit administrative për pranim – dorëzim të dokumentacionit financiar nga Thesari të Organizatat buxhetore
- Rishikimi i Rregullës 01- Menaxhimi financiar dhe kontroll.
- Përgatitja e marrëveshjeve që përcaktojnë përgjegjësinë e zyrtarëve llogaridhënës, autorizues të buxhetit dhe personelit tjetër financiar për MFK
- Rishikimi i legjislacionit sekondar dhe terciar për të siguruar pajtueshmëri me MFK
- Hartimi i manualëve për MFK,
- Udhëzues për menaxhimin e rrezikut,
- Hartimi i listave kontrolluese për vetë- vlerësim të funksionimit të MFK,
- Hartimi i procedurave për raportim vjetor mbi sistemet e kontrollit të brendshëm
- Përgatitja e programit të trajnimit që personat përgjegjës të kuptojnë rolin e MFK dhe të iu mundësojë atyre arritjen e njohurive të reja që zbatimi i MFK të jetë më i suksesshëm.

Si prioritet tjetër që del nga Partneriteti European është që nën koordinimin e Ministrisë së Financave, të zhvillohen dhe të zbatohen principet e përgjegjësisë së decentralizuar të menaxhimit dhe funksionalitetit, auditimit të brendshëm të pavarur në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira gjatë këtij viti janë ndërmarre disa veprime siç është Udhëzimi administrativ për krijimin e NjAB i cili është duke u harmonizuar me Ligjin e Ri të Auditimit i cili është shpall nga Presidenti në fund të tetorit 2009 në bashkëpunim me ekspertet e BE.

Gjithashtu Udhëzimi administrativ për themelimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është miratuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave në dhjetor të vitit 2009.

Sipas Ligjit për auditim të brendshëm nr 02/L-74 neni 5 Përgjegjës për krijimin dhe funksionalizimin e komiteteve të auditimit janë organizatat buxhetore. Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm ka nxjerre udhëzimin për komitetet të auditimit, praktikrat më të mira për komitete të auditimit dhe model statutin e komiteteve të auditimit dhe të gjitha organizatat buxhetore janë pajisur me këto udhëzime .

#### ***h. Statistikat***

Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka funksionuar si zyrë profesionale qysh prej vitit 1948. Më 2 gusht 1999, ESK-ja rifilloi punën e tij si institucion i pavarur dhe profesional i administratës publike në Kosovë sipas rregullores 2001/14(UNMIK).



ESK-ja është agjencion ekzekutive brenda Ministrisë së Administratës Publike (MAP).

ESK për këtë vit ka parapare miratimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Kosovës i cili është në procedurë sipër në MAP. ESK ka hartuar planin zhvillimor strategjik 2009-2013 i cili dokument synon prioritetet statistikore të identifikuar nga gjithë akteret që përfshihen në fushat statistikore. Me 19 nëntor 2009 Kuvendi i Kosovës në bazë të Ligjit 2003/16 ka marrë vendim që Regjistrimi i Popullsisë Ekonomike Familjare dhe Banesave të fillojë me 1-15 Prill 2011. Janë ngritur të gjitha grupet profesionale dhe teknike si me ekspert të mbrendshëm ashtu edhe me ekspert ndërkombëtar me përkrahje të Misionit Monitorues Ndërkombëtar si dhe EUROSTAT për implementimin e hartës rrugore të Regjistrimit të Popullsisë.

Gjithashtu janë krijuar grupe punuese në fushat e caktuara me qëllim të përmirësimit, të grumbullimit, përpunimit dhe publikimit të të dhënave statistikore. Janë nënshkruar; Marrveshja e Mirkuptimit me INSTAT-in e Republikës së Shqipërisë, për këmbimin e përvojave profesionale statistikore si dhe Marrveshjet e Mirkuptimit me Ministrinë, Agjencionet, Bankat për këmbimin e të dhënave statistikore.

ESK vazhdon publikimet për të gjitha departamentet prodhuese si dhe statistikat e përgjithshme sipas Kalendarit të publikimeve për vitin 2010. Për të realizuar të gjitha këto ESK-ja ka dhënë premtimin për përmirësimin e Teknologjisë Informatike, infrastrukturës ligjore, ndërtimin e kodifikimit statistikor si dhe në kapacitetet njerëzore (për të cilat jemi limituar në personel dhe buxhet).

ESK merr pjesë në takime të ndryshme ndërkombëtare profesionale, vlen të ceket takimi me temën “Sistemi Informativ, Gjeografik për Statistikë” i organizuar nga EUROSTAT i mbajtur në Luksemburg, ku është prezantuar harta “GEOSTAT Population Map 2010” ku për herë të parë figuron edhe harta e Kosovës. Kjo ishte si rezultat i prezantimit të hartës së Kosovës në Hagë në muajin Tetor 2009. Zyrtarisht jemi informuar se jemi pranuar anëtar i ri me të drejta të barabarta si të gjitha vendet tjera të Evropës të cilat figurojnë në hartë.

### **3.3.3 DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA**

#### ***a. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi***

Pas fillimit të lëshimit të Pasaportave të Republikës së Kosovës, në korrik të vitit 2008, dhe vënies në fuqi të legjislacionit përkatës kornizë dhe atij implementues në këtë fushë, veprimet afatshkurtra synojnë përmirësimin e efikasitetit të kontrollit të lëvizjeve të personave në kufi dhe të efektivitetit dhe transparencës së Policisë Kufitare, forcimin e bashkëpunimit me agjencitë e menaxhimit të kufirit në vendet fqinje, zhvillimi i infrastrukturës për pritjen e azilkërkuësve, hartimi, miratimi dhe zbatimi i legjislacionit dhe politikave për riatdhesim dhe ri-integrimin e të riatdhesuarve si dhe legjislacionit përkatës për lëshimin e dokumenteve biometrike.

Sa i përket kornizës ligjore, veprimet fokusohen në çështjet e MIK-ut, dokumenteve të identifikimit e atyre të udhëtimit, statusit civil, si dhe në ato të shtetësisë dhe regjimit të ardhshëm të vizave të Republikës së Kosovës. Sa i përket ndërtimit të institucioneve në këtë fushë, ato fokusohen në themelimin dhe funksionalizimin e Agjencisë për Regjistrim Civil, në kuadër të procesit të gjithëmbarshtëm të implementimit të rishikimit funksional për MPB-në. Një kategori tjetër ka të bëjë me

forcimin me strukturat institucionale ndërkombëtare për zbatimin e ligjit (me Interpol-in dhe Frontex-in), kurse në një nivel më teknik ato kanë të bëjnë me vendosjen e infrastrukturës teknike për mbështetjen e funksionimit të infrastrukturës institucionale, përkatësisht lidhen me një numër bazash të të dhënave (për lëshimin e vizave, të dhënat biometrike dhe migrimin, si dhe integrimin e bazave të të dhënave të të gjitha agjencive relevante për zbatimin e ligjit), si dhe me përmirësimi i infrastrukturës së objekteve në pikat kufitare.

Sa u përket trajnimeve, ato do të fokusohen në zbatimin e politikës së vizave, kurse në nivelin e implementimit, veprimet do të fokusohen në lëshimin e pasaportave biometrike të Republikës së Kosovës, Procedurat Standarde Operative (PSO) për kontrollin e kufirit, vlerësimin e zbatimit të kësaj të fundit dhe Strategjisë MIK dhe të rrezikut në lidhje me "kufirin e gjelbër" dhe pikat e kalimit kufitar, si dhe fillimin e transferimit të përgjegjësive mbi vijën e gjelbër dhe të kaltër të kufirit nga KFOR-i tek PK përgjatë kufirit me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Me qëllim të përmbushjes së prioriteteve afatmesme në këtë fushë – përmirësimi të mëtejshëm të kapaciteteve të MPB-së dhe të Policisë së Kosovës – masat përkatëse për ndërtimin e institucioneve fokusohen në funksionalizimi e strukturës së re të MPB-së, e cila përfshin, ndër të tjera, riorganizimin e Departamentit për Kufij, Azil dhe Migrim (DKAM) në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM), themelimi e funksionalizimi i Departamentit të MPB-së për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Politikave, si dhe në vendosjen e bashkëpunimit operacional në mes të DShAM-it dhe Policisë Kufitare. Sa i përket kapaciteteve, masat përkatëse përshijnë rritjen e numrit të personelit të DShAM-it, ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së MPB-së për Koordinim dhe Integrim European, rritjen e numrit të stafit të DShAM-it, si dhe trajnimin e stafit të DShAM-it dhe DMH-së (PK) për çështjet e vizave dhe lejeve të qëndrimit.

### ***b. Shpëlarja e parave***

Luftimi i shpëlarjes së parave akoma përballlet me mungesë të kornizës ligjore dhe institucionale vendore. Marrë parasysh këtë, si dhe rëndësinë e luftimit të shpëlarjes së parave për sundimin e ligjit si prioritet strategjik afatshkurtër, si në nivelin politik ashtu edhe në kuadër të Partneritetit European – i cili kërkon gjithashtu ngritjen e kapaciteteve institucionale përgjegjëse për luftimin e këtij lloji të krimit, përfshirë qartësimin e kompetencave në mes tyre dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara për gjyqtarë dhe prokurorë – PVPE 2010 parasheh një numër veprimesh.

Sa i përket kornizës legjislative, masat e parapara adresojnë specifikisht parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit, dhe menaxhimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara. Sa i përket ndërtimit të institucioneve në këtë fushë, ato lidhen me të gjitha aspektet institucionale të një Qendre të ardhshme kosovare të Inteligjencës Financiare, përfshirë një sistem raportimi të detyrueshëm dhe adekuat të subjekteve jo-bankare të kjo e fundit, si dhe me Agjencinë e ardhshme për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale, veprimet e planifikuara kanë të bëjnë me shtimin e personelit në Sektorin për Hetime Financiare të PK-së, ofrimin e trajnimeve të specializuara stafit të gjyqësorit dhe agjencive të zbatimit të ligjit, përfshirë atyre të

Drejtorisë së PK-së për Hetimin e Krimit Ekonomik, Financiar dhe Korrupsionit, dhe furnizimin e saj me pajisje teknike.

### ***c. Drogat***

Përkundër përparimit të shënuar në luftimin e trafikimit të narkotikëve, në veçanti sa i përket bazës ligjore dhe të politikave, agjencitë kosovare për sundimin e ligjit akoma përballen me mungesë resursesh të mjaftueshme për luftimin e efektshëm të drogave, me theks të veçantë në hetimin e tyre, PVPE 2010 parasheh një numër veprimesh afatshkurtra. Sa i përket legjislacionit implementues, ai adreson zvogëlimin e dëmeve shëndetësore dhe sociale të ndërlidhura me drogën. Sa u përket aspekteve institucionale, veprimet parashohin përmirësimi i bashkëpunimit operacional ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit, themelimin e një Qendre për Rehabilitim Social, shtimin e numrit të personelit policor dhe gjyqësor për qëllime hetuese, si dhe trajnimin e prokurorëve, personelit policor, korrektues dhe atij doganor. Më tej, gjithashtu është planifikuar rritja e numrit të qenve të trajnuar për zbulimin e drogave, implementimin e projektit kapital për përgjim ligjor, sigurimin e pajisjeve përkatëse dhe sigurimin e objekteve adekuate për depozitimin e drogave të konfiskuara.

### ***d. Policia***

Pas vendosjes së kornizës ligjore themelore për funksionimin e saj, dhe me qëllim të përmbushjes së mandatit të saj përtej funksioneve të ruajtjes së rendit publik, në veçanti për luftimin e krimit të organizuar, Policia e Kosovës është në proces të reformimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të saja strategjike për përmbushjen e mandatit të saj ligjor. Në afat të shkurtër, me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore, PVPE 2010 parasheh plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit mbi Policinë. Sa u përket aspekteve institucionale, ato kanë të bëjnë me operacionalizimin e strukturës së reformuar të PK-së, me prioritet në strukturat udhëheqëse dhe komanduese të saj, pastaj përmirësimin e bashkëpunimit të saj me Prokurorinë dhe të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, si dhe emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, në kontekstin e ekzekutimit në mënyrë të pavarur të funksioneve të këtij institucioni.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale, parashihet zhvillimi i kapaciteteve të PK-së për planifikim strategjik dhe për të zbatuar një sistem policimi të udhëhequr nga/bazuar në inteligjencë (ILP), trajnimi i zyrtarëve të Shtyllës së Krimit në të gjitha fushat e hetimit dhe luftimit të krimit, avancimi, integrimi dhe sigurimi i rrjeteve të komunikimit, sidomos me stacionet policore në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe vendosja e kanaleve të komunikimit dhe shkëmbimit të informatave zbulimore me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Më tej, janë planifikuar veprime specifike për Policinë me qëllim të luftimit të krimit të organizuar, përfshirë bashkëpunimin operacional të saj me funksion-bartësit e tjerë përgjegjës për këtë, rritjen e numrit të personelit femra në Njësitë e OK-së për Luftimin e Trafikimit me Qenieve Njerëzore, ofrimin e trajnimeve stafit përgjegjës për luftimin e krimit të organizuar, si dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme teknike për këtë qëllim.

### ***e. Luftimi i krimit dhe krimit të organizuar***

Kosova ka shënuar progres në vendosjen e bazës ligjore dhe hartimin e dokumenteve strategjike Megjithatë, sfidë mbetet mungesa e resurseve adekuate për luftimin efektiv

të këtyre dukurive përmes një qasjeje sistematike, përfshirë mungesën e një sistemi të inteligjencës penale dhe të infrastrukturës ligjore e institucionale për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në përgjithësi, Raporti i Progresit 2009 ka vënë në dukje një shkallë të ulët të implementimit të strategjive dhe planeve të veprimit për luftimin e llojeve të ndryshme të krimit të organizuar dhe të teorizimit.

Prioritetet afatshkurtra që kërkojnë përmirësimin e efektivitetit të hetimit të krimeve, reduktimin e krimit, si dhe mbledhjen e armëve të vogla e rregullimin e çështjeve që ndërlidhen me to, PVPE 2010 parasheh, përveç masave të specifikuara në pjesën mbi Policinë, vënien në fuqi të kornizës ligjore për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, të krimit në Internet (cyber-crime), për klasifikimin e informatave e të dhënave, si dhe të tri ligjeve të reja kornizë që rregullojnë fushën e çështjeve penale. Kjo përfshin edhe legjislacionin kornizë dhe implementues për armët e vogla dhe dokumentet strategjike për policinë në komunitet dhe për sigurinë kombëtare.

Sa i përket ndërtimit të institucioneve dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre, masat parashohin themelimin një Departamenti për Siguri Publike në kuadër të MPB-së, ngritjen e kapaciteteve institucionale të inteligjencës penale për luftimin e krimit, rritjen e numrit të gjyqtarëve përgjegjës për luftimin e krimit të organizuar dhe atij financiar, përmirësimin e sistemit të statistikave të krimeve me qëllim që ato të shërbejnë si udhërrëfyes për punë me caqe/objektiva precize, zhvillimin e bazave të të dhënave dhe sistemit të TI-së për eksplozivë dhe armë zjarri, ndërtimi i një depoje për mbajtjen e eksplozivëve komercialë, si dhe përmirësimi i kushteve në qendrat e paraburgimit. Në nivelin e implementimit, veprimet parashohin zbatimin e procedurave standarde operative për luftimin e krimit të organizuar dhe të legjislacionit zbatues për Këshillat Komunalë për Sigurinë në Komunitet, vetëdijësimin e qytetarëve mbi rreziqet nga armëve të zjarrit dhe përdorimi i paligjshëm i armëve, si dhe hetimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve për qëllime të lypjes së detyruar dhe të korrupsionit të ndërlidhur me këtë fenomen kriminal. Kjo përfshin edhe kontrollimin më të mirë të pikave të kalimit kufitar 1 dhe 31 dhe zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Prokurorisë dhe Drejtorisë Kombëtare Anti-Mafi të Italisë.

#### ***f. Mbrojtja e të dhënave personale***

Megjithëse Republika e Kosovës ka marrë përgjegjësitë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale nga qershori 2008, akoma nuk është materializuar ndonjë përparim konkret në këtë fushë. Sidoqoftë, përparimi i shpejtë në këtë fushë është i domosdoshëm për procesin e liberalizimit të vizave me BE-në. Prandaj prioriteti afatshkurtër në këtë fushë do të përmbushet nëpërmjet masave që parashohin vendosjen e bazës themelore ligjore dhe institucionale për këtë fushë. Sa u përket masave afatmesme, ato kanë të bëjnë me zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit në këtë fushë, përfshirë masa të ndërlidhura – harmonizimin e tërë legjislacionit ekzistues që rregullon çështjet e sigurisë me atë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe reformimin e bazave përkatëse të të dhënave në përputhje me këtë legjislacion – si dhe zhvillimin e sistemeve për mbrojtjen e të dhënave personale, ofrimin e trajnimeve profesionale agjencive të zbatimit të ligjit përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informimin e ngritjen e vetëdijes së qytetarëve mbi rëndësinë e të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre.

#### **4. LIDHJA ME DOKUMENTET STRATEGJIKE TË QEVERISË**

Lidhja ndërmjet PVPE dhe KASH në radhë të parë qëndron në prioritetin strategjik që theksohet në dokumentin e KASH 2010 -12 i cili është “objektivi i integritetit gjithnjë e më të madh si me rajonin por edhe në drejtim të forcimit të partneritetit me Bashkimin Europian”.<sup>3</sup> Politikat strategjike të Qeverisë në KASH janë të orientuara drejt plotësimit të reformave në sektorët kyç dhe shtyllat kryesore që sigurojnë një zhvillim të Kosovës në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian.<sup>4</sup>

Përcaktimi i prioriteteve të KASH të ndërlidhura me prioritetet e PVPE, kërkon dhe një reflektim të kostos financiare të PVPE në dokumentin e KASH. Grupi punues i themeluar me vendim të Qeverisë Nr. 079/09 të datës 19 mars 2009, mbetet një mekanizëm i rëndësishëm qeveritar për kalkulimin e kostos financiare të veprimeve brenda PVPE-së dhe përfshirjen e tyre brenda KASH-it, buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Megjithatë një rëndësi i është dhënë kalkulimit të kësaj kostoje direkt nga ministritë dhe agjencitë qeveritare. Lidhja e PVPE-së me KASH ndihmon dhe për identifikimin e nevojave financiare të cilat mund të mbulojnë nga kontributi që donatore të ndryshëm mund të japin në këtë aspekt. I tërë ky sistem do të sigurojë që PVPE-ja si një dokument strategjik, të jetë financiarisht i mundshëm për tu zbatuar.

Hartimi nga AKZHIE e metodologjisë për përfshirjen e veprimeve të PVPE në KASH dhe Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës po ndihmon në përmirësimin e procesit të llogaritjes së kostos financiare të veprimeve të PVPE-në , por ky proces ende nuk është një proces i realizuar plotësisht dhe ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Hapa të rëndësishëm janë marre gjatë fundit të vitit 2009 për lidhjen e PVPE me Planin të Veprimit të Qeverisë për vitin 2010. AKZHIE realizoi analizën e raportit të Progresit të paraqitur nga Komisioni Europian dhe në nëntor 2009, paraqiti pranë Qeverisë dokumentin “Prioritetet Strategjike të Kosovës për vitin 2010 dhe veprimet për përmirësimin e tyre”, ku u identifikuan 10 prioritetet më të rëndësishme të dalta nga analiza e Raportit të Progresit të KE-së, nga të cilat 9 u përfshinë në prioritetet dhe objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës. Në këtë mënyrë është siguruar një ndërlidhje e të dy dokumenteve të rëndësishëm dhe harmonizim të prioriteteve strategjike të qeverisë. Në nivel aktivitetesh ky harmonizim është arritur në masën 78%.

#### **5. RAPORTIMI DHE MONITORIMI I PVPE-SË DHE INDIKATORËT E MATJES**

Korniza e sistemit të monitorimit dhe raportimit të PVPE-së ka për qëllim që të sigurojë një qasje të njëjtë dhe procedura standarde të bazuar në rregullimet dhe përgjegjësitë ligjore. Sistemi gjithashtu ka për qëllim të paraqes formën e monitorimit të cilat do të ndihmojnë në cilësinë e të dhënave dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të tyre si dhe të paraqesë një kornizë të indikatorëve si mjet për vetëvlerësim, të sigurojë që

---

<sup>3</sup> Shih KASH 2010-2011 seksioni Hyrje, faqe 5.

<sup>4</sup> Shih KASH 2010 – 2011 seksioni 1.3 Prioritet politike, faqe 5,6

dobishmëria e informatave të monitoruara dhe raportuara të jetë forca themelore për mekanizmin e zgjidhjes së problemeve dhe përkrahjes së vendim marrjes.

Korniza është në përputhje me kërkesat procedurale dhe ligjore që dalin nga dokumentet ligjore për procesin e PVPE-së, dhe praktikën e tanishme për koordinim dhe monitorim të implementimit.

Koordinimi i monitorimit dhe raportimit bëhet nga Ministria e Integritimit Europian si kanal qendror i koordinimit dhe përkrahjes së PVPE-së përmes rrjetit të Zyrave për Integritim Europian, si pika qendrore nëpër ministrinë e linjës dhe institucionet tjera qeveritare. Në veçanti Monitorimi dhe raportimi bëhet përmes Strukturave të Koordinimit, brenda mandatit të përshkruar në dokumentet ligjore ekzistuese: GPIE (Grupet Punuese për Integritim Europian), KPIE (Komitetin Punues për IE) dhe KMIE (Këshillin Ministror për IE) duke siguruar përputhshmëri me sistemin vendimmarrës të qeverisë dhe DPSA-në (Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit).

Korniza e PVPE-së paraqet një **forme të qartë kohore** për raportim të implementimit. Veprimet në vijim duhet të ndërmerren nga të gjitha institucionet qeveritare (agjencitë) me qëllim të raportimit dhe monitorimit të implementimit të PVPE-së:

- Vlerësimi i progresit të PVPE-së përballë Raportit të Progresit të KE **në bazë vjetore** (Tetor/Nëntor). Vlerësimi duhet të shërbejë për analizë të reformave të ndërmarra, identifikimin e veprimeve të reja, dhe planifikimit të resurseve për zbatim;
- Të gjitha institucionet qeveritare (agjencitë) përmes sistemit të themeluar të koordinimit dhe rrjetit të zyrtarëve për IE si pika referente, të dorëzojnë informata mbi progresin e PVPE-së tek MIE fillimisht çdo tre muaj pastaj **në bazë mujore**;
- Të gjitha strukturat e koordinimit rregullisht të mbajnë **takime mujore** për të rishikuar progresin në PVPE dhe performancën e raporteve mujore, të diskutojnë çështjet e hapura dhe veprimet e duhura të ndërmerren
- Në **baza tre mujore** (posaçërisht në periudhat qershor – shtator) raportet gjithëpërfshirëse të progresit PE/PVPE duhet të përgatiten, dhe të komunikohen me KE si kontribut për Raportin vjetor të Progresit të KE.

Sistemi është prezantuar nga projekti WYG financuar nga DFID të vjeshtën e vitit 2009, me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, kurse ka vazhduar funksionalizimi i tij me ndihmën e projektit të Binjakëzimit për përkrahje Ministrisë së Integritimit Europian. Me anë të sistemit të monitorimit dhe raportimit deri tani janë zhvilluar dy cikle të raportimit dhe atë për periudhën shtator-dhjetor 2009 dhe janar – mars 2009. Këto dy cikle kanë pas për qëllim krijimin dhe fuqizimin e procesit të raportimit për të siguruar një proces të suksesshëm për grumbullimin e të dhënave nga ministrinë e linjës dhe institucionet tjera.

Deri në stadin aktual monitorimi i PVPE-së ka qenë i fokusuar në drejtim të formulimit dhe monitorimit të procesit kundrejt respektimit të afateve dhe realizimit të produkteve kryesore të dala nga secili veprim. Theksi ka qenë me shumë në drejtim të raportimit se sa të analizimit të ecurisë. Këtë vit janë ndërmarre hapat e para për të futur në PVPE treguesit (indikatorët) e matjes së performancës së arritjeve në disa

sektorë si arsimi, transporti dhe bujqësia, në anën tjetër puna në përcaktimin e indikatorëve do të vazhdoj edhe gjatë procesit të monitorimit dhe raportimit të PVPE-së. Megjithëse treguesit e propozuar këtë vit paraqesin vetëm tregues që do masin arritjet në synimet për vitin 2010, ky është një hap pozitiv në drejtim të përmirësimit të metodës së monitorimit të PVPE-së.

Ministria e Integrimit European synon që në rishikimin e ardhshëm të PVPE-së të shtrijë përfshirjen e treguesve në sektorë të tjerë, dhe të kalojë nga tregues vjetorë në tregues që mund të matin ecurinë mbi periudha afatmesme, duke përcaktuar qartë treguesit e nivelit bazë (baseline indicators) dhe treguesit e pritshëm (target indicators). Në këtë mënyrë synohet në një përmirësim të procesit të monitorimit dhe raportimit duke kaluar nga raportim në monitorim dhe analizë të progresit të bërë dhe të ndikimit të reformave të ndërmarra.

## 6. MATRICA E VEPRIMEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EUROPIAN 2010

EPP	Veprimi	Afati	Institucioni Përgjegjëse	Institucioni Mbeshtetes	Dokument Referuese
<b>Prioritetet Kyçe</b>					
	<b>0 PRIORITETET KYÇE</b>				
	0 Prioritetet Kyçe				
	0 <i>Prioritetet Kyçe</i>				
1	1. Të vazhdohet të punohet me ekipet për planifikim për përgatitjen e Misionit të parashikuar ndërkombëtar/ të BE-së, me qëllim që të mund të zbatohet plotësisht një marrëveshje.				
2	2. Të bashkëpunohet konstruktivisht në çështjet që kanë të bëjnë me Serbinë.				
2	2.1 Të identifikohen çështjet për bashkëpunim me Serbinë në të ardhmen	Në vazhdimësi	ZKM		
3	3. Të sigurohet bashkëpunim i plotë me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi.				
3	3.1 Të hartohet legjislati që do të rregullojë bashkëpunimin me Tribunalin për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi	K4 - 2010	MD		
3	3.2 Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar	K4 - 2010	MD	KGJK, Prokuroria e Kosovës, ZKM, MEF, Policia e Kosovës, Profesor Universitar, etj.	Plani vjetor i punës 2010
4	4. Të sigurohet respektimi i plotë i sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, si dhe të ndiqet një politikë për zero tolerancë ndaj korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimit financiar.				
4	4.1 Miratimi i katër ligjeve për reformimin e gjyqësorit: Ligji për gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligji për Prokuroritë dhe Këshillin Prokurorial.	K4 - 2010	Kuvendi		
4	4.2 Përfundimi i procesit të emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.	K4 - 2010	KGJK		
4	4.3 Miratimi i projektligjit për të drejtat e njeriut në Kosovë	K2 - 2010	ZKM		
4	4.4 Kompletimi i kornizës institucionale për monitorimin e zbatimit të normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut	K4 - 2010	ZKM		



4	5	4.5 Zbatimi i një zgjidhjeje të qëndrueshme për pjesëtarët e komunitetit rom që jetojnë në kampet e kontaminuara me plumb. ZÇK/ZKM dhe MKK, në bashkëpunim me njëri-tjetrën dhe me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, të identifikojnë masat e mëtejshme.	K4 - 2010	ZKM	MKK	
4	6	4.6 Implementimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Komunitetit RAE	K4 - 2012	ZKM	MKK, dhe institucionet Qendrore , Lokal , Agjencitë përgjegjëse	Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali, Egjiptas ( 2009-2015 ) Plani i Punës 2009
4	7	4.7 Miratimi i strategjisë së përgjithshme dhe planit të veprimit të MKK-së 2009-2013 si dhe 'Doracakut për Kthim të Qëndrueshëm'	K1 - 2010	MKK	ZÇK, Komunitat e Kosovës,	
4	8	4.8 Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor kundër korrupsion dhe harmonizimi i tij me standardet Evropiane	K4 - 2010	AKK		
4	9	4.9 Të zhvillohet një koncept që do të mundësonte përgatitjen e strategjive sektoriale për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit	K4 - 2010	AKK	Kuvendi, Ministritë e linjës dhe institucionet tjera	
4	10	4.10 Të përcaktohet korniza procedurale/ligjore për ratifikimin e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare	K2 - 2010	Kuvendi		
4	11	4.11 Miratimi i ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave të parave dhe financimit të terrorizmit	K2 - 2010	Kuvendi		
4	12	4.12 Miratimi Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Agjencinë Kundër-Korrupsionit.	K1 - 2010	Kuvendi		
4	13	4.13 Miratimi i Projektligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë	K2 - 2010	Kuvendi	MD	Strategjia Legjislative 2009
4	14	4.14 Themelimi i Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuara	K3 - 2010	MD	Prokuroria e Shtetit	Ligji mbi Menaxhimin e Pasurive së Sekuestruara dhe të Konfiskuara
4	15	4.15 Ngritja e kapaciteteve për transferimin e përgjegjësi në fushën e krimit financiar nga EULEX, përfshirë nënshkrimin e aranzhimeve teknike për të arritur këtë.	K2 - 2010	MIE	MPB, PK, PSH	
4	16	4.16 Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.	K2 - 2010	Kuvendi	MD	
4	17	4.17 Përkrahja e implementimit të strategjive kundër krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore dhe kundër drogave.	Në vazhdimësi	MPB	PK, PSH, MD, MSH, KGJK, MPMS.	
4	18	4.18 Implementimi i një sistemi policimi të udhëhequr/bazuar në inteligjencë (ILP).	K2 - 2012	PK	MPB	

5	0	<b>5. Të sigurohet qeverisje demokratike dhe bartje e shërbimeve publike tek të gjithë qytetarët e Kosovës, duke vendosur administratë publike përfaqësuese e cila të jetë profesionale, e përgjegjshme, e arritshme dhe e liruar nga ndërhyrjet politike.</b>			
5	1	5.1 Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të RAP	Në vazhdimësi	MAP	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Reformën e Administratës Publike
5	2	5.2 Miratimi i ligjeve bazike për reformën e administratës publike: Ligji për Qeverinë, Ligji mbi pagat e shërbyesve civil, dhe Ligji mbi Shërbimin Civil	K3 - 2010	Kuvendi	
5	3	5.3 Të përcaktohen kompetencat e institucioneve dhe procedurat për emërimet e shërbyesve të lartë civil në shërbimin civil të Kosovës, bazuar mbi ligjin për Shërbimin Civil	K3 - 2010	ZKM	Strategjia legjislative
5	4	5.4 Reformimi i sistemit zgjedhor duke përfshirë implementimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian për zgjedhjet	K4 - 2010	KQZ	Kuvendi
6	0	<b>6. Të avansohet reforma e vetë-qeverisjes dhe të ngriten kapacitetet administrative për të ndihmuar decentralizimin, duke i marrë parasysh synimet dhe interesat e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të miratohet korniza legjislative dhe të ndahen resurset e duhura buxhetore.</b>			
6	1	6.1 Miratimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e të ligjit për Vetëqeverisje Lokale	K2 - 2010	MAPL	Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Karta Evropiane mbi Vetëqeverisje Lokale
6	2	6.2 Themelimi the funksionalizimi i Komunave te reja	K4 - 2010	MAPL	
6	3	6.3 Ngritja e kapaciteteve administrative për absorbimin e kompetencave të reja	K2 - 2010	MAPL	
6	4	6.4 Themelimi i institutit për politika të vetëqeverisjes lokale	K3 - 2010	MAPL	
6	5	6.5 Harmonizimi i statuteve te komunave me shumice serbe konform ligjit për vetëqeverisje lokale dhe miratimi i statuteve te reja nga komunat e mbetura Graçanicë, Ranillugë, Kllokot, Partesh, Novobërda e zgjeruar dhe Mitrovica e veriut pas themelimit të saj si Komunë	K4 - 2010	MAPL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
6	6	6.6 Miratimi i Ligjit për Menaxhimin e Pronës se Paluajtshme Komunale	K2 - 2010	Kuvendi	MAPL
6	7	6.7 Miratimi i Ligjit për Emrat e Vendbanimeve ne Komuna	K4 - 2010	Kuvendi	MAPL
6	8	6.8 Miratimi i Projektligjit për Qytetin e Prishtinës	K3 - 2010	Kuvendi	MAPL
7	0	<b>7. Të krijohet një atmosferë adekuate për pajtim, tolerancë ndër-etnike dhe shumë-etnicitet të qëndrueshëm që i çon drejt kthimit të personave të zhvendosur. Të sigurohet respekt, siguri, liri e lëvizjes dhe pjesëmarrje e të gjitha komuniteteve. Të dënohen në</b>			

<b>mënyrë eksplicite të gjitha manifestimet e ndjenjës kundër-minoritare. Ashpër të dënohen të gjitha krimet ndër-etnike.</b>						
7	2	7.1 Vlerësimi dhe përgatitja për zgjedhjen e projekteve për zhvillimin e komuniteteve	K4 - 2010	MKK		
7	3	7.2 Zhvillimi i programeve të partneritetit me komunitet dhe palët e tjera me synim sigurimin e resurseve financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit, që të mundësojë kthimin.	K4 - 2010	MKK	Komunat	
7	4	7.3 Identifikimi i mekanizmave për nxitjen e bizneseve për minoritetet.	K4 - 2010	MKK	Komunat dhe Doganat	Plani i Punës 2009
7	5	7.4 Zyra e Prokurorit Shtetëror të trajtojë me prioritet krimet ndër-etnike.	Në vazhdimësi	PSH		
7	7	7.5 Incimi i programeve dhe projekteve të cilat kanë të bëjnë me krijimin e një atmosfere adekuate të tolerancës ndër-etnike.	K4 - 2010	MKK	Zyra për Komunitete pranë ZKM-së	Plani i Punës 2009 dhe Doracak për Kthim të Qëndrueshëm.
7	8	7.6 Krijimi i programit për vlerësim në Terren dhe Komunikimi me Kthyerit përmes: 1. funksionalizimit të grupit për terren dhe komunikim. 2. vlerësimeve periodike dhe publikimeve të raporteve lidhur me gjendjen e të kthyerve dhe të personave të zhvendosur	K4 - 2010	MKK		
8	0	<b>8. Të sigurohet respekt i plotë për lirinë e religjionit. Të sigurohet mbrojtja e trashëgimisë religjioze dhe kulturore, dhe të ndërmerren hapa për parandalimin e sulmeve në këto vende dhe ndjekjen e kryesve të tyre.</b>				
8	2	8.2 Themelimi i inspektoratit për Trashëgimi Kulturore	K4 - 2010			
8	3	8.3 Hartimi i dokumentit strategjik mbi konservimin e integruar të tërësive kulturore dhe natyrore.	K4 - 2010	MKRS		
8	4	8.4 Kthimi i Thesarit Arkeologjik dhe Etnologjik dhe vendosja e tyre e përhershme në Muzeun e Kosovës, si dhe kthimi i dokumentacionit në Institutin për Mbrojtje të Monumenteve të 426 objekteve.	K4 - 2010	MKRS	ZKM/SKQ dhe ICO	Aneksi V I Pakos së Ahtisaarit, Plani I Punës 2009
9	0	<b>9. Të krijohet një shoqëri e lirë nga diskriminimi i çfarëdo lloji, dhe të promovohet integrimi i grupeve të disavantazuara.</b>				

9	1	9.1 Ngritja e mekanizmave në fushën e të drejtave të njeriut për të siguruar implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2009-2011.	K4 - 2010	MAPL		Programi për zhvillimi profesional të NJDNUK - Planit I veprimit për të Drejtat e Njeriut 2009 - 2011, Planit I Punës 2010 I MAPL-se	
9	2	9.2 Të funksionalizohen të gjitha njësitë për të drejtat e njeriut nëpër Komunë, si dhe të zbatohet programi për ngritjen e kapaciteteve të njëjësive për drejtat e njeriut në nivelin lokal.	K4 - 2010	MAPL	ZKM	Plani I veprimit për të Drejtat e Njeriut 2009 - 2011, Planit I Punës 2010 I MAPL-se	
9	3	9.3 Organizimi i fushatave të vetëdijesimit për ligjin kundër diskriminimit	K4 - 2010	ZKM	Ministritë e Linjës dhe Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Komuna	Ligji kundër Diskriminimit 2004/32	
9	4	9.4 Implementimi I Planit Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara.	K4 - 2010	ZKM	MASHT, MPMS, MSH, MMPH, si dhe Ministritë tjera të linjës	Plani Kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2009 - 2011	
9	5	9.5 Organizimi i fushatës gjithëpërfshirëse vetëdijesuese për promovimin e të drejtave të njeriut - parimit të diversitetit, pa diskriminim në çfarëdo baze.	K4 - 2010	ZKM		Ligji Kundër Diskriminimit	
10	0	<b>10. Të vazhdohet me forcimin e të drejtave pronësore, kornizës ligjore dhe qasja në gjykata, me vizion të promovimit të një mjedisi të përshatshëm për biznes.</b>					
10	1	10.1 Referohuni Prioritetit 120., Veprimeve 1, 2, 3, 4, 5.	NA*	NA			
<b>Prioritetet Afat-Shkurtra</b>							
<b>1 KRITERET POLITIKE</b>							
<b>11 Demokracia dhe Sundimi i Ligjit</b>							
<i>111 Institucionet</i>							
11	0	<b>11. Të sigurohet funksionimi efektiv i Kuvendit dhe komisioneve të tij, i Qeverisë dhe komunave, përfshirë respektimin e plotë të të gjitha rregulloreve të punës, kodeve të mirsjelljes, si dhe të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve.</b>					
11	1	11.1 Miratimi i Rregullores së re të punës së Kuvendit	K2 - 2010	Kuvendi			

11	2	11.2 Forcimi i koordinimit dhe komunikimit në mes të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës përmes themelimit të pikave të kontaktit.	K3 - 2010	Kuvendi		
11	3	11.3 Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të shqyrtoj projektligjet në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.	Në vazhdimësi	Kuvendi		
11	4	11.4 Të plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë përkrahimin e detajuar të detyrave të punës me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe mbështetjes profesionale të Kuvendin dhe organet e tij.	K3 - 2010	Kuvendi		
11	5	11.5 Miratimi i Projektligjit mbi Qeverinë e Kosovës.	K3 - 2010	Kuvendi	MSPH	
11	6	11.6 Hartimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003 / 12 për qasje në dokumente zyrtare	K3 - 2010	ZKM		
11	7	11.7 Hartimi dhe miratimi i Projektligjit për konfliktin administrativ	K2 - 2010	MAP		
11	8	11.8 Hartimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2/L-28 për procedura administrative	K1 - 2010	MAP		
11	9	11.9 Raportimi i regullt gjashtëmuor për punën e komunës. (Raporti për pjesën ekzekutive dhe politike)	Në vazhdimësi	MAPL	Komunat	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
11	10	11.10 Të finalizohen UA për Përdorimin e gjuhëve në komunat: Gillogoci, Vitiia, Podujeva, Malisheva, Deçani, Kaçaniku, Hani i Elezit, Skenderaj, Shtërpa, Leposaviqi, Zubin Potoku, Zveçan.	K4 - 2010	Komunat	MAPL	
11	11	11.11 Miratimi i statuteve të reja nga Komunitet e mbetura: Graçanicë, Ranillug, Klokoç, Partesh, Novobërdë e zgjeruar dhe Mitrovica e Veriut pas themelimit të saj si komune	K4 - 2010	Komunat		
11	12	11.12 Te behet decentralizimi ne komuna nga niveli i programeve ne nivelin e nen programeve për arsim dhe shëndetësi	K2 - 2010	MEF	Banka Botërore	Plani Kontabël për Komuna 2009
11	13	11.13 Ngritja dhe zbatimi i sistemit te vlerësimit te performances se komunave. Hartimi i Doracakut për Vlerësim dhe Matje te Performances dhe përgatitja e raporteve te vlerësimit.	Në vazhdimësi	MAPL		
11	14	11.14 Monitorimi i zbatimit te akteve ligjore dhe publikimi i te dhënave te dala nga monitorimi ne ueb-faqen e MAPL ne mënyrë qe te rritet transparencja e te informohen gjerësisht qytetarët.	Në vazhdimësi	MAPL	Komunat	
11	15	11.15 Hartimi i Planit për realizimin dhe ngritjen e nivelit të planifikimit të të hyrave vetanake.	K2 - 2010	MAPL		

12	0	<b>12. Të rritet mbikëqyrja e ekzekutivit nga ana e Kuvendit, si dhe të përmirësohet transparencja dhe llogaridhënia brenda Kuvendit. Të forcohet kapaciteti administrativ i Kuvendit.</b>					
12	1	12.1 Hartimi dhe publikimi i raporteve tre-mujore mbi shpenzimet e Kuvendit.	Në vazhdimësi	Kuvendi			
12	2	12.2 Shqyrtimi i raporteve të institucioneve të pavarura të themeluara nga Kuvendi.	Në vazhdimësi	Kuvendi			
12	3	12.3 Publikimi i konkluzioneve të mbledhjeve të komisioneve parlamentare.	K4 - 2010	Kuvendi			
12	4	12.4 Të hartohet Udhëzimi Administrativ në lidhje me procedurat për kërkesat e qytetarëve për të ndjekur seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve.	K3 - 2010	Kuvendi			
12	5	12.5 Të sigurohet me kohe publikimi i rezultateve të votimeve dhe transkripteve të seancave plenare në ueb faqen e Kuvendit	Në vazhdimësi	Kuvendi			
13	0	<b>13. Të publikohet Gazeta Zyrtare në periudha të rregullta kohore, dhe të sigurohet që është plotësisht e saktë. Të përmirësohet kontrolli i përktihmeve të versioneve të ndryshme gjuhësore që të sigurohet se versionet janë identike, si dhe të sigurohet qasja e publikut në Gazetën Zyrtare.</b>					
13	1	13.1 Publikimi i Gazetës Zyrtare 15 ditë pas shpalljes së aktit, në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës.	Në vazhdimësi	ZKM			Ligji mbi Gazetën Zyrtare
13	2	13.2 Miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gazetën Zyrtare	K3 - 2010	Kuvendi			
14	0	<b>14. Të rritet edhe më tej përfaqësimi i minoriteteve në të gjitha institucionet dhe shërbimet publike në nivel komunal dhe qendror.</b>					
14	1	14.1 Mbikëqyrja e Institucioneve qendrore dhe lokale të Shërbimit Civil të Kosovës në lidhje me përfaqësimin e minoriteteve në të gjitha institucionet dhe shërbimet publike në të gjitha nivelet.	Në vazhdimësi	MAP			
14	2	14.2 Përmirësimi i kornizës legjislative nëpërmjet rishikimit/ përgatitjes të tre ligjeve: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale; Projektligji për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale; Projektligji për bashkëpunimin ndërkomunal dhe partneritet	K2 - 2010	MAPL			
14	3	14.3 Zbatimi i Rregulloreve dhe Udhëzimeve administrative të SHCK, sidomos procedurën e rekrutimit me qëllim të inkurajimit të pjesëtarëve të minoriteteve për aplikimin në konkurse dhe zgjedhja sipas meritës	Në vazhdimësi	MAP			
		<b>112 Parlamenti / Zgjedhjet</b>					

15	0	15. Të mbahen zgjedhje të lira dhe të drejta. Të përforcohet Komisioni Qendror Zgjedhor, i pavarur dhe shumë-etnik, që të organizojë zgjedhjet në afatin e duhur kohor.						
15	1	15.1 Përpilimi dhe certifikimi i rezultateve në komunat e mbetura.	K3 - 2010	KQZ				
15	2	15.2 Themelimi i Këshillave të KQZ-së për buxhet, prokurim, personel dhe procedurat e zgjedhjeve, si dhe atyre mbi grupet punuese, udhëzimet dhe procedurat administrative.	Në vazhdimësi	KQZ				
16	0	16. Të sigurohen vendvotime adekuatë, të sigurta për të gjitha komunitetet me qëllim që të lehtësohet ushtrimi i të drejtës së votimit. Të iu mundësohet personave të zhvendosur dhe refugjatëve të marrin pjesë në zgjedhje edhe nëse mundësia e kthimit të tyre në Kosovë është e kufizuar.						
16	1	16.1 Përgatitja e Vendvotimeve për zgjedhjet e ardhshme duke u bazuar në vendosjen e tyre në zgjedhjet e kaluara, dhe hapja e vendvotimeve të reja sipas nevojës.	Në vazhdimësi	KQZ				
17	0	17. Të rritet kontrolli i harmonizimit të legjislacionit të ri me atë të BE-së.						
17	1	17.1 Punësimi i një Koordinatori, dhe dy zyrtarëve profesional, të cilët kanë njohuri të larta mbi të drejtën e BE-së.	K3 - 2010	Kuvendi				
17	2	17.2 Divizioni për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor të punësoj tre zyrtarë profesional, të cilët kanë njohuri të larta mbi të drejtën e BE-së si dhe një zyrtar për koordinim të partneritet evropian.	K3 - 2010	Kuvendi				
17	3	17.3 Zyra për shërbime dhe ndihmë juridike, Sekretaria Koordinuese dhe AKZHIE në Zyrën e Kryeministrit në njërin anë si dhe Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale, Divizionit për Mbështetje Komisioneve Parlamentare si dhe Divizionit për Standardizim, Harmonizim dhe Këshillim Juridik në Kuvendin e Kosovës të bëjnë koordinimin e punëve të nivelit administrativ në mes të dy institucioneve si dhe të ngritin cilësinë e legjislacionit dhe harmonizimin e tij, përfshirë harmonizimin me legjislacionin evropian.	Në vazhdimësi	Kuvendi				
17	4	17.4 Themelimi i Njesisë për Përaftrim të Legjislacionit me atë të BE-së brenda Zyrës Ligjore të ZKM-së.	K4 - 2010	ZKM				Plani për Integrim Evropian 2008-2010
17	5	17.5 Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve në fushën e hartimit të akteve juridike dhe rritjes së numrit të stafit të Zyrave Ligjore të Ministrive të Linjës sipas nevojave të Ministrive përkatëse.	K2 - 2010	ZKM				Plani për Integrim Evropian 2008-2010, Strategjia për Trajtime Evropiane

17	6	17.6 Të përgatitet forma standarde e Deklaratës së Pajtueshmërisë dhe Tabelës së Pajtueshmërisë.	K4 - 2012	MIE	ZKM, IKAP	
		<b>113 Administrata Publike</b>				
18	0	<b>18. Të përforcohet kapaciteti për koordinimin e qeverisjes dhe të definohen më saktësisht përgjegjësitë e të gjitha autoriteteve qendrore dhe lokale për të siguruar konsistencë në zbatimin e politikave. Të forcohet efienca e funksioneve të qeverisë për monitorimin e performancës së shërbimeve publike.</b>				
18	1	18.1 Themelimi dhe funksionalizimi i Njësisë për Planifikim Strategjik ne kuadër të ZKM-se.	K2 - 2010	ZKM		Rregullorja e Punës së Qeverisë 1/2007
18	2	18.1 Të përfundohet cikli i rishikimeve horizontale dhe vertikale për ministritë/institucionet e mbetura	K2 - 2010	MAP		
18	2	18.2 Sistemit menaxhimit të dokumenteve.	K1 - 2010	MAP		Strategjia për Qeverisje Elektronike 2009-2015, Plani i Veprimit.
18	3	18.3 Avancimi i Qendrës së të Dhënave të Kosovës me pajisje te nevojshme teknike.	K3 - 2010	MAP		Strategjia për Qeverisje Elektronike 2009-2015, Plani i Veprimit.
19	0	<b>19. Të zbatohen në mënyrë rigoroze procedura transparente mbi punësimin, transferimin, vlerësimin e punës, promovimin, mbikëqyrjen dhe largimin nga puna të shërbyesve civilë, përfshirë policinë dhe stafin e sistemit gjyqësor, si dhe ato mbi menaxhimin financiar.</b>				
19	1	19.1 Avancimi i e-Portalit	K4 - 2010	MAP		Plani i punës 2010 ,Plani veprimit ,Strategjisë për Qeverisje elektronike 2009-2015
19	3	19.3 Arkivimi elektronik i dokumenteve shtetërore.	K4 - 2010	MAP		Plani i punës 2010 ,Plani veprimit ,Strategjisë për Qeverisje elektronike 2009-2015
19	4	19.4 Zgjerimi i Rrjetit Qeveritar në Komuna	K4 - 2010	MAP		Plani i punës 2010 ,Plani veprimit ,Strategjisë për Qeverisje elektronike 2009-2015



19	5	19.5 Te ristrukturohet Sistemi telefonik Qeveritar ne voice over IP.	K4 - 2010	MAP	MAP	Plani i punës 2010 ,Plani veprimt ,Strategjisë për Qeverisje elektronike 2009-2015
19	6	19.6 Implementimi i sistemit për monitorim dhe siguri të të dhënave	K4 - 2010	MAP	MAP	Plani i punës 2010 ,Plani veprimt ,Strategjisë për Qeverisje elektronike 2009-2015
19	7	19.7 Miratimi i Projektligjit mbi Shërbimin Civil.	K2 - 2010	Kuvendi	MSPH	
19	8	19.8 Modifikimi i sistemit te menaxhimit te burimeve njerëzore sipas kërkesave te ligjit te ri mbi Shërbimit Civil	K2 - 2010	MAP		
19	9	19.9 Përcaktimi i kompetencave të IKAP-it me akte nën-ligjore bazuar ne Ligjin e ri për Shërbimin Civil	K2 - 2010	MAP		
19	10	19.10 Hartimi I Planit Strategjikë të IKAP-it	K2 - 2010	MAP	IKAP	Urdhëresa Administrative e u UNMIK-ut 2003/25 mbi themelimin e IKAP-it
19	11	19.11 Të rritet niveli dhe cilësia e përfshirjes së ShC ne aktivitetet e ReSPA-së përmes planifikimit të pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara nga ReSPA.	K4 - 2010	MAP	IKAP	
19	12	19.12 Të përmirësohet cilësia e trajnimeve të ofruara nga IKAP-i, përmes analizës së nevojave për trajnim, dhe hartimit të planit të trajnimeve për 2010. Ofrimi i programeve trajnuese për secilën kategori funksionale sipas kategorizimit të nëpunësve civil bazuar ne draft ligjin për ShC. Dizajnim i kurrikulave bazuar ne nevojat për trajnim.	K3 - 2010	MAP	IKAP	Plani i Veprimt për Reformën e Administratës Publike ne Kosovë 2009-2012.
19	13	19.13 13. Të ngriten kapacitetet e IKAP-it, përmes aftësimit të vazhdueshëm të stafit të IKAP-it, ne fushën e planifikimit, analizave, menaxhimit të programeve të trajnimit, zhvillimit te politikave, procedurave dhe te strategjisë se IKAP për marrëdhëniet me publikun dhe marketingun, si dhe përmes ndërtimit te sistemit te operimit te brendshëm dhe rregulloreve dhe procedurave operative.	K4 - 2010	MAP	IKAP	
19	14	19.14 Organizimi i trajnimeve për trajner ne sektorët: 1) Burime Njerëzore; 2) Menaxhimi i cilësisë ne Administratën Publike -Common Assessment Framework; 3) Prokurim Publik 4) Programet e investimeve publike (PIP)	K4 - 2010	MAP		
19	15	19.15 Miratimi i Projektligjit mbi Pagat e Nëpunësve Civil.	K2 - 2010	Kuvendi	MAP	

19	16	19.16 Monitorimi i të gjitha institucioneve të SHCK-së mbi zbatimin e udhëzimeve administrative mbi procedurat e rekrutimit, vlerësimit të punës dhe të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në të gjitha institucionet e ShC.	Në vazhdimësi	MAP	Ligji mbi Shërbimin Civil 2001/36, Urdhëresa Administrative 2003/2 dhe 12 procedura të Udhëzimeve Administrative të MSHP-së
20	0	<b>20. Të përmirësohet funksionimi dhe të forcohet pavarësia e Bordit të Pavarur Mbikëqyrës dhe e Komisionit për Emërime të Larta Publike.</b>			
20	1	20.1 Alokimi i buxhetit të nevojshëm për funksionimin e mirëfilltë të KPMK-së duke pasur parasysh ngritjen e stafit dhe kapaciteteve përmes trajnimeve.	Në vazhdimësi	Kuvendi	Plani i Punës 2009
20	2	20.2 Të funksionalizohet KPMK-ja përmes emërimit të të gjithë antarëve të KPMK-së	K4 - 2010	Kuvendi	Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/12 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës
20	3	20.3 Të përcaktohen kompetencat e institucioneve dhe procedurat për emërime të shërbyesve të lartë civil në ShCk bazuar në ligjin e ri mbi ShC	K3 - 2010	ZKM	Strategjia Legjislative
21	0	<b>21. Përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve publike për të gjitha komunitetet, përfshirë kontributin për të reduktuar kërkesën për shërbime nga strukturat paralele.</b>			
21	1	21.1 Transferimi i nën-zyrave komunale të punësimit në zyra komunale të punësimit në komunat e reja	K4 - 2010	MPMS	Plani i Punës 2009
21	2	21.2 Ngritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe punësimit përmes trajnimeve të zyrave komunale për punësim dhe mirëqenie sociale pas decentralizimit të sistemit	K4 - 2010	MPMS	Plani i Punës 2009
21	3	21.3 Nxitja e punësimit përmes shërbimeve të punësimit për komunitetin rom, ashkali dhe atë egjiptas (RAE).	K3 - 2010	MPMS	Plani i Punës 2009
21	4	21.4 Ndërmjetësimi në punësim përmes Shërbimeve Publike të Punësimit të grupeve që kanë vështirësi në tregun e punës (te papunët afatgjatë, gratë, RAE dhe persona me aftësi të kufizuara)	Në vazhdimësi	MPMS	MASHT dhe MKRS
21	5	21.5 Hartimi i Strategjisë së Informimit Shëndetësor në Kosovë.	K3 - 2010	MSH	MEF, OBSH dhe MASHT

21	6	21.6 Revidimi i Strategjisë për Shëndetin Riprodhues.	K4 - 2010	MSH	Komunat, MAPL, MPB, MD dhe MPMS	Ligji i Shëndetësisë, Ligji për Shëndetin Riprodhues.
21	7	21.7 Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Shëndetit dhe të Zhvillimit të Fëmijëve dhe Adoeshentëve.	K4 - 2010	MSH	Komunat, MAPL, MPB, MD, MPMS dhe MKRS	Ligji i Shëndetësisë, Ligji për të Ushqyerit me Qumësht, Ligji për Shëndetin Riprodhues, Ligji për Abortin
21	8	21.8 Miratimi i Master-Planit të Ministrisë së Shëndetësisë.	K4 - 2010	MSH	MAPL dhe Komunat	Plani i Punës 2009, KASH, Strategjia Shëndetësore
21	9	21.9 Furnizimi i institucioneve shëndetësore rajonale dhe qendrore me pajisje dhe aparature.	K4 - 2010	MSH	Komunat	Plani i Punës 2009
21		21.10 Funkcionalizimi i Qendrave të Shëndetit mendor përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore (Skenderaj, Drenas, Podujevë, dhe Fushë Kosovë)	K3 - 2010	MSH	MPB, MASHT, MD, UP	Strategjia për shëndet mendor 2008-2013
21	11	21.11. Takime intensive me menaxhimin e institucioneve shëndetësore minoritare për sensibilizimin dhe informimin mbi problemet dhe mundësitë e tejkalimit të problemeve	Në vazhdimësi	MSH	MAPL, Komunat, MKK	Ligji për shëndetin publik
21	12	21.12. Zhvillimi i Sistemit për menaxhimin e stokut farmaceutik	K4 - 2010	MSH	AKPM	Plani i Punës 2010
21	13	21.13. Ridizajimi i modulit për regjistrim dhe licencim të profesionistëve shëndetësor dhe qasja online në këto shërbime	K4 - 2010	MSH		Strategjia Qeveritare për Qeverisje elektronike, Plani i Punës 2010
22	0	<b>22. Të avancohet procesi i decentralizimit dhe të adaptohen, mes të tjerash, ligjet mbi qeverisjen lokale dhe kufijtë komunalë.</b>				
22	1	22.1 Implementimi i Planit të Veprimit të Decentralizimit.	K4 - 2010	MAPL	Komunat	Plani i Punës 2009
		<b>114 Sistemi Gjyqësor</b>				
23	0	<b>23. Të sigurohen gjykata dhe prokurori efektive, të pavarura, illogaridhënëse, të paanshme dhe të lira nga influenca politike.</b>				
23	1	23.1 Rritja e numrit të gjyqtarëve në 80 gjyqtarë.	K4 - 2010	KGJK		
23	2	23.2 Të rekrutohet numri i nevojshëm i stafit administrativ nëpër gjykata, bazuar në analizën mbi numrin e nevojshëm të tyre.	K2 - 2011	KGJK		

23	3	23.3 Miratimi i Projektligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës.	K2 - 2010	MD	Prokuroria e Kosovës, KGJK, ZKM, MEF, Oda e Avokatëve, Profesor Universitar, etj.	Strategjia Legjislatve 2010
23	4	23.4 Themelimi dhe funksionalizimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).	K4 - 2010	MD		Strategjia Legjislatve 2010
23	5	23.5 Miratimi i Projektligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës.	K2 - 2010	MD	KGJK, Prokuroria e Kosovës, ZKM, MEF, Oda e Avokatëve, Profesor Universitar, etj.	Strategjia Legjislatve 2010
23	6	23.6 Verifikimi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve: Riemërimi i të gjithë Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Kosovës në përputhje me praktikat më të mira mbi procedurën e verifikimit.	K4 - 2010	KGJK	KPGJP	
23	7	23.7 Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës.	K4 - 2010	PSH		
23	8	23.8 Funksionalizimi i Dhomës Speciale të Gjykatës së Lartë përmes rekrutimit të gjyqtarëve shtesë profesionalë.	K2 - 2010	KGJK		
24	0	<b>24. Të forcohen Prokuroritë për të siguruar që janë në gjendje të respektojnë parimet e autonomisë dhe paanshmërisë. Të vazhdohet të forcohet Prokuroria Speciale. Të sigurohet zbatimi i një skeme efçiente të sigurisë për mbrojtjen e dëshmitarëve.</b>				
24	1	24.1 Rekrutimi i tre prokurorëve shtesë.	K4 - 2010	PSH	Komisioni i Pavarur për Gjyqësi dhe Prokurori	Rregullorja mbi Themelimin e Këshillit Përkohshëm Prokurorial
24	2	24.2 Sigurimi i automjeteve shtesë për Prokuroritë.	K4 - 2010	MD		Plani vjetori i punës 2010
24	3	24.3 Ngritja e kapaciteteve të Prokurorëve përmes punësimit të stafit mbështetës.	K3 - 2010	PSH	Komisioni i Pavarur për Gjyqësi dhe Prokurori	Rregullorja mbi Themelimin e Këshillit Përkohshëm Prokurorial
24	4	24.4 Ndërtimi i objektit të Prokurorisë së Qarkut dhe asaj Komunale në Pejë.	K4 - 2012	MD		Plani i Qeverisë sipas KASH

24	5	24.5 Ndërtimi i dy objekteve për nevojat e MD-së (në Gjilan dhe Ferizaj).	K4 - 2012	MD		Plani i qeverisë sipas KASH-it
24	6	24.6 Të krijohet një program i qëndrueshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve.	K4 - 2010	MD	Prokuroria e shtetit, MPB	
24	7	24.7 Ndërtimi i burgut për dëshmitarë të mbrojtur	K3 - 2010	MD		2,699,619
24	8	24.8 Të hartohet dhe miratohet rregullorja mbi veprimtarinë e brendshme të prokurorive publike të Kosovës.	K4 - 2010	MD	Prokuroria e shtetit	Ligji mbi Zyrën e Prokurorisë
24	9	24.9 Të hartohet dhe miratohet rregullorja e punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.	K4 - 2010	PSH		Ligji mbi Zyrën e Prokurorisë
25	0	<b>25. Të miratohen ligjet mbi Gjykatat dhe Prokuroritë dhe zbatimi i tyre. Të zhvillohet një sistem i drejtësisë administrative dhe të qartësohen kompetencat.</b>				
25	1	25.1 Të miratohet Projektligji mbi Gjykatat.	K2 - 2010	MD	Prokuroria e Kosovës, KGJK, ZKM, MEF, Oda e Avokatëve, Profesor Universitar, etj.	Strategjia Legjislativë 2010
25	2	25.2 Të miratohet Projektligji mbi Prokuroritë.	K2 - 2010	MD	Prokuroria e Kosovës, KGJK, ZKM, MEF, Oda e Avokatëve, Profesor Universitar, etj.	Strategjia Legjislativë 2010
25	3	25.3 Të bëhet ristrukturimi i Gjykatave, bazuar në Ligjin e ri mbi Gjykatat.	K4 - 2010	KGJK		
25	4	25.4 Të bëhet ristrukturimi i Prokurorive, bazuar në Ligjin e ri mbi Prokuroritë.	K4 - 2010	PSH		
26	0	<b>26. Të zbatohet plotësisht Sistemi i Automatizuar i Menaxhimit të Rasteve në të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë. Të zvogëlohet numri i rasteve të pazgjidhura dhe të bëhet zbatimi i vendimeve të gjykatave civile.</b>				
26	1	26.1 Hartimi i rregullave për menaxhimin e gjykatave, në përputhje me Ligjin e ri mbi Gjykatat.	K1 - 2011	KGJK		Plani Strategjik 2007-2012

26	2	26.2 Hartimi i rregullave mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave, në përputhje me Ligjin e ri mbi Gjykatat.	K1 - 2011	KGJK		
26	3	26.3 Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Teknologji Informative.	K3 - 2010	KGJK		
26	4	26.4 Mbështetja e përdoruesve në zbatimin e softuerit i cili ka për qëllim menaxhimin e automatizuar të rasteve në gjykata dhe prokurori.	K3 - 2010	KGJK		
26	5	26.5 Krijimi i bazës ligjore mbi Ndarjen e lendeve për gjyqtar që merren me lëndë penale dhe civile.	K4 - 2010	KGJK		
26	6	26.6 Rritja e numrit të stafit të TI-së, përfshirë edhe ndërrimin dhe furnizimin me pajisje të nevojshme të TI-së.	K2 - 2011	KGJK		
26	7	26.7 Funkcionalizimi i arkivave digjitale të Prokurorëve.	K4 - 2010	MD	Prokuroria e shtetit	
27	0	<b>27. Të forcohen gjykatat komunale dhe veprimet policore që të adresojnë, parandalojnë dhe sanksionojnë uzurpimin, përdorimin e pronës dhe ndërtimin e saj në mënyrë të paligjshme.</b>				
27	1	27.1 Të forcohet bashkëpunimi në mes të gjykatave komunale, AKP-së, Inspeksioneve Komunale të Ndërtimit dhe Policisë në ekzekutimin e rasteve, përmes një Memorandumi Mirëkuptimi.	K4 - 2010	KGJK	MPB/PK MAPL/Komunat, Agjencia Kadastrale dhe AKP	
27	2	27.2 Implementimi i procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.	K4 - 2010	KPGJK	KGJK	Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/2
28	0	<b>28. Të zhvillohet edhe më tutje avancimi dhe trajnimi ligjor, posaçërisht për gjykatës, prokurorë, dhe për personelin administrativ. Të transformohet Instituti Gjyqësor në një institucion funksional të përgjegjshëm për trajnim e gjyqësorit.</b>				
28	1	28.1 Organizimi i trajnimit të vazhdueshëm për arsimim fillestar ligjor për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj, pas përfundimit të procesit të riemërimit.	K4 - 2010	IGJK	KGJK dhe MD	Ligji për Themelimin e IGJK-së-Nr.02/L-25, Plani Strategjik tre vjeçar dhe Programi Trajnues I aprovuar nga Këshilli Drejtues
28	2	28.2 Hartimi, vlerësimi dhe administrimi i Provimit Përgatitor/Hyrës për kandidatët për Gjyqtarë dhe Prokurorë er arsimim ligjor për kandidatet për gjyqtare dhe prokurorë.	K3 - 2010	IGJK	KGJK dhe MD	Ligji për Themelimin e IGJK-së-Nr.02/L-25, Plani Strategjik tre vjeçar
28	3	28.3 Funkcionalizimi i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.	K2 - 2010	MD		Plani vjetor i punës 2010

28	4	28.4 Trajnimi i gjyqtarëve porotë.	K4 - 2010	IGJK	KGJK dhe MD	Ligji për Themelimin e IGJK-së-Nr.02/L-25, Plani Strategjik tre vjeçar dhe Programi Trajnues I aprovuar nga Këshilli Drejtues	
28	5	28.5 Implementimi i Programit të Hulumtimeve, dhe publikimi i dokumenteve, rekomandimeve dhe punimeve shkencore lidhur me problemet ligjore dhe të praktikës gjyqësore.	K4 - 2010	IGJK	Qendra Juridike e Kosovës	Ligji për Themelimin e IGJK-së Nr.02/L-25, Plani Strategjik tre vjeçar dhe Programi Trajnues I aprovuar nga Këshilli Drejtues	
28	6	28.6 Trajnimi i trajnuesve të cilët përgatiten në frymën e Teknikave dhe Metodologjive bashkëkohore trajnuese dhe të gatshëm të hartojnë module trajnuese dhe zhvillojnë kurse trajnimi bazuar në to.	K4 - 2010	IGJK		Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor	
28	7	28.7 Organizimi i katër sesioneve të provimeve të avokaturës pas themelimit të Komisionit të Jurisprudencës, sipas ligjit në fuqi.	K4 - 2010	MD		Udhëzimi Administrativ për Programin dhe mënyrën e dhënies së provimit të Jurisprudencës. UA 152-126/09	
29	0	<b>29. Të zhvillohet kapaciteti i Qeverisë për të marrë përgjegjësi në fushën e drejtësisë dhe atë të punëve të brendshme, pa ndikim politike. Të zbatohet sistemi për emërimin, largimin dhe promovimin në karrierë të gjykatësve dhe prokurorëve, në përputhje me standardet evropiane, pa ndikime politike.</b>					
29	1	29.1 Sigurimi i softuerit të nevojshëm dhe krijimi i bazave të të dhënave dhe arkivave elektronike për të bartur të dhënat nga DD/UNMIK në MD.	K2 - 2011	MD			
29	2	29.2 Miratimi i Projektligjit mbi Mjekësi Ligjore.	K2 - 2010	MD	Prokuroria e Kosovës, KGJK, ZKM, MEF, Dep. Për Mjekësi Ligjore dhe Persona të Zhdukur, Profesor Universitar, etj.	Strategjia legjislative 2009	
29	3	29.3 Zhvillimi i procesit të riemërimit.	K4 - 2010	KPGJK	KGJK		

29	4	29.4 Hartimi dhe miratimi i Rregullave dhe procedurave për: a) Emërim të përhershëm dhe të përkohshëm të gjyqtarëve, b) Vlerësim, c) Transferim dhe d) Avancim	K1 - 2011	KGJK	IGJK	
29	5	29.5 Ngritja e kapaciteteve administrative përmes rekrutimit, transferimit dhe trajnimit të stafit me qëllim të fuqizimit dhe funksionimit të plotë të administratës në Ministrinë e Drejtësisë.	K4 - 2010	MD		Plani Vjetor i punës 2010
29	6	29.6 Të bëhet ristrukturimi dhe riorganizimi i MD-së, bazuar në raportin e Rishikimit Funksional.	K2 - 2011	MD	MAP	Plani vjetor i punës 2010
29	7	29.7 Hartimi dhe miratimi i rregullave dhe procedurave për hetimin e pohimeve për sjetje të pajishme.	K2 - 2011	KGJK		
29	8	29.8 Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mbi projektin për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.	K4 - 2010	KPGJK	KGJK	Urdhërsa Administrative e UNMIK-ut 2008/2
